

Dr. Vehbetu Zuhejli

Parimi i interesit

VIII

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:

Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:

Dr. Musli Vërbani

Titulli:

Parimi i interesit

Korrektura:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Parimi i interesit

Në temën e kijasit, në nëntemën *rrugët e arsyes*, studiuesi e kupton se *përshtatshmëria* është harmonizimi ndërmjet atributit dhe ligjit, me fjalë tjera, është rruga e cila tregon arsyeshmërinë (*me arsyeshmëri nënkuptohet atributi i vlefshëm për të arsyetuar ligjin nëpërmjet kijasit*) dhe atëherë kur Ligjvënësi e merr për bazë përshtatshmërinë për shkak të atributit të përshtatshëm.

Përshtatshmëria mund të jetë:

- ose për shkak të anulimit, që do të thotë, kur Ligjvënësi e anulon për shkak se vjen një atribut degë e kundërt me bazën;
- ose për shkak të miratimit, që do të thotë, kur Ligjvënësi e konfirmon për shkak se vjen një atribut për ta vërtetuar, por jo nëpërmjet tekstit apo sinjalizimit të tekstit (të Kur'anit dhe Sunetit).

Bazuar në këto, atëherë atributi i përshtatshëm, ashtu siç e parasheh Ligjvënësi ndahet në tri lloje:¹

1. **Atributi i llogaritur si i përshtatshëm:** Është, atributi të cilin Ligjvënësi e ka dëshmuar si të llogaritur, pasi që nëpërmjet tij ka aprovuar ligje të sqaruara se si është arritur deri tek aty. *Shembull:* Të gjitha ligjet e sheriatit të aprovuara për t'i siguruar pesë parimet kryesore të sheriatit, apo qëllimet e ligjeve të cilat janë lejuar në një popull prej popujve² e ato janë:

- Sigurimi i fesë;
- Sigurimi i jetës;
- Sigurimi i mendjes;
- Sigurimi i pasurisë;
- Sigurimi i trashëgimtarëve.³

Xhihadi dhe vrasja e tradhtarit të fesë (felëshuesit) janë ligjësuar në bazë të parimit për të siguruar fenë apo besimin.

Hakmarrja është ligjësuar për të siguruar jetët dhe gjakderdhjen, sepse hakmarrja është mjete më i qartë për të sjellë dobi.

Ndalimi i pijeve alkoolike dhe dënimi për to është ligjësuar për të siguruar mendjet.

Ndalimi i vjedhjes dhe prerja e dorës së vjedhësit është ligjësuar për të siguruar pasurinë private.

Ndalimi i prostitucionit dhe dënimi me të rrahur është ligjësuar për të siguruar pasardhësit dhe nderin.

Lehtësimi me mosagjërime për udhëtarin dhe për të sëmurin dhe shkurtimi i namazit dhe bashkimi i namazeve është ligjësuar për të larguar vështirësitë nga njerëzit.

Nuk ka mospajtim në mes të dijetarëve se ky atribut qon në lejimin e arsytimit për të aprovuar ligje sepse ligjet e sheriatit janë për të sjellë interes dhe për të larguar dëmin.

2. **Atributi i anuluar (i diskualifikuar):** është atributi të cilin Ligjvënësi e ka dëshmuar të anuluar (diskualifikuar) ashtu që ka përpiluar ligje të cilat tregojnë se nuk duhet bazuar në të, si f.v.:

- obligueshmëria e agjërimit të dy muajve rresht dhe pandërprerë në ndëshkimin për shkak të kontaktit, edhe pse është ndëshkim më i rreptë se sa ndëshkimi për lirim të një robi, mirëpo Ligjvënësi e ka anuluar këtë atribut ashtu që në rend të parë të jetë lrimi i robit dhe nuk lejohet të merret për bazë që të jetë vetëm ky atribut për të kundërshtuar tekstin i cili është thur nga suneti: **“Liroje një rob.”**

- ose përkufizimin e konceptit të kompensimit në ndëshkim duke mos i marrë parasysh dobitë e tjera, *shembull*: Hiperbolizimi i dënimit në detyra, sepse mendja e koncepton se hiperbolizimi në detyra sjell dobi, ashtu siç kanë menduar disa shahbe kur kanë ndaluar veten (si ndëshkim) me mosushqim duke agjëruar pandërprerë, disa tjerë kanë vendosur që të mos martohen kurrë, disa tjerë duke e ndëshkuar veten me mosfjetje natën për t’u falur gjatë tërë natës. Mirëpo, Ligjvënësi këtë e ka anuluar me thënien e pejgamberit s.a.v.s., **“Në islam nuk ka murgëri.”**⁴ dhe pastaj pejgamberi s.a.v.s. u ka thënë atyre, **“Unë më së shumti i frikohem Allahut dhe jam më i devotshmi, mirëpo unë agjëroj por edhe nuk agjëroj, falem dhe pushoj, martohem, dhe kush i largohet sunetit tim ai nuk është prej meje.”**⁵ Kemi edhe shembuj të tjerë të shumtë, si f.v., të vepruarit me kamatë, dhënia e kompetencës për shkurorëzim gjyqtarit apo gruas, të mbyturit e të sëmurit pa shpresë jete me qëllim që të lirohet nga vuajtjet. Të gjitha këto bien në kundërshtim me tekstet e Ligjvënësit. Nuk ka mospajtim në atë se arsytimi me këto attribute është i ndaluar, po ashtu nuk lejohet edhe arsytimi për t’i lejuar, siç kemi thënë edhe më herët.

3. **Përshtatshmëria asnjane:** është atributi i cili prej Ligjvënësit nuk është kuptuar se është anuluar apo se është marrë për bazë, as prej tekstit dhe as prej ixhmait,⁶ që do të thotë se në ligjet e sheriatit nuk është hasur diçka që pajtohet me atë atribut apo që e kundërshton atë atribut.

Për këtë atribut dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme rreth lejimit të arsyetimit të tij.

Gazalijtë e quajnë *interesi i pabazuar*. Vet Gazaliu e quan *parim interesi*. Mutekeliminët e usulit e quajnë *përshtatshmëri në harmonizim me interesin*. Disa tjerë e quajnë *argumentim i pabazuar*.

Imam Hamejini dhe Ibn Semani e quajnë *në përputhshmëri me argumentin*.

Sa i përket parimit të interesit, do të flas si në vijim:

- Llojet e interesit;
- Definicioni;
- Argumentimi;
- Kushtet e të vepruarit;
- Mendimi i Nexhmud-dijn et-Tufit për anulimin e tekstit për shkak të interesit.

Tema e parë: Llojet e Interesave

Ashtu siç kemi thënë, klasifikimin i cili është përmendur për interesin apo atributin e përshtatshëm, ashtu siç e bazon apo nuk e bazon Ligjvënësi dhe po ashtu interesi të cilin as nuk e dokumenton dhe as nuk e anulon Ligjvënësi është klasifikim tjetër nga aspekti i fuqisë së saj në vetvete. Ky klasifikim është tri llojesh:⁷

1. **Domosdoshmëritë** – Janë çështjet prej të cilave varet jeta e njerëzve si për këtë botë ashtu edhe për botën tjetër, ashtu që nëse mungojnë, vihet në rrezik jeta në këtë botë, zhduken të mirat dhe fitohet ndëshkimi në botën tjetër, e ato janë: *sigurimi i jetës, i fesë, i mendjes, i trashëgimtarëve dhe i pasurisë*.

2. **Nevojshmëritë** – Janë çështjet për të cilat kanë nevojë njerëzit për të larguar vetëm të keqen, ashtu që nëse do të ndodhnin, njerëzit do të rrezikoheshin dhe do t'u ngushtohej gjendja, por nuk do të rrezikohej jeta e tyre. Ligjvënësi i ka ligjësuar llojet e ndërveprimeve njerëzore të shitblerjeve, qiradhënien, qiramarrjen dhe llojet e lehtësimeve të shkurtimit të namazit, të bashkimit të namazeve, lejimit të mosagjërimi të ramazanit për shtatzënë, gjdhënësen, të sëmurin. Lirimi nga namazi për menstruacionisten, lehonën, mes'hi mbi meste për rezidentin dhe udhëtarin, dhënia e së drejtës për kurorëzim të së miturës për shkak se ka nevojë që ajo të martohet me të ngjashmen me të, e të ngjashme.

3. **Përsosmëritë** – Janë interesat me të cilat synohet që të realizohet edukimi sa më cilësor dhe tradita sa më e përsosur. *Shembull*: pastërtitë për namaz, veshja e rrobave sa më të mira, vendbanimet sa më të mira, ndalimi i ushqimeve të papastras, sigurimi i gruas ashtu që drejtpërdrejt në aktin e kurorëzimit e zëvendëson i autorizuari i saj, e raste të ngjashme.

Këto tri lloje të interesave janë pika fillestare e parimit të interesit. Prej çështjeve të cilat nga natyrshmëria Ligjvënësi i konsideron prej interesit të njerëzve në ligjësimin e dispozitave të kësaj bote për të pasur vlerë, dobi dhe interes, dhe që nuk janë të domosdoshme dhe të prera siç i konsiderojnë Muëtezilët. Për këtë arsye shumica e dijetarëve i quajnë *parimi i interesit i padokumentuar (neutral)*. Sa i përket nevojave të domosdoshme, me këtë titullim janë pajtuar Shafiijtë, e prej tyre Gazaliu. Përderisa, sa i përket nevojave jo të domosdoshme dhe përsosmërive, nuk lejojnë ligjësim të padokumentuar, nëse nuk ka mbështetje në dëshmi bazë prej dëshmimeve bazike të shariatit, vetëm poqëse është ligj i cili derivon prej

domosdoshmërive dhe dihet se domosdoshmëritë lejojnë të ndaluarat, ashtu siç do të sqarojmë më vonë në nëntemën “**Argumentimi i parimit të interesit**”.

Tema e dytë: Definicioni i parimit të interesit

Gazaliu, Zoti e pastë mëshiruar, ka thënë: Interes quhet ajo prej bazës së cilës rezulton dobja ose mënjanohet dëmi, dhe ne nuk pajtohemi me këtë, sepse sjellja e dobive dhe largimi i dëmit janë prej qëllimit të krijesave, sepse *e mira* e krijesave nënkupton realizimin e qëllimeve të tyre. Por ne me parimin e interesit kemi për qëllim: Sigurimin e qëllimit të Ligjit dhe Ligji ka për qëllim që krijesave t’ua siguroj pesë çështje: ***fenë e tyre, veten (jetën) e tyre, mendjet e tyre, pasardhësit e tyre dhe pasurinë e tyre***. Çdo gjë e cila është në mbështetje të sigurimit të këtyre pesë çështjeve quhet “**interes**”. Çdo gjë e cila i rrezikon këto pesë baza quhet dëm dhe largim i interesit.⁸

Kështu e ka definuar Gazaliu kur ka sqaruar peshoren e interesit, ai në këtë ka të drejtë, sepse njerëzit ndryshojnë në përcaktimin e interesit varësisht prej asaj se çka ata e parashohin si interes personal, duke mos e shikuar interesin e shumicës apo interesin e përgjithshëm. Duhet që Ligjvënësi i Urtë të ligjësoj atë që është e drejtë në mes njerëzve në peshoren e dobive, e pastaj ato dobi të shpërndahen në mënyrë të barabartë. Nga kjo edhe paraqitet nevoja në përcaktimin e interesit në peshoren e ligjit, pa ua lënë në dispozicion egoje (epsheve) të individëve dhe logjikës (hamendjes) së tyre.

Me termin “**dëme dhe dobi**” është për qëllim ajo se si e parasheh ligji dhe jo ajo çka është e përshtatshme apo e papërshtatshme me natyrshmërinë.⁹ Kjo është ajo që na detyron që ta sqarojmë esencën e **parimit të interesit** sipas terminologjisë së ekspertëve të Usulit.

Havarizmiju e definon kështu: Me termin *interes* qëllimi është sigurimi i qëllimit të Ligjvënësit për të larguar dëmin nga krijesat.

Gazaliu e definon kështu: Është që të gjendet një koncept me të cilin ndjehet se dispozita logjike është e papërshtatshme, por, ja që nuk e kemi ndonjë bazë e cila është në përputhshmëri me të.

Ibn Burhani e definon kështu: Është ajo e cila nuk ka as mbështetje të përgjithshme dhe as mbështetje parciale.

Këto definicione janë të përafërta për nga kuptimi, por unë preferoj një definicion tjetër i cili është më i qartë për të definuar parimin e interesit: *Janë atributet të cilat janë në harmoni me veprimtaritë e qëllimit të Ligjvënësit, por që nuk janë hasur në ndonjë argument të caktuar prej Ligjvënësit, as për t'i vërtetuar (miratuar) as për t'i zhvleftësuar, dhe me të realizohet ndërlidhshmëria e ligjit, për t'u sjellë dobi njerëzve apo për të larguar dëmin nga ta.*¹⁰

Nga kjo kuptohet se:

- nëse për një ngjarje gjendet diçka identike me një ligj të Kur'anit, sunetit apo ixhmait, atëherë muxhtehidi **ia mësyn kijasit**.
- Përderisa, nëse nuk gjendet atribut i përshtatshëm me të cilin mund të aprovohet ligji me atë ngjarje identike, atëherë muxhtehidi **ia mësyn parimit të interesit**.

Cili është qëndrimi i dijetarëve për këtë, a lejohet të merret për bazë apo jo?

Tema e tretë: Argumentimi i parimit të interesit

Nuk ka mospajtim në atë se Ligji islam është ligj edhe i kësaj bote edhe i botë tjetër. Në aspektin fetar janë dispozitat e adhurimit, siç janë: rregullat e namazit dhe agjërimit, urtësinë e të cilave nuk mund t'i kuptojë mendja jonë në mënyrë të saktë. Në këto dispozita nuk ka vend për kijasë (analogji), ashtu që në këto çështje të kemi të bëjmë me parimin e interesit, sepse këto çështje janë të përkufizuara vetëm në shpallje qiellore, e cila e thur mënyrën e adhurimit e cila sjell kënaqësinë e Zotit të Lartmadhëruar, ashtu që të jenë unilaterale për të gjitha gjeneratat dhe llogariten prej cilësive të ngjitura domosdoshmërisht me personalitetin e muslimanit në të gjitha kohërat dhe për të gjithë dhe për të mos ketë nevojë për kijasë dhe të mos ketë shpikje apo risi apo reformim në të, sepse përndryshe do të shpinte te çështja e cila të devijon dhe të humb.

Sa i përket statusit personal apo veprimtarive të ndërsjella ndërnjerëzore është sferë e pranuar që në të të bëhet ixhtihadë nëpërmjet rrugës së kijasit, parimit të interesit, e të ngjashme, vetëm se dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket se a lejohet të merret për bazë me titullimin e saj si argument i pavarur në ligjësimin e ligjeve në tri drejtime, ashtu siç i ka përmendur Esneviu, Shevkaniu dhe të tjerë¹¹, por Shevkaniu e ka paraparë edhe drejtimin e katërt, sa i përket parimit të interesit, nëse ai interes është në përputhshmëri me bazën shariatike të tërësishme dhe parësore. Sipas mendimit tim ky i takon burimit të kijasit, për këtë arsye drejtimin e katërt nuk do ta përmendi.

Drejtimi i parë: Shumica absolute e dijetarëve (*Kjo çështje duhet të analizohet, ashtu siç do ta kuptojmë më vonë*): **Absolutisht nuk veprohet me parimin e interesit.** Të këtij mendimi janë: Ibn Haxhibi, sipas mendimit më të preferuar të tij, pastaj Amediju, i cili ka thënë:¹² Është e vërtetë se për këtë janë pajtuar dijetarët.¹³ Sa i përket shiitëve, dijetarët e tyre janë pajtuar që të mos japin fetva me të.¹⁴

Profesori Muhamed Tekijudin ka thënë: Shiitët nuk e pranojnë parimin e interesit, pos asaj e cila logjikisht duhet të jetë e patjetërsueshme, përpos saj nuk merret si argument.

Drejtimi i dytë: Imam Maliku, këtë e ka preferuar Imam Haremejni, se¹⁵ **parimi i interesit është argument dhe pranohet si argument.** Transmetohet se Maliku ka thënë: Lejohet mbytja e një të tretës, për të shpëtuar dy të tretat.¹⁶ Imam Maliku llogaritet si flamurtar i të vepruarit me

parimin e interesit. Sipas mendimit të tij, interesi merret për bazë ose nëpërmjet tekstit ose prej përgjithësisë e cila rezulton prej teksteve. *Shembull*: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

أَجْتَبَاكُمْ وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“Dhe nuk ka bërë për ju në fe diçka çka ju rëndon.” (El Haxh : 23)

Thënia e Muhamedit s.a.v.s.:

“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”

Interes quhet ajo e cila në Ligjin e Allahut nuk është as e urdhëruar dhe as e ndaluar. Interes i paligjësuar. Kjo është ajo në të cilën dobia është më e madhe se sa dëmi. Imam Ahmedi ka vepruar me parimin e interesit. Ky parim është bazë e medhhebit të tij. Në çështjen e zgjedhjes së qeverisë ka vepruar me parimin e interesit në mënyrë të përgjithshme. Është program i Imamit për rregullimin e çështjeve shoqërore, e ka aplikuar në atë mënyrë që prej këtij parimi shoqëria të përfitoj dhe të largoj dëmin.

Drejtimi i tretë: Gazaliu ka thënë: **Parimi i interesit merret për bazë atëherë kur interesi është i patjetërsueshëm dhe i tërësishëm, përndryshe nuk merret parasysh.** Domosdoshmëri llogaritet njëra prej pesë domosdoshmërive sipas radhitjes:

1. sigurimi i fesë,
2. i jetës,
3. i mendjes,
4. i pasardhësve dhe
5. i pasurisë.

Sa i përket *i patjetërsueshëm*, është atëherë kur interesi është i prerë.

I tërësishëm është ajo e cila është obligative në bazë të parimit të përgjithshëm të muslimanëve.¹⁷

Shembull: Nëse pabesimtarët, i zënë rob muslimanët dhe i vendosin si mur të gjallë duke i vënë si mburojë para neve me qëllim që të na sulmojnë dhe ne jemi të sigurt se nëse nuk i vrasim muslimanët të cilët janë mur i gjallë para pabesimtarëve, atëherë ata na mbysin dhe e okupojnë vendin, dhe shtëpitë e muslimanëve i shkatërrojnë, dhe i mbysin të gjithë muslimanët, do të mbysin edhe muslimanët e pafajshëm, në këtë rast mbytyja e robërve në

mur të gjallë është në interes, por që nuk është nënvizuar (cekur) me ligj, dhe me këtë lejohet vrasja e muslimanit pa bërë mëkat.

Po ashtu nuk ka argument se nuk lejohet mbytja e muslimanit për të realizuar interesin e përgjithshëm të muslimanëve, bile ai musliman i zënë rob, edhe ashtu veç është i mbytur, kështu që interesi realizohet, sepse shpëtimi i një grupi të madh të muslimanëve ka përparësi në realizimin e qëllimit të frymës kushtetuese, se sa të shpëtohej një musliman, sepse qëllimi i ligjit është zvogëlimi i vrasjeve, e armiku veç ka për pikësynim të vras sa më shumë dhe edhe nëse nuk fitojmë ndaj armikut, kemi arritur të zvogëlojmë numrin e të vrarëve.

Këtë e mbështet edhe një shembull tjetër, të cilin e tregon Gazaliu: Institucionalizimi i haraxhit për plantacionet. Nëse bëhet shpronësimi dhe pastaj nuk ka mjete për t'i plotësuar nevojat e ushtrisë dhe atëherë njerëzit aktivizohen në punimin e tokave, paraqitet rreziku që pabesimtarët t'i okupojnë vendet islame, ose ekziston rreziku i kryengritjeve dhe përçarjeve në vendet islame, kështu që lejohet për qeveritarin që t'i obligoj të pasurit që të shpenzojnë për ushtrinë, sepse kur të paraqiten dy të këqija, apo dy dëme, qëllimi i Ligjvënësit është që të largoj dëmin më të madh dhe të keqen më të madhe. Është e paktë puna e individit në krahasim me rrezikun i cili paraqet humbjen e qeverisjes e cila e ruan sistemin e qeverisjes dhe nuk lejon rikthimin e trazirave dhe shkatërrimeve.

Vërehet se, tek shembulli i vrasjes së të burgosurit të lidhur dhe institucionalizimi i haraxhit është parimi i të vepruarit në rast të domosdoshmërive dhe këto bëjnë pjesë brenda kornizës së rregullave të ligjit të përgjithshëm e cila është e pranuar nga të gjithë muslimanët. *Shembull:* Të zgjedhurit e të keqes më të lehtë nga dy të këqijat. Kjo na tregon se për parimin e interesit i kemi vetëm dy drejtime:

- Drejtimi i parë: **nuk e pranon;**
- Drejtimi i dytë: **e pranon.**

Cilat janë ato dy drejtime?

Ata të cilët nuk e pranojnë janë: Dhahirijtë, shiitët, Shafijjtë dhe Ibn Haxhibi nga Malikijtë.

Ata të cilët e pranojnë janë: Malikijtë dhe Hanbelijtë.¹⁸

Sa i përket Hanefijëve, Amediju tregon se janë me Shafijjtë në mospranimin e parimit të interesit, pastaj këto i ka pasuar Esneviju dhe disa autorë modern të shkencës së usulit.

Mirëpo, Hanefijtë veprojnë me parimin e interesit, nëpërmjet rrugës së istihsanit, në të cilën Ebu Hanife është i mrekullueshëm, sepse ajo në çka më së shumti mbështetet istihsani është mbështetja në parimin e interesit, *siç kemi treguar më parë*.

Nga kjo kuptohet se shumica absolute e dijetarëve veprojnë me parimin e interesit, e kjo është e kundërta e asaj të cilën e thonë Esneviju dhe Shevkaniju kur i paraqesin drejtimit e dijetarëve në lidhje me këtë çështje. Këtë konkludim e kam arritur gjatë përcjelljes së aprovimit të ligjeve sekondare të medhhebeve edhe pse në aspekt të jashtëm e mohojnë parimin e interesit.

Argumentet

Argumentet e mohuesve

Mohuesit e parimit të interesit janë argumentuar si në vijim:

1. Të vepruarit me interesin do të na tregonte se ligji hyjnor, pra ligjet e sheriatit nuk janë të përsosura dhe do të na shpinte në pasimin e epsheve, varësisht prej qëllimeve të tyre dhe në realizimin e projekteve të tyre brenda vellos së parimit të interesit, duke u bazuar në ndryshimin e interesit varësisht prej ndryshimit kohëror dhe vendeve dhe veprimi me parimin e interesit do të ishte veprim sipas apetiteve dhe dëshirave. Ibn Hazmi ka thënë: **Kjo është e papranueshme, sepse parimi i interesit është pasim i epshit dhe mendim pa argument.**¹⁹

Ky argument replikohet me atë se: të vepruarit me parimin e interesit, nuk është të vepruarit e llojit të veprimit sipas dëshirës dhe ligjësimi i epshit, sepse prej kushteve të të vepruarit me të (*siç do t'i sqaroj më vonë*) është të ekzistuarit e përputhshmërisë në mes të interesit dhe qëllimeve të sheriatit.

Kjo, dhe duke pasur parasysh se urrejtja ndaj të vepruarit me parimin e interesit shpie deri te mbyllja e kapitullit prej kapitujve të cilat janë kapituj të mëshirës ndaj krijesave dhe ai i cili e deklaroi interesin është prej atyre të cilët janë kompetent për ixhtihadë dhe për aprovim të ligjeve.

2. Parimi i interesit është term në mes të dy shprehjeve: Anulimi i disa dobive nga Ligjvënësi dhe llogaritja e disa dobive tjera. Poqëse do të bëhen obligative ato interesa, për shkak të llogaritjes se ato sjellin dobi, do të bëhej obligative anulimi i tjerave gjithashtu, për shkak të llogaritjes se nuk sjellin dobi. Për shkak të ekzistimit të këtyre dy alternativave nuk lejohet të vepruarit me të, sepse nuk ka prioritet ndaj njëra-tjetrës, për këtë arsye nuk lejohet që të merret si argument në ligjësimin e ligjeve të shariatit, sepse esenciale është mosligjësimi deri sa të sillet argumenti për ligjësimin e saj.²⁰ Amediju ka thënë: Parimi i interesit është mes premtimit të Ligjvënësit për ta ligjësuar apo premtimit për ta anuluar, e jo që t'i jepet përparësi të parës ndaj të dytës dhe është penguar që të argumentohet me të pa pasur dëshmi për ta marrë për bazë me të cilën kuptohet se është prej llojit e cila merret parasysh përpos asaj çka përjashtohet.²¹

Replikohet për këtë argument se çështja se atributi përmban dobi në krahasim me atë që llogaritet t'i jepet prioritet ndaj asaj që duhet të anulohet sepse Ligjvënësi është përkujdesur për vendosjen e parimit që në ligjësimin e ligjeve të ketë interes, gjë që dominon mendimi për ta llogaritur se është në harmonizim me dobinë dhe duhet të veprohet me të, sepse: **të vepruarit sipas mendimit më të sigurt është obligative.**

Po ashtu, dobitë të cilat Ligjvënësi i ka anuluar janë shumë të pakta në krahasim me dobitë të cilat nuk i ka anuluar, kështu që ligjësohet me atë çka është e shumtë dhe e përgjithshme.

3. Të vepruarit me parimin e interesit na orienton në realizimin e unisimit të ligjësimit dhe përgjithësimin e tij, sepse ligjet ndryshojnë varësisht prej ndryshimeve të kohërave, gjendjeve dhe personave, duke pasur parasysh në ndryshimin e interesave varësisht prej kalimit të kohës.

Replikohet me atë se sfera e të vepruarit me parimin e interesit nga aspekti se nuk ekziston as fuqizimi dhe as të shfuqizimi nuk është në kundërshtim me parimin e unisimit (unifikimin) të ligjësimit dhe përgjithësimit të tij, por çështja është e kundërta e saj sepse e bën shariatin të jetë i përshtatshëm për çdo vend dhe për çdo kohë me atë që është në përputhshmëri të interesit të përgjithshëm dhe e mënjanon dëmin nga shoqëria.

Argumentet e vërtetuesve

Shumica absolute të cilët e pranojnë argumentimin e parimit të interesit argumentohen me argumente si në vijim:

1. Në mënyrë permanente është vërtetuar se ligjësimi i ligjeve kujdeset që t'i sjell interes njerëzve. Vet çështja e ligjeve në përgjithësi është në dobi të njerëzve, kjo na obligon që të mendojmë se arsyetimi i ligjeve bëhet për interes²², sepse të vepruarit me mendimin dominues është obligativ. Argument për parimin e interesit kemi thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ﴿١٧﴾

“Ne të kemi dërguar ty (Muhamed) mëshirë për gjithë njerëzimin.” (El Enbija : 107)²³

Fjala “mëshirë” nënkupton realizimin e interesit për njerëzit.

Pastaj thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

يُرِيدُ اللَّهُ بِكُمُ الْيُسْرَ وَلَا يُرِيدُ بِكُمُ الْعُسْرَ

“Allahu dëshiron për ju lehtësim dhe nuk dëshiron për ju vështirësim.” (El Bekare : 185)

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar në lejinim e mishit të derrit për atë i cili është i detyruar:

فَمَن أَضْطَرَّ فِي حُمْصَةٍ غَيْرِ مُتَجَانِفٍ لِإِثْمٍ فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣﴾

“Dhe kush detyrohet nga uria tej mase (dhe ha) por nuk e tepron në ngrënie për të mëkatuar. Pa dyshim se Allahu është Falës, Mëshirues.” (El Maide : 3)

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى

وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٧﴾

“O ju njerëz, u ka ardhur juve këshillë prej Zotit tuaj dhe shërim për atë që keni në zemra, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.” (Junus : 57)

Thënia e Muhamedit s.a.v.s.:

“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”²⁴

2. **Jeta është dinamike dhe vazhdimisht zhvillohet.** Mjetet e njerëzve për t’i realizuar interesat e tjerë ndryshojnë në çdo kohë dhe çdo vend. Gjatë zhvillimit shoqëror paraqiten interesa të reja, po të ndaleshim vetëm në ligjet të cilat janë themeluar për interes të cilin e parasheh teksti, shumë interesa të shoqërisë do të paralizoheshin, shoqëria do të ngurtësohej dhe sheriatit do të mbetej vetëm për kohën e kaluar. Me këtë shoqëria do të dëmtohej shumë dhe nuk do të ishte në harmonizim me qëllimet e ligjit në realizimin e interesave dhe në largimin e dëmeve. Për këtë arsye, është e patjetërsueshme që të bëhet aprovimi i ligjeve të reja të cilat janë në harmonizim me pikësynimet e përgjithshme të ligjësismit dhe qëllimeve të tërësishme ashtu që të realizohet përgjithmonshmëria e sheriatit dhe vlefshmëria e vazhdueshme.

3. Ai i cili i përcjell ixhtihadet e shabeve dhe të tjerëve që i pasojnë ata, sheh se ata kanë dhënë fetva të shumta të ngjarjeve vetëm se kanë parë se për atë ngjarje anon interesi, duke mos u mbështetur vetëm në rregullat e kijasit, që do të thotë se kanë dhënë fetva vetëm duke e parë se ekziston dëshmi e qartë se është në interes (të qytetarëve) dhe për këtë nuk i ka kundërshtuar askush prej tyre. Kështu që, veprimi i tyre llogaritet themelim i ixhmait për t’u bazuar në harmonizimin e interesit dhe dihet se ixhmai është argument me të cilin patjetër duhet të veprohet. Shembuj të kësaj natyre kemi si në vijim:

- a. Ebu Bekri r.a., Kur’anin fisnik e ka tubuar në mus’haf, pasi që më parë ishte i shpërndarë, pasi që për këtë e sinjalizoi Umeri r.a. edhe pse më herët nuk e kishte bërë askush. Umeri e ka argumentuar kështu: “Për Zotin, kjo është në interes të islamit.”

Ebu Bekri r.a. i ka luftuar penguesit e Zekatit.

Ebu Bekri e ka nominuar Umerin për halife pas tij edhe pse më herët nuk kemi dëgjuar për një nominim të tillë.

- b. Umeri r.a. e ka pezulluar pjesën e zekatit për personat të cilëve duhet përfutur zemrat e tyre edhe pse kjo kategori e ka merituar me tekst. Këtë e ka bërë pasi që islami është forcuar dhe më nuk ka pasur nevojë për kategorinë e njerëzve për t’u përforcuar zemrat e tyre.

E ka pezulluar dënimin me prerje të dorës në rrethana të krizës së urisë për shoqërinë edhe pse teksti e ligjëson një gjë të tillë, kjo është bërë pasi që shoqërinë e ka përfshirë nevoja për ushqim.

Ka ligjësuar ligjin e dënimit (me vdekje) të një grupi, nëse ata kanë bashkëpunuar në vrasjen e një individi, për të mos marrë pretekst që shumica të lirohen nga gjakmarrja.

E ka aprovuar lejimin e tri shkurorëzimeve me një fjalë të vetme, për t'i penguar që të mos e përdorin fjalën e “shkurorëzimit” pa nevojë.

I ka kthyer pronat në duart e pronarëve të tyre pas çlirimit të atyre vendeve.

Ka aprovuar taksën e *haraxhit* për të mirën e shoqërisë islame dhe për shtimin e buxhetit të fondit qendror.

Ka themeluar librin e amzës dhe të arkivës shtetërore, e shumë çështje të tjera të cilat i gjejmë në ligjet e reja.

- c. Uthmani r.a. e ka botuar Kur'anin në mus'haf dhe e ka shpërndarë në qendra islame dhe të gjitha shkrimet e mëparshme ka urdhëruar që të digjen.

Për të mos lejuar burrat që t'i shmangin gratë nga trashëgimia, e ka paraparë të drejtën e gruas që të trashëgoj edhe nëse shkurorëzohet nga burri i saj kur ai është në shtratin e vdekjes. Ky ligjësim bëhet në kundërshtim me qëllimin e tij (burrit). Këtë mendim e pranojnë Maliku, Ahmedi dhe Hanefijtë, ndërsa Shafiiu r.a. e ka refuzuar një gjykim të tillë, dhe ai mendon se në mënyrë absolute gruaja e shkurorëzuar nuk trashëgon nga burri i shkurorëzuar.

- d. Sehabet janë pajtuar për dënimin për mallin e prodhuar me të meta, i cili ka qenë i porositur. Edhe pse në esencë ata (prodhuesit) llogariten besnik në pasurinë e tjerëve. Ky gjykim bëhet për shkak të nevojës së njerëzve dhe për të mënjанuar përsëritjen e një veprimtarie të tillë në shoqëri. Për këtë çështje Aliu r.a. ka thënë: Ndryshe nuk përmirësohet shoqëria, pos me një veprim këtillë.

Debati dhe mendimi i preferuar

Nga argumentet e refuzuesve të parimit të interesit kuptohet se është e njëjtë si me çështjen e rregullit të istihsanit, ku mospajtimi nuk ka të bëjë me thelbin e çështjes së mospajtimit me drejtimin tjetër të cilët e pranojnë argumentimin me parimin e interesit sepse në të gjykuarit me parimin e interesit në të vërtetë nuk kemi të bëjmë me ligjësim sipas epshit dhe dëshirës, por kushtëzohet me kushtëzimet e rregullave të caktuara të cilat do t'i sqarojmë te tema e kushteve të të vepruarit me parimin e interesit, mirëpo çështja është se Shafiijtë edhe pse e pranojnë parimin e interesit si parim për ligjësimin e ligjeve të fikhut islam, ata janë rigoroz me të vepruarit me këtë parim, ashtu që e obligojnë bartjen e atributit të përshtatshëm në kijasin me arsyeshmëri precize, ose që e aplikojnë parimin e interesit në bazë të rregullit të sheriatit të tërësishëm, ose si parim të përgjithshëm të cilin e ka dëshmuar ligji.

Siç shihet, prej qëllimit të ligjeve të fikhut të çështjeve dytësore të cilat i ka sjellë Gazaliu në librin e tij “Mustesfa” është edhe vrasja e grupit të robërve musliman të cilët janë të prangosur dhe janë bërë mburojë e gjallë e pabesimtarëve. Raste tjera:

- Ekzekutimi i tradhtarit të fshehur i cili pendohet haptazi.
- Ekzekutimi i atij i cili nxit dhe angazhohet për të shkaktuar trazira, të cilat trazira dëmtojnë pasurinë e muslimanëve dhe shkaktojnë gjakderdhje.
- Përcaktimi i taksave për të pasurit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të ushtrisë, atëherë kur nuk mjafton prej fondit të arkës qendrore islame.

Këto shembuj tregojnë se lejohet mbështetja në parimin e interesit, me argumentimin e thënies së Gazaliut se, nëpërmjet ixhtihadit mund të jenë të përshtatshme me sa vijon: “Ne interesin e kemi kthyer në bazën e qëllimeve të sheriatit dhe qëllimet e sheriatit kuptohen prej Kur’anit, sunetit dhe ixhmait, dhe çdo interes nuk do të thotë se mund të kthehet në qëllimin e kuptuar prej Kur’anit, sunetit dhe ixhmait. Këto janë interesa të habitshme (të rralla) me të cilat nuk mund të hasim të ketë vepruar ligji. Këto paraqitje janë të pavlefshme, kush ligjëson me ta, ai ka ligjësuar ligj në vete, njësoj sikurse ai i cili ligjëson me istihsanë, ai ka ligjësuar ligj në vete. Çdo interes i cili kthehet në bazën e sigurimit të ligjit, ai interes kuptohet nëpërmjet qëllimit të sigurisë prej Kur’anit, sunetit ose ixhmait, dhe nuk mund të jetë

jashtë kornizave të këtyre bazave, mirëpo nuk quhet kijasë por quhet parim interesi, pasi që kijasi është bazë e përcaktuar, mirëpo koncepti i parimit të interesit nuk perceptohet vetëm prej një argumenti por prej argumenteve të shumta të përkufizuara prej Kur'anit dhe sunetit, dhe prej faktorëve rrethanor dhe të shenjave dalluese, e cila quhet parim (koncept) i interesit. Nëse e interpretojmë parimin e interesit, atëherë nuk ka çka të kundërshtohet në pasimin e saj, por duhet që patjetër ta llogarisim argument.”²⁵ Kjo është deklaratë e qartë në pranimin e parimit të interesit sepse ata të cilët e pranojnë parimin e interesit e kushtëzojnë që të jetë në harmoni me qëllimet e Ligjvënësit.

Atë çka nuk e pëlqejnë Shafiijtë nuk është se e sulmojnë parimin e interesit në mënyrë absolute por i kundërshtojnë interesat të cilat Ligjvënësi nuk i llogarit interesa, qoftë edhe në mënyrë të përgjithshme, e që në esencë këto as që llogariten si interesa.

Vetëm se rrethi i parimit të interesit të Shafiijtë është më i ngushtë se sa të të tjerët, në esencë ai parim nuk është parim në vetvete.

Nga kjo kuptohet se në esencë të gjithë dijetarët janë pajtuar për veprimin me parimin e interesit. Kjo shihet qartë në thënien e Ibni Dekikë el Ijd kur thotë²⁶: Nuk e urrej atë që e llogarit si bazë interesin, mirëpo interesin i cili në esencë nuk është interes dhe që ka nevojë për analizë të thuktë, sepse ndonjëherë ndonjë interes del prej kufirit të interesit të vërtetë. Ai po ashtu ka thënë: “Nuk ka dyshim se për këtë lloj, përparësi ka Maliku ndaj të tjerëve, pastaj e pason Ahmed bin Hanbeli”, me një fjalë edhe të tjerët janë shumë afër tyre, mirëpo këto dy veçohen në praktikumin e interesit ndaj të tjerëve.

Dijetari Karafiju i drejtimit Malikij thotë: Në të vërtetë parimi i interesit praktikohet të të gjithë medhhebet sepse ata i analogojnë dhe i dallojnë në raste të shumta dhe nuk kërkojnë dëshmi për ta llogaritur dhe këtë formë të veprimit e quajmë *parim të interesit*.

Shatibiju ka thënë:²⁷ Në argumentimin me parimin e interesit janë mbështetur Maliku dhe Shafiiju, edhe pse në një gjykim dytësor nuk është hasur dëshmi bazike e caktuar por është hasur dëshmi bazike e përgjithshme.

Përfundim: Dijetarët ndryshojnë në masën e të vepruarit me të:

- Më së shumti e praktikon Maliku,
- pastaj e pason Ahmedi,
- pastaj Ebu Hanife,
- pastaj Shafiiju.

Por ne e mbështesim Gazaliun dhe Ibnu Dekikë el Ijdin për domosdoshmërinë rezervë të të vepruarit me këtë veprim, sepse realizimi i këtij ka nevojë për perceptim të thuktë dhe për aprovim të ligjeve me të (parim të interesit) nevojitet studim i thellë.²⁸

Si e llogaritë Shafiiju interesin?

Të argumentuarit me interes, quhet aprovimi i dispozitës në bazë të logjikës së përgjithshme të teksteve të sheriatit të cilat tregojnë llojin e ligjeve prej të cilave ka interes.

Parimi i interesit bën pjesë brenda llojit ligjor të cilat Ligjvënësi i ka paraparë se janë të dobishme në përgjithësi, por pa i definuar me ndonjë argument të caktuar, ose janë interesa në përputhshmëri me llojin e praktikës së Ligjvënësit.²⁹

Është vërtetuar se Shafiiju e aplikon parimin e interesit në këtë koncept, mirëpo ai këtë e bën nën ombrellën e kijasit. Tek ai, kijasi është: kërkimi i argumentit në përputhshmëri me tekstin (lajmin) e mëparshëm prej Kur'anit dhe sunetit sepse ato janë dituri e vërtetë prej të cilave është obligim të kërkohet.³⁰ Kjo përputhshmëri me lajmërimin (prej Kur'anit dhe sunetit) është praktike me parimin e interesit. Argumentet për këtë janë me sa vijon:³¹

1. Siç e parasheh Shafiiju: llogaritjen e atributit të cilin e llogaritë Ligjvënësi si atribut të llojit të tij e cila është burim i kijasit. *Shembull:* Dënimi i alkoolistit me dënimin e shpifësit (ndaj grave të ndershme), analog me të vetmuarën me të panjohurën duke pasur parasysh se në të dy rastet, edhe në bazë, edhe në degë, e presupozuara ligjësohet në bazë të presupozimit, kështu që merret vendim i të presupozuarës (bazë) në të presupozuarën (degë), mirëpo te ta ky mendim është mendimi më preferues.³²

Vërehet se, parimi i interesit është parim i përputhshmërisë. Përputhshmëria (harmonia) është: të vendosurit nën llojin të cilin Ligjvënësi e llogaritë në mënyrë të përgjithshme por pa e definuar me argument konkret të përcaktuar.

2. Sa i përket mendimit të Hanefijëve për Shafiijtë, është se e pranojnë parimin e interesit por si interes në harmonizim.³³

3. Deklarimi i Malikijëve është se, i mbështesin Shafiijtë në argumentimin e interesit të papërcaktuar.³⁴

4. Deklarimi i Shevkanijut është se, Shafiijtë e pranojnë parimin harmonizues të interesit, i cili deklarim është transmetuar nga Ibni Burhani në “Vexhizë” (libër i tij) dhe nga Imami i dy haremeve.³⁵

5. Deklarimi i Zenxhanijut, dijetarit dhafiijtë, është se, dhafiijtë e pranojnë interesin harmonik. Ai në deklarin e tij thotë: Shafiiju shkon në atë drejtim se të bazuarit në parimin e interesit është të bazuarit në ligjin e sheriatit në përgjithësi edhe pse ai nuk është mbështetur në çështjet dytësore të cilat posaçërisht janë të nënvizuara, ato janë të lejuara.³⁶

6. Imam Haremejni i cili është dijetarë Shafiijtë, ka thënë se të vepruarit me parimin e interesit i ngjanë të vepruarit me atë që llogaritet në interes të ligjit.³⁷

7. Thënia e Shafiijtut se lejohet kijasi në shkaqe. Kjo ka kuptimin se lejohet të vepruarit me parimin e interesit, siç e kanë paraparë shumica absolute e dijetarëve.³⁸

8. Argumentimi i Shafiijtut me parimin e interesit ose me konceptin e mbështetjes së përgjithshme të sheriatit në përpilimin e rregullave bazë të usulit.³⁹

Teoria e parimit të interesit te Gazaliu

Gazaliu ka bërë analizë në lidhje me parimin e interesit apo të interesit në librat e tij të usulit: “El – Menhulë”, “El Mustesfa”⁴⁰ dhe “Shifaul Galijl”. Në librin “Mustesfa” parimin e interesit e ka definuar kështu: **Është një term që në esencë ose sjell dobi ose e largon dëmin** dhe ne nuk e pranojmë këtë kuptim, sepse sjellja e dobisë dhe largimi i dëmit është prej qëllimeve të njerëzve dhe interesi i njerëzve është që t’i realizojnë qëllimet e tyre, por ne me termin e interesit kemi për qëllim sigurimin e qëllimit të ligjit (shariatit). Qëllimet e shariatit për njerëzit janë pesë: ***që t’u sigurohet feja, jeta, mendja, pasardhësit dhe pasuria e tyre***. Çdo gjë e cila e mbështet sigurinë e këtyre pesë bazave quhet parim i interesit dhe çdo gjë e cila i dëmton këto baza quhet e dëmshme, ndërsa largimi i atij dëmi quhet interes.

Klasifikimi i parë: Klasifikimi i interesit në bazë të dëshmimit të shariatit ⁴¹

Në bazë të kësaj Gazaliu interesin e ka klasifikuar në tri kategori:

1. Atë interes të cilin e dëshmon shariati: Kjo kategori është argument dhe realizohet nëpërmjet kijasit.⁴² Kjo kategori është rezultimi i dispozitës prej logjikës së tekstit apo ixhmait. *Shembull:* Siç kemi treguar se çdo pije apo ushqim dehës është i ndaluar në bazë të analogimit të pijes alkoolike sepse është ndaluar për shkak të sigurimit të mendjes e cila është kandari i pranimit të obligimit sepse ndalimi i alkoolit nga ana e shariatit është argument për të vërejtur këtë interes.

2. Atë që shariati e zhvlerëson:

Shembull: Thënia e disa dijetarëve, drejtuar disa mbretërve për shkak të kontaktimit gjatë ditës së agjërimit të Ramazanit: Ti e ke obligim që t’i agjërosh dy muaj rresht. Dhe nuk i thotë për të liruar një rob, për shkak se pasi që ka pasuri të shumtë mendon se, nëse i them këtë, për atë (mbretin) do të ishte çështje e lehtë dhe për të liruar një rob përball çështjes së realizimit të epshit të tij do ta konsideronte si diçka të thjeshtë. Kështu që, do të ishte në interes të tij për ta obliguar me agjërim si ndëshkim për të.

Kjo thënie dhe një gjykim i tillë është i papranueshëm dhe i pavlefshëm dhe është në kundërshtim me tekstin e Kur’anit sa i përket interesit dhe

hapja e këtij kapitulli do të shkaktonte ndryshimin e të gjitha ligjeve të dënimit dhe teksteve për shkak të ndryshimit të gjendjeve. Përpos kësaj, një veprim i tillë, do të humbte besimin tek dijetarët dhe tek fetvat e tyre nga ana e mbretërve, sepse do të mendonin se çdo fetva e tyre do të ndryshonte për shkak të mendimit të tyre (dhe jo të sheriatit).

3. Atë që Ligjvënësi as nuk e ka paraparë të zhvlerësohet dhe as të fuqizohet me ndonjë tekst të caktuar: Kjo është çështje e cila duhet të studiohet.

Përfundim: Ky është kategorizim i parimit të interesit për të cilin nuk ekziston tekst i caktuar as për ta fuqizuar dhe as për ta zhvlerësuar. Nga ky kategorizim përfitohet kushtëzimi i kushtit të parë i parimit të interesit, e ai kusht është që të mos dëshmohet prej sheriatit ndonjë tekst i caktuar as për zhvlerësimin dhe as për fuqizimin e interesit në fjalë.

Klasifikimi i dytë: Klasifikimi i interesit në bazë të fuqisë së saj

Parimi i interesit – e cila nuk është e nënvizuar me ndonjë tekst të caktuar, bën pjesë nën burimin e kijasit, dhe e cila as nuk është e zhvlerësuar me ndonjë dëshmi e cila e zhvlerëson atë, klasifikohet në tri kategori:

- Ajo çka kategorizohet në **domosdoshmëritë**;
- Ajo çka kategorizohet në **plotësimin e nevojave**;
- Ajo çka është e ndërlidhur me atë çka e **zhvillon dhe e plotëson atë**.⁴³

1. **Domosdoshmëritë** – Është kategoria e parë dhe kategoria më e fuqishme e interesit. Është kategoria e cila i siguron pesë bazat: **fenë, jetën, mendjen, pasardhësit dhe pasurinë**.

Shembuj të sigurimit të fesë: Vendimi për vrasjen e jobesimtarit sulmues; ndëshkimi i atij i cili sjell risi dhe thërret në risinë e tij sepse kjo e largon shoqërinë nga feja.

Shembuj të sigurimit të jetës: Vendimi për gjakmarrje sepse kështu sigurohen jetët.

Shembuj të sigurimit të mendjes: Vendimi për dënimin e alkoolistit sepse kështu sigurohen mendjet të cilat i pranojnë obligimet.

Shembuj të sigurimit të pasardhësve: Dënimi për prostitucion sepse kështu sigurohet gjaku, gjeni (fisi) dhe pasardhësit.

Shembuj të sigurimit të pasurisë: Dënimi për uzurpuesin, vjedhësin, sepse me këto dënime sigurohet pasuria me të cilën jetojnë njerëzit dhe është e patjetërsueshme për të (atë pasuri).

Plotësimi i domosdoshmërive. *Shembull*: Në zbatimin e dënimit të gjakmarrjes të bëhet barazim i plotë sepse ndëshkimi është paraparë për shërim, e kjo nuk realizohet nëse nuk bëhet në mënyrë të barabartë. *Shembull tjetër*: Ndalimi edhe i sasisë së vogël të alkoolit sepse ndikon për shtimin e sasisë, kështu që analogohet me verën.

2. **Nevojat** – Nevojat e interesit të përshtatshmërisë së rasteve të ndryshme, si f.v., e drejta e kujdestarit për ta martuar vajzën apo djalin e mitur. Në këtë nuk dëmtohen (vajza/djali) por përkundrazi kanë nevojë për ta realizuar dobinë (të mirën).

Plotësimi i nevojave – *Shembull*: Vajza e vogël martohet vetëm me mehrin e ngjashëm, edhe në këtë ka përshtatshmëri, por pa pasur nevojë për kurorëzim.

3. **Përsosmëritë** dhe zbukurimet e elementeve me programet më të mira, si në adhurime (ibadete), po ashtu edhe në raportet reciproke, si f.v., kushtëzimi i kujdestarit dhe dëshmitarit në *aktin e kurorëzimit* sepse kjo është në përputhje me traditat e mira dhe kjo bëhet që t'i iket turpërimit të femrave sepse ato ngushtohen dhe nuk iu shkon për shtati që ta kryejnë aktin e kurorëzimit në prezencë të burrave, e për këtë arsye i është dhënë e drejta asaj që ta autorizoj kujdestarin që ta bëjë aktin e kurorëzimit sepse kjo është një procedurë më e përshtatshme. Po ashtu edhe dëshmimi i dëshmitarëve është paraparë për ta ngritur vlerën e kurorëzimit dhe që të dallohet dhe që të çmohet me publikimin dhe lajmërimin.

Interesat e domosdoshmërive gjykohen edhe pse nuk kanë ndonjë dokumentim të caktuar, si f.v., vrasja e një numri të të arrestuarve musliman nëse pabesimtarët i bëjnë mburojë të tyre dhe kjo (vrasja) bëhet për të shpëtuar të gjithë muslimanët nga vrasja.

Përderisa, sa i përket nevojave apo përsosmërive, nuk gjuhen në mënyrë absolute pa pasur ndonjë dokumentim i cili mbështetet në bazë (ligjore).⁴⁴

Nga ky klasifikim merret për bazë kushtëzimi i kushtit të dytë për të vepruar me parimin e interesit të Gazaliu, i cili është: që të jetë interesi në kuadër të ndodhive që hynë në kategorinë e domosdoshmërive ose çka i takon domosdoshmërive.

Klasifikimi i tretë: Klasifikimi në bazë të përshtatshmërisë dhe përgjithshmërisë apo tërësisë

Parimi i interesit mund të jetë:

- Ose interes i përshtatshëm me llojin e interesave me të cilat ka vepruar Ligjvënësi.

- Ose e interesit të rrallë, për të cilin Ligjvënësi ka heshtur dhe nuk e ka treguar me ndonjë argument dhe nuk kundërshtohet me tekstin dhe Ligjvënësi nuk ka sjellë dëshmi për llojin e tij. Ky klasifikim është vërejtur në Librin “Mustesfa”⁴⁵ të Gazaliut, ku thotë: “Çdo interes i cili nuk ka të bëjë me sigurimin i cili kërkohet nga Kur’ani, suneti dhe ixhmai, dhe është prej interesave të rralla, e cila nuk është në përputhshmëri me veprimtarinë e Ligjvënësit, ai është i pavlefshëm, dhe kush anon në drejtim të atij interesi ai ka ligjësuar ligj në vete, njësoj sikurse të ketë ligjësuar parimin e istihsanit në vete, dhe çdo interes i cili ka të bëjë me sigurimin i cili kërkohet nga Kur’ani, suneti dhe ixhmai, dhe nuk është jashtë kornizave bazike, nuk quhet kijasë por parim i interesit sepse kiasi ka bazë prej një argumenti të caktuar por koncepti i këtyre interesave nuk kuptohet nga një argument, por nga argumente të shumta, të cilat nuk mund të numërohen, dhe të cilat janë prej tekstit (Kur’anit) dhe sunetit dhe dokumentimeve të rasteve të shumta dhe të ndryshme. Për këtë arsye edhe quhet parim i interesit të çrregullt. Nëse interesin e interpretojmë interes për të cilin ka për pikësynim ligji, nuk ka hapësirë për t’u kundërshtuar, por patjetër duhet llogaritur si argument.”

Nga ky klasifikim, pra në bazë të përgjithshmërisë, parimi i interesit klasifikohet në:

1. **Parim i interesit i përgjithshëm;** dhe

2. **Parim i interesit të veçantë,** ashtu siç i ka përmendur Gazaliu në librin “Mustesfa”,⁴⁶ pasi që e ka ilustruar me shembullin e mburojës së gjallë të domosdoshmërisë. Pastaj ka thënë: Ky shembull i parimit të interesit nuk është marrë nga rruga e kijasit prej një baze të caktuar dhe e ka kritikuar në bazë të tri attributeve duke thënë: *Ajo është domosdoshmëri e prerë e tërësishme.*

Përfundim: Gazaliu i kushtëzon tri kushte për të vepruar me parimin e interesit, e ato janë:

E para: Harmonizimi i interesit me llojin e veprimtarisë së Ligjvënësit dhe kjo është peshorja e pranimi apo refuzimit të të vepruarit me parimin e interesit.

E dyta: Mosndeshja e interesit me tekstin e sheriatit, e që në esencë ky është kushti i titullimit të parimit të interesit.

E treta: Që interesi të jetë i domosdoshëm, qoftë edhe në të drejtë të një personi, ose nevoja e përgjithshme e të gjithë shoqërisë.

Sa i përket kushtit të përgjithshëm apo të tërësishëm, kjo nuk kërkohet, vetëm se është kërkuar te rasti i murit (mburojës) të gjallë sepse është kusht i domosdoshëm i parimit të përshtatshëm të llojit të veprimtarisë së Ligjvënësit.⁴⁷

Sa i përket kushtit të prerë, nuk kërkohet që të jetë në koncept të përgjithshëm, por ai duhet të jetë i sigurt, e me kuptimin *i sigurt*, kemi për qëllim të mendohet se në të shumtën e rasteve sjell interes ose të jetë përafërsisht i prerë.⁴⁸

Nga ky aspekt, nëse interesi bie ndesh me tekstin, sipas Gazaliut nuk veprohet me atë interes sepse ai ka deklaruar se interesi nuk mund të bie ndesh me tekstin. Nëse bie ndesh, ai interes përjashtohet dhe nuk bazohet me të dhe nuk dispozitohet duke u bazuar në të.

Nëse teksti nuk mund të interpretohet në atë interes sepse të vepruarit me parim të interesit përball atij teksti e shkatërron tekstin.

Ndërsa nëse teksti mund të interpretohet në atë interes apo siç quhet te Shafiijtë *tekst i qartë*, atëherë ai interes lejohet të specifikohet, ose mund të bëhet sqarim i qëllimit të atij teksti dhe mund t'i jepet përparësi njërit kuptim prej saj, pasi që te shumica absolute e dijetarëve, e prej tyre edhe Gazaliu, tekstin e përgjithshëm e konsiderojnë prej kategorisë së tekstit të qartë e cila mund të interpretohet në më shumë se një kuptim, ndërsa specifikimi i tij është sqarim i tij dhe nuk konsiderohet abrogim i tij.⁴⁹

Te Gazaliu, parimi i interesit nuk është bazë e pavarur nga tekstet e sheriatit, por është për të siguruar qëllimet e sheriatit të cilat kuptohen prej Kur'anit, sunetit dhe ixhmait, dhe është specifikim i tekstit parcial prej atyre teksteve të cilat dëshmojnë llojin e interesit.

Te Gazaliu, parimi i interesit llogaritet brenda kornizës së kijasit, ndërsa tek të tjerët jashtë kornizës së kijasit, sepse te ai, kijasi është kalimi i vet dispozitës nga vet teksti në rastin e vendit ku nuk është teksti, me arsyeshmërinë e cila është obligative në rastin (vendin) e tekstit dhe nga shkaku se te shumica absolute kijasi mund të specifikohet, e i mendimit të

tyre është edhe vet Gazaliu, atëherë rezulton se specifikuesi i tekstit në esencë nuk është parim i interesit si parim në vete.⁵⁰

Teoria e parimit të interesit të Hanefijjtë

Prej asaj çka kemi thënë më herët, e kemi kuptuar se parimi i interesit është: Interes në përshtatshmëri apo në frymën e llojit të veprimtarisë së Ligjvënësit, ashtu që bën pjesë brenda llojit të ligjeve të cilat Ligjvënësi i llogarit si të dobishme, por pa ndonjë fakt apo argument të caktuar (specifik).

Argumenti specifik: Është argumenti i cili dëshmon në mënyrë konkrete për interesin, përderisa parimi i interesit nuk dëshmon për interesin në mënyrë konkrete, por dëshmon llojin e interesit.

Nga ky koncept, shihet se është afër përputhshmërisë së veprimit të dijetarëve të medhhebeve tjera, e ajo është: Parimi i interesit (apo *përshtatshmëria*, tek disa ekspert të usulit quhet kështu) dhe mbështetja e prodhimit (përpilimit) të arsyeshmërisë së kijasit për atë rast (atë ndodhi) dhe të istihsanit. Kjo dëshmon se Hanefijjtë i zgjerojnë rregullat e parimit të interesit,⁵¹ siç shihet qartë në pjesën që do ta tregojmë në tri çështje në vijim:

E para: Harmonia

Për dallim nga shumica absolute, Hanefijjtë e kushtëzojnë që atributi i cili duhet të jetë i vlefshëm, duhet të jetë më i fuqishëm dhe mbi dispozitën, ashtu që të ketë ndikim në dispozitën e ardhshme,⁵² dhe e definojnë ndikimin me atë çka e përfshin interesin edhe pse nuk e deklarojnë atë.

Ndikimi: është atëherë kur kuptohet prej tekstit apo ixhmait, se atributi konkret është harmonik me dispozitën konkrete ose atribut i llojit harmonik me llojin e asaj dispozite. Këtë veç e kemi sqaruar në kapitullin e kijasit, përderisa këtu do të shtoj si në vijim:

Shembulli kur Ligjvënësi e llogarit atributin konkret në dispozitën konkrete: Rrethrotullimi (i maces) është shkaktar i përcaktimit të pastërtisë. Kjo është argumentuar me tekstin e hadithit të Muhamedit a.s.: *Ato (macet) janë prej*

rrethrrrotullueseve dhe rrethrrrotulluesve tuaj. Atributi konkret është llogaritur *rrethrrrotullimi*, e cila është tekstformulim i dispozitës së caktuar dhe konkrete e cila është pastërtia, pasi që ekziston pajtueshmëria e shumë në mes të rrethrrrotullimit dhe pastërtisë dhe lehtësimin e njerëzve nga vështirësia pasi është e pamundur shmangia prej saj.

Shembull: Kur Ligjvënësi e llogarit atribut të llojit në një dispozitë të dispozitës: Plotësimi i kushteve për t'u gjendur në domosdoshmëri është masa për t'u ligjësuar largimi i dëmit, e ajo është se Ligjvënësi e ka ndaluar shitblerjen e llojit **“rukbanë”** për shkak të atributit: Sjellja butësisht me banorët vendas të qytetit dhe largimin e dëmit nga ata dhe e ka ndërlidhur dispozitën me ndalesën, për t'ua larguar krizën (vështirësinë) prej tyre, pasi që është plotësuar kushti i indikacionit. Kështu me të analogohet tek çdo rast i cili ka kuptim të njëjtë. *Shembull:* Dispozita për prishjen e murit të anuar (në prag të rrëzimit) për ta larguar kanosjen e rrezikut për kalimtarët. Kështu, baza dhe dega kanë një pikë të përbashkët në llojin e dëmit i cili është atribut i dispozitës. Dëmi i cili shkaktohet për kalimtarët është një lloj tjetër dëmi, mirëpo që të dy dëmet janë një lloj dëmi, e për këtë arsye merret i njëjti vendim (dispozitë), pra vendimi për ta larguar dëmin. Po ashtu, kjo analogji e vërteton edhe vlefshmërinë se, Ligji e ka lejuar shit-blerjen e pasurisë së borxhliut. Për këtë arsye është plotësuar kushti i rrënimit të murit, pasi që Ligjvënësi e konsideron atribut të llojit dhe cilësi në dispozitë prej llojit të dispozitave, e ajo është mënjanimi i dëmit nëpërmjet dispozitës së largimit të dëmit.

Shembull tjetër: Ligjvënësi e konsideron se vështirësia e udhëtimit është shkak i shkurtimit të namazit dhe bashkimit të namazeve, po ashtu lejimi i mosagjërimit, tejemumi, si dhe sëmundjen e konsideron shkak për lejim të mosagjërimit, tejemumit, dhe lejimin e të falurit ulur. Përsëritjen e të njëjtës vështirësi e konsideron shkak të lejimit të mosfaljes siç është rasti me menstruacionisten. Këto lloje të vështirësive i bashkon një lloj, e ajo është *vështirësia*. Ky lloj është shkak që të merren vendime të shumta të cilat hynë brenda një lloji, e ajo është *largimi i dëmit dhe i vështirësive*.

Me këtë parim analogohet lejimi i mjekut që të shoh organet e turpshme për shkak të nevojës së shërimit dhe largimit të vështirësisë, e ajo vështirësi është dhembja dhe sëmundja. Ligjvënësi nuk e ka paraparë (llogarit) as me tekst dhe as me ixhmaë vështirësinë e sëmundjes si model (formulë) për t'u lejuar që të shihen organet e turpshme, por Ligjvënësi ka paraparë (llogaritë) lloje të shumta të attributeve të cilat ndryshojnë nga ky atribut, por që janë të

llojit të atij atributi dhe janë formulim dhe model te dispozita të shumta të cilat ndryshojnë me këtë dispozitë, por që janë të këtij lloji të dispozitës, e që ai atribut ndikon që të llogaritet lloj atributi në llojin e dispozitës dhe lloji i atributit është *vështirësia*, ndërsa lloji i dispozitës është *largimi i vështirësisë*.

Shembull tjetër: Privimi nga trashëgimia i vrasësit të trashëgimlënësit. Këtë e ka nënvizuar (tekstualizuar) Ligjvënësi për arsye se është e mundur se e ka vrarë trashëgimlënësin për ta përshpejtuar të drejtën e trashëgimisë. Kjo analogohet me të shkurorëzuarën që trashëgon, të cilën burri e shkurorëzon për t'ia humbur të drejtën e trashëgimisë. Kështu: Vrasja e trashëgimlënësit dhe shkurorëzimi (i gruas) në momentin kur trashëgimlënësi është në shtratin e vdekjes (në prag të vdekjes), janë dy lloje të ndryshme të atributit ligjor, por që përputhen, sepse që të dyja mund të ndodhin me qëllim që të veprohet një ndalesë (haram). Mostrashëgimia e të shkurorëzuarës dhe mostrashëgimia e vrasësit (trashëgimtar) janë dy lloje të ndryshme ligjore, mirëpo që të dyja i vendosim në një lloj të vetëm, e ai lloj është: Në të dy rastet veprojmë në bazë të ligjit (parimit) të vepruarit të kundërt me qëllim, e ai qëllim është *haram* (i ndaluar).

Ky është argument se një lloj i atributit akuzues është arsyetim për të formuluar ligj të llojit të ligjit i cili rezultohet nga ai atribut. Ky është indikacioni i kërkuar për të vepruar me arsyeshmërinë në kijasë (analogji).

Përfundimi i çështjes: Përshtatshmëria e interesit i bashkëngjitet parimit të interesit, dhe siç ka deklaruar Kemal bin Hemami,⁵³ është vet parimi i interesit. Interesi i përshtatshëm është i pranuar te shumica absolute e dijetarëve të Hanefijëve, përderisa autori i librit “Muslimu Thubut”,⁵⁴ përshtatshmërinë e interesit (me tekstin) nuk e quan parim të interesit, duke e përkufizuar me interes të rrallë (të izoluar), që do të thotë, parim i rrallë i interesit.

Te Hanefijtë, përshtatshmëria me ligjin ndikon në ligje dhe te ta llogaritet argument. Ata parimin e interesit e deklarojnë nga ky drejtim, sepse përshtatshmëria e interesit nuk është atribut me të cilin është ligjësuar ligji bazë dhe nuk është rezultat as prej tekstit, as prej ixhmailt, se është atribut i ndonjë ligji konkret, por ekziston tekst ose ixhmaë, të cilët e llogaritin atribut të llojit në lloj të ligjit i cili ndikon në të ose që orienton në të. Ky është koncepti i ndikimit te ta, i cili përfshinë dy forma:

E para: Tregueshmëria e tekstit ose e ixhmailt, se lloji i atributit është formulë ose arsyeshmëri ose indikator në lloj të ligjit, që do të thotë: që

Ligjvënësi të nënvizoj, ose të themelohet ixhmai, se atributi është ndryshe nga atributi, por që është prej llojit të tij, është formulë e ligjit i cili është ndryshe nga ligji tjetër, por që është i të njëjtit lloj. Nuk është qëllimi që të ekzistoj tekst i qartë se, vështirësia imponon lehtësimin apo interesi i përgjithshëm ka përparësi ndaj interesit të veçantë, sepse, kjo do të ishte prej formës së prerë.

E dyta: Tregueshmëria e tekstit apo e ixhmait që, një tekst konkret është formulë e një ligji konkret, si f.v., tavafi (konkret) të jetë formulim i pastërtisë (konkrete).

Nga kjo rezulton se parimi i interesit është arsyeshmëri e cila i plotëson kushtet që të ketë *indikacion*, të cilën e kërkojnë Hanefijtë për vlefshmërinë e arsyeshmërisë me arsyetime. Në të kundërtën, përshtatshmëria e interesit do të ishte parim i interesit dhe rezultati do të ishte, deklarim i Hanefijëve për parimin e interesit si përshtatshmëri e interesit, në frymën e llojit të ligjeve me të cilat ka vepruar Ligjvënësi, ashtu siç deklarojnë Malikijtë dhe të tjerët.

Vërehet se, argumentimi i përshtatshmërisë së ligjeve të interesit është, kijasi te dijetari Shemsul-Eimeti Sarhasiju dhe Fahrul Islami Bezdaviju. Autori i librit “Muslimu Thubut” thotë se: Në esencë është kijasë,⁵⁵ sepse kijasë nuk do të thotë vetëm të barazuarit e bazës me degën në të njëjtën arsye dhe në të njëjtin ligj, por përfshinë edhe përbashkësinë e bazës me degën në llojin e arsyeshmërisë, përderisa ligji ka për qëllim bartjen e degës prej llojit të ligjit bazik.

Shihet edhe një grupim tjetër i Hanefijëve, të cilët thonë: Përshtatshmëria e cila ndikon në llojin e tij të llojit të ligjit quhet arsyeshmëri e sheriatit e cila është rezultat i mendimit, ixhtihadit dhe prodhimit, mirëpo ideja e mendimit nuk është prodhim i mendjes, por prodhim prej tekstit të Ligjvënësit. *Shembull: Rregulli: Dëmi mënjanohet.* Është arsyeshmëri e sheriatit e vendosur prej mendimit dhe si prodhim prej tekstit të Ligjvënësit duke pasur parasysh se dëmi është formë për ligjësim ku i bashkëngjitet ligji, **të larguarit e dëmit.**

Ky grup (i Hanefijëve) pajtohet me deklarimin e Shatibijut: Koncepti i cili formohet prej teksteve të sheriatit, prej saj muxhtehidi e zbaton në çështje dytësore, ashtu siç e zbaton të përgjithshmen e cila rezulton nga teksti pa pasur nevojë të procedohet kijasi ose burime tjera.

Ky mendim përputhet me deklaratën e Gazaliut, kur thotë se: Kur muxhtehidi plotëson elementet e realizimit të qëllimit deri te qëllimi i sheriatit, atëherë ai qëllim i arritur llogaritet argument i prerë dhe më pastaj muxhtehidi nuk ka nevojë që të zbatojë nënçështje parësore në tekst specifik. Dhe, kur Gazaliu thotë: Kur ta interpretojmë interesin se është sigurues i qëllimit të sheriatit, atëherë ajo është argument i prerë dhe nuk lejohet që të kundërshtohet.⁵⁶ Me këtë ka për qëllim atë që e kanë për qëllim një pjesë e dijetarëve Hanefijë, që do të thotë: Arsye sheriatike e prodhuar nga mendimi, ose në kuptim të përgjithshëm *i realizuar prej teksteve*.

Pasi që qëllimi është i realizuar prej parimit të interesit: Është ajo çka llogaritet atribut i llojit në lloj të ligjit, por pa ndonjë tekst i cili tregon se llogaritet lloj atributi në llojin e ligjit për ta proceduar kijasi, atëherë Hanefijët, Malikijët dhe Shafijët, pajtohen për këtë parim të interesit.

E dyta: Istihسانی i Hanefijëve

E kemi sqaruar esencën e istihsanit dhe llojet e tij të Hanefijët, dhe atë se ai është të vepruarit me argument sheriatik dhe se nuk është ligjësim sipas epshit dhe dëshirës, dhe se ajo është istihsanë me tekst, ose me ixhmaë, ose me kijasë të fshehtë, ose për shkak të domosdoshmërisë, ose të interesit, ose të traditës, dhe si përfundim i të gjitha këtyre është se kjo është paraqitje për kijasin i cili shpie në teprim të ligjësimit, ose në hiperbolizim të tij, ose në përjashtim të çështjes parciale nga ajo e tërësishme, ose në përjashtim prej rregullës së përgjithshme duke u bazuar në argumentim specifik në të dy rastet.

E vërteta është se, të gjitha llojet e istihsanit, përpos istihsanit të tekstit, në esencë janë istihsanë të interesit, sepse, istihسانی i domosdoshmërisë bëhet për interes.

Interesi llogaritet ose për shkak të domosdoshmërisë, ose për shkak të nevojës.

Istihسانی me traditë, në esencë kthehet në interesin e nevojës së përgjithshme.

Interesi me ixhmaë mbështetet në sigurinë e interesit të domosdoshëm apo nevojës së përgjithshme, pasi që nevoja e përgjithshme zbret në vendin e domosdoshmërisë.

Istihsani me kijasin e fshehtë është përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, apo teksti, apo nga baza e tërësishme e përgjithësuar e përfituar nga formula e fjalës, e cila na obligon t'i japim kuptimin e fuqishëm ndikues, i cili në esencë realizon interes, ose e mënjanon dëmin apo vështirësinë e tepërt.

Kjo na orienton në atë se istihsani i fshehtë është sikurse istihsani i Malikijëve, pra nuk është *deklarim mendimi* ose ligjësim i epsheve dhe dëshirave, e as qëndrim i shijeve apo çka i përshtatet dëshirave njerëzore, por është anashkalim i rregullit të përgjithshëm apo kijasit, kur nuk mund të arrihet deri te një formulim i një rregulli, ose prodhim i një arsyeshmërie të një kijasi në çështjen e paraqitur dhe kjo prej argumenteve të sheriatit për të cilat nuk ka papajtueshmëri.

Në esencë, mbështetja e istihsanit është në sigurimin e interesit e cila është e dëshmuar prej teksteve të sheriatit, pa marrë parasysh a dëshmohet me tekst konkret, apo është në bazë të logjikës së ndonjë teksti konkret, apo të logjikës së një numri tekstesh të cilat janë në pajtueshmëri të një kuptimi. Nëse kthehemi te burimi i istihsanit, shohim se istihsani është të vepruarit me interesin parcial përball bazës së përgjithshme, apo kijasit të rregullt. Ky interes është realizuar dhe veç është kuptuar prej tekstit. Fekihi, deri aty mund të arrijë nëpërmjet arsyeshmërisë së fshehtë por që ka ndikim të fuqishëm me frymën e të vepruarit të Ligjvënësit. Mund të jetë rregull që të konsiderohet interes interesi i patjetërsueshëm, apo i nevojshëm, i cili na shpie deri te ky përjashtim prej bazave⁵⁷, dhe atëherë, në esencë tekstin nuk e specifikojmë me parimin e interesit, por me istihsanin e fshehtë. Në të vërtetë istihsani i fshehtë është kijasi të cilit i është fshehur vetëm arsyeshmëria dhe analogohet me një tekst tjetër, dhe sipas shumicës absolute të dijetarëve kijasi e specifikon tekstin.

E treta: Çka llogaritet përshtatshmëri apo zëvendësim.

Në temën e kijasit është kuptuar se përshtatshmëria, apo zëvendësimi, është prej rrugëve të vërtetimit të arsyetimit të prodhuar, dhe ajo tregon për atë se Ligjvënësi mund ta konsideroj atribut të përshtatshëm të arsyes, mirëpo pasuesi ndonjëherë *mund ta konsiderojë* të parealizueshëm, e kjo kur Ligjvënësi e anulon atë atribut.

Për këtë arsye, Hanefijtë deklarojnë se, përshtatshmëria nuk llogaritet përshtatshmëri në vetvete, deri sa kështu mos ta llogaritë Ligjvënësi me tekst, ose me ixhmaë, që do të thotë se, ata e kushtëzojnë që të ekzistoj teksti apo ixhmai për atë atribut si argument për formulimin e dispozitës. Nëse rezulton një ligj për një ndodhi dhe nuk ka tekst apo ixhmaë në formulimin e atij ligji, te Hanefijtë, ai ligj ndalet vetëm në atë ndodhi dhe muxhtehidi nuk ka të drejtë të prodhoj arsyeshmëri prej saj, apo formulim të atij ligji, e që ai formulim të bartet te një ndodhi tjetër.

Vërehet se, atë që e deklarojnë dijetarët Hanefijë të usulit në këtë kuptim, ka të bëjë me kushtëzimin e ndikimit në arsye, që do të thotë, e llogaritur si interes prej tekstit apo ixhmait. Unë e shoh se ndonjëherë në fikhun Hanefijë kjo është e pa zbatueshme, sepse shumë herë Hanefijtë arsyetohen me arsyetime të prodhuara, të cilat arsye nuk janë as në tekste e as në ixhmaë, dhe i bëjnë ato arsyetime bazë për rregullat e përgjithshme dhe interesa të përgjithshme, të cilat zbatohen në ndodhi në të cilat pikësynohet njohja e ligjit të saj dhe njohja e ligjeve prej saj.⁵⁸

1. Ligjvënësi e ka tekstualizuar se **“Në çdo dyzetë dele, një dele jepet zekat.”**⁵⁹ dhe nuk ka tekst apo ixhmaë në përcaktimin e arsyeshmërisë së ligjit. Hanefijtë e kanë prodhuar arsyen se *arsyeja* është *mbulimi i nevojave të nevojtarit*, për këtë arsye e kanë lejuar që në vend të dhënies së deles zekat, të lejohet të jepet kundërvlera e saj.

2. Ligjvënësi ka vendosur që një e pesta e pasurisë së luftës të jepet për kategori të caktuara. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

﴿وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا غَنِمْتُمْ مِّن شَيْءٍ فَإِنَّ لِلَّهِ خُمُسُهُ وَلِلرَّسُولِ وَلِذِي الْقُرْبَىٰ

وَالْيَتَامَىٰ وَالْمَسْكِينِ وَأَبْنِ السَّبِيلِ

“Ta dini se çfarëdo që fitoni nga pasuria e luftës, një e pesta i takon Allahut, të dërguarit të Tij, të afërmve të tij, jetimëve, të varfërve, dhe të mbeturve në rrugë.” (El Enfal : 41)

dhe nuk e ka sqaruar arsyen e këtij ligji. Hanefijtë e kanë themeluar arsyetimin me atë se ky kategorizim është bërë për *mbulimin e nevojave të nevojtarit*, për këtë arsye edhe nuk kanë lejuar që të afërmit e pasur (të pejgamberit s.a.v.s.) të marrin hise në atë kategori.

3. Hanefijtë e kanë paraparë që të lejohet dënimi për mallin në disponim, pra blerësi i cili e ka blerë dhe e disponon, sepse ai e ka blerë në formë të shitblerjes. Poseduesi, në formën e shitblerjes në esencë është posedues, pasi që këtë e kanë analoguar me mjetin e marrë peng (garancion).

Hanefijtë, ndalimin e kamatës e arsyetojnë në masë dhe sasi të njëjtë, kur janë në pyetje artikujt e njëjtë, të cilat janë gjashtë: ari me ari, argjendi me argjend, elb me elb, grurë me grurë, hurma me hurma, dhe kripë me kripë.

Në të dy rastet, arsyeshmëria është e prodhuar, dhe nuk është as prej tekstit as prej ixhmait.

4. Hanefijtë gjykojnë për të drejtën e trashëgimisë së gruas së shkurorëzuar tri herë, kur bashkëshorti e shkurorëzon nga shtrati i vdekjes, për të mos ia dhënë të drejtën e trashëgimisë. Ky veprim bëhet me qëllimin e kundërt të bashkëshortit, edhe pse për këtë çështje nuk ka as tekst dhe as ixhmaë (të vepruarit me qëllimin e kundërdëshiruar).

Ndalesa e trashëgimisë së vrasësit, ka ardhur si tekst por jo si formulim për ndalesën për të mos pasur të drejtë trashëgimie e shkurorëzuara, por Hanefijtë këtë bazë e kanë marrë si rregull të përgjithshme dhe interes të përgjithshëm të cilin e zbatojnë te larguesi nga e drejta për trashëgimi.

Kjo tregon se, shumica e analogjive të Hanefijtë, por edhe të dijetarët tjerë, nuk kanë tekst dhe as ixhmaë për t'i llogaritur si arsyeshmëri të cilat ndikojnë në ligj, por janë arsyeshmëri të prodhuara dhe muxhtehidi mbështetet në ta për shkak të përshtatshmërisë në ligj.

Te këta dijetarë, siç janë Malikijtë, të cilët e llogaritin vetëm përshtatshmërinë e cila është e vlefshme për arsyetim dhe për prodhimin e përshtatshmërisë nga muxhtehidi dhe e cila nuk është prej arsyeshmërive të anuluar, atribuohet përshtatshmëria prej saj dhe veprohet me atë që quhet parim i interesit, apo përshtatshmëri me interesin, sepse është atribut i përshtatshëm, të cilin Ligjvënësi as nuk e ka llogaritur si bazë, por në të njëjtën kohë as nuk e ka anuluar atë atribut.

Teoria e parimit të interesit te Hanbelijtë

Pas Malikijve, Hanbelijtë konsiderohen prej atyre që më së shumti veprojnë me parimin e interesit. Argument për këtë i kemi tri çështje:

1. Deklarimi i ekspertëve të usulit dhe i shumicës së dijetarëve Hanbelijë;
2. Fet'vatë e rezultuara nga imam Ahmedi;
3. Të vepruarit me parimin e të penguarit nga rruga e keqe.⁶⁰

E para: Disa ekspertë të usulit dhe shumica e dijetarëve Hanbelijë janë deklaruar në favor të bazimit në parimin e interesit.

Disa ekspertë të usulit kanë deklaruar se imam Ahmedi është bazuar në parimin e interesit, dhe atë si atribut bazik prej bazave të prodhuara, e kjo është: Interesi i cili është në harmoni me llojin e veprimtarisë së Ligjvënësit dhe që bën pjesë brenda bazës së tërësishme e cila tregon tekstet në mënyrë globale dhe nuk janë interesa të rralla për të cilat tekstet e sheriatit nuk dokumentojnë se llogariten se janë të atij lloji për t'i llogaritur si bazë.

Në këtë drejtim ka shkuar imam Shafiiu, i cili parimin e interesit e konsideron brenda bazës së kijasit, pra në kuptim më të gjerë, i cili përfshinë interesat të cilat dokumentohen prej bazave të cilat llogariten të llojit bazik. Imam Shafiu e ka marrë këtë koncept, që do të thotë: **bartja e ligjit prej llojit ligjor të bazës te dega, e cila nuk është e llojit të saj.**

Sa i përket Gazaliut, ai, kjasin e interpreton në kuptim më të ngushtë. Sipas tij, kijasi është: **bartja e ligjit konkret nga vendi i tekstit në vendin ku nuk ekziston teksti, me arsyeshmërinë e cila e obligon atë ligjësim.**

Disa Hanbelijë, kur i analizojnë fetvatë e imam Ahmedit, i llogarisin bazat dhe formën e nxjerrjes së fetvave, por pa e përmendur se ato janë si rezultat i parimit të interesit, e kjo tregon se këto raste kanë të bëjnë me interesa të rrallë, për interesa të cilat asnjë dijetarë i umetit nuk deklarohet.

Prej atyre të cilët deklarojnë mbështetje në favor të asaj se imam Ahmedi e ka përdorur parimin e interesit në nxjerrjen e ligjeve, janë: Ibni Dekik el Ijdi Karafiu dhe disa autorë bashkëkohorë.

Ibn Dekijk el Ijdi thotë: Ajo, për të cilën nuk ka pikë dyshimi është se, në këtë lloj, Maliku ka përparësi ndaj dijetarëve tjerë, e pastaj atë e pason Ahmed bin Hanbeli, me një fjalë, afër tyre janë edhe tjerët mirëpo këta të dy e praktikojnë parimin e interesit më shumë se të tjerët.⁶¹

Kerafiu thotë: Sa i përket parimit të interesit është thënë se, është posaçërisht e jona. Nëse humbin medhhebet, do të shohësh që nëse ringrihen ose tubohen ose ndahen në mes të dy çështjeve, nuk kërkojnë ndonjë dokumentim për të llogaritur atë koncept për të cilën janë tubuar, apo janë ndarë, por u mjafton vetëm përshtatshmëria (me ligjet e sheriatit), dhe ky është ai parim i interesit, e atëherë, ky parim është tek të gjitha medhhebet.⁶²

Profesori ynë, Ebu Zehra, thotë: T'i kemi sjell ty bazat të cilat i ka përmendur Ibn Kajimi se janë baza të nxjerrjes së ligjeve të imam Ahmedi, dhe nuk është përmendur parimi i interesit, mirëpo mospërmendja e tij nuk do të thotë se nuk e ka marrë për bazë, bile dijetarët Hanbelijë parimin e interesit e marrin si bazë prej bazave të përpilimit të ligjeve dhe këtë bazë ia mbështesin imami të tyre dhe vet Ibn Kajimit, i cili parimin e interesit e llogaritë bazë prej bazave të përpilimit të ligjeve, mirëpo ai nuk e përmend kur i përmend bazat mbështetëse të tij, sepse ai e parasheh se ai është mbështetur në kapitullin e analogjisë së shëndoshë.⁶³

Ibn Tejmije, në fetvatë e tij deklaron se e merr për bazë domosdoshmërinë dhe sjelljen e interesit dhe largimin e dëmit. Po ashtu edhe Ibn Kajimi në librin e tij (I'elamul Mukiiyn) e specifikon një kapitull për ndërtimin e sheriatit mbi parimin e interesit dhe në këtë libër tregon për shumë fetva të tij duke u mbështetur në interes,⁶⁴ si p.sh., shfrytëzimi i mjetit në garancion nga garantuesi, përballë shpenzimit të tij ndaj atij mjeti.⁶⁵

E dyta: Fetvatë e imam Ahmedit në lidhje me këtë çështje.

Janë hasur shumë fetva të fikhut Hanbelijë të cilat tregojnë se sikurse të tjerët edhe ata veprojnë me parimin e interesit të përshtatshëm me llojin e veprimit të Ligjvënësit dhe në bazë të saj përpilojnë ligje dhe detajizojnë çështje dhe kjo është dëshmi tjetër se parimi i interesit nuk është veprim vetëm i idesë dhe mendimtarit, por është rrugë prej rrugëve të argumentimit me tekste të sheriatit, dhe për çdo interes për të cilin kanë dhënë fetva dijetarët e umetit dëshmon se merren për bazë lloji i teksteve, dhe nuk janë interesa për të cilat ka heshtur Ligjvënësi.

Te Hanbelijtë, shembuj të parimit të interesit janë të shumtë, ja disa prej tyre:

1. Lejimi i shfrytëzimit të pasurisë së tjetrit apo i të drejtës së tij, kur të paraqitet nevoja dhe nuk ka mundësi të merret leje prej tij.

Kjo është një bazë e sheriatit, për të cilën nuk ekziston ndonjë tekst konkret, por që përshtatet me veprimet e Ligjvënësit dhe koncepti merret prej argumentimeve të tij. Ky parim është i njohur si parim shtesë (fadale).

Mbështetja e kësaj baze është marrë nga teksti i hadithit të Urve el Barukijut të cilit *pejgamberi s.a.v.s. ia jep një dinarë që t'i blen një kurban apo një dele. Urvete me atë dinarë i blenë dy dele dhe njërën dele e shet për një dinarë dhe Muhamedit s.a.v.s. ia dërgon edhe një dele edhe një dinarë.*⁶⁶ Në këtë tregim ne e shohim se si Urvete ka blerë dhe ka shitur dhe ia ka dorëzuar pejgamberit s.a.v.s. pa kërkuar leje prej tij, për shkak të pamundësisë për të kërkuar leje prej tij dhe pasi është paraqit nevoja për të vepruar në atë formë, dhe në fund, gjithë këtë pejgamberi s.a.v.s. e miratoi dhe madje iu lut Allahut t'i jep begati Urves.

Në këtë bazë (pako) marrin pjesë raste të shumta të cilat nuk kanë mbështetje pos në parimin e interesit për të cilin nuk ka ndonjë dokumentim (argument) të një baze konkrete, e prej tyre po i përmendim këto:

Nëse një njeri e sheh delen e një njeriu duke ngordhur edhe e prenë për t'ia ruajtur pasurinë e tij, ky veprim ka përparësi ndaj mosveprimit, pra lënies që delja të ngordhë dhe kështu njeriut t'i humb delja në tërësi. Ky veprim është veprim përjashtues nga tekstet të cilat e ndalojnë të vepruarit në pasurinë e tjetrit sepse kështu i shkaktohet dëm atij, mirëpo në rastin konkret, mosveprimi në pasurinë e tjetrit është dëmtim për të.

Nëse e sheh se uji vërshon në shtëpinë e fqinjit të tij dhe e prish murin dhe i nxjerr sendet të cilat fqinji i ka pasur brenda shtëpisë së tij. Kjo lejohet, dhe ai i cili e ka prishur murin për të hyrë brenda nuk dënohet.

Nëse ndonjë armik pikësynon pasurinë e një fqinji dhe për ta pajtuar armikun me fqinjin, ky bën marrëveshje për t'ia dhënë një pjesë të pasurisë në mënyrë që fqinjit t'ia ruajë pasurinë tjetër. Kjo lejohet dhe vepruesi i kësaj nuk dënohet për veprimin që e ka bërë, pra për atë se e ka paguar ngatërrestarin e fqinjit të tij me pasurinë e fqinjit.

Nëse shpërthen zjarri në shtëpinë e fqinjit dhe e prish një pjesë të shtëpisë për të mos e kapluar zjarri pjesën tjetër. Kjo lejohet dhe prishësi i murit nuk dënohet.

Për këto çështje nuk është dokumentuar interesi me ndonjë tekst konkret, mirëpo marrin pjesë brenda llojit (pakos së ligjeve) të cilat Ligjvënësi në mënyrë globale i konsideron si interesa, pa i cekur me ndonjë tekst konkret.⁶⁷

2. Obligueshmëria për të vepruar një veprim, prej të cilit, vepruesi nuk ka dëm, ndërsa moslejimi i atij veprimi shkakton dëm tek tjetri.

Kjo është një bazë e sheriatit, për të cilën nuk është dokumentuar me ndonjë tekst konkret, mirëpo është në përshtatshmëri me veprimet e Ligjvënësit dhe si koncept rrjedh nga një numër i konsiderueshëm i argumenteve.

Mbështetja e kësaj baze rezulton nga ligji i Ligjvënësit për pranimin e një pjese të “Shufuas” nga ortakut i tij, pasi që nuk dëmtohet pronari, ndërsa po të pengonte do të dëmtohej ortakut, kështu që pronari detyrohet të blejë pjesën e ortakut të tij.⁶⁸

Këtë e mbështet hadithi **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”**⁶⁹ Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar që një njeri ta pengoj fqinjin e tij që të vendos ndonjë dërrasë në murin e tij: **“Asnjëri mos të pengojë fqinjin e tij që të ngulit dërrasë (dru) në murin e vet.”**⁷⁰ Umeri ka dhënë fetva që të obligohet pronari që të lejoj të kaloj uji nëpërmes tokës së tij deri tek fqinji i tij, përderisa pronari i tokës nuk dëmtohet nga qarkullimi i atij uji.⁷¹

Kjo fetva bazohet në themelet e parimit të interesit, e cila nuk mund të dokumentohet me ndonjë tekst konkret, mirëpo përshtatet me veprimtarinë e Ligjvënësit dhe është brenda llojit të ligjeve të cilat në mënyrë globale tekstet e llogarisin në interes.

3. Duhet të shfrytëzohen çështjet, nëse me shfrytëzimin e tyre nuk dëmtohet askush dhe nevojtarit e shfrytëzon pa pagesë dhe pa kompensim.⁷²

Ky është interes i tërësishëm të cilin tekstet e dëshmojnë globalisht, kështu që ky është lloj ligji të cilin e bazon Ligjvënësi dhe në të zbatohet çdo ndodhi e cila është në harmoni me atë lloj ligjesh dhe që bëjnë pjesë në të.

Dëshmi për këtë bazë të tërësishme apo për këtë parim interesi të tërësishëm është se pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shit-blerjen e maceve,⁷³ ka ndaluar që të pengohet fqinji t'i mbështes drutë në murin e vet, dhe ka ndaluar që të pengohet uji që të shkoj dhe të grumbullohet te pronari i tokës së mëtutjeshme.⁷⁴

Prej zbatimit të kësaj baze, te Hanbelijtë kemi edhe rastet si në vijim:⁷⁵

1. Duhet t'i lejohet tjetrit që ujin rrjedhës (përroi, lumi) ta shfrytëzoj për pije të tij (familjes) dhe kafshëve të tij. Sipas mendimit më të saktë edhe për ujitjen e bimëve të tij.
2. Vendosja e drurëve në mur të fqinjit nëse nuk e dëmton atë, po ashtu edhe lejimin e qarkullimit të ujit nëpërmjet tokës së tij, e kjo sipas njërit prej dy transmetimeve.
3. Duhet të lejohet huazimi i mus'hafit atij i cili ka nevojë për ta lexuar dhe nuk ka.
4. Duhet t'i lejohet pranimi për pushim të rraskapiturve dhe duhet të lejohet të ushqehet me kompensim dhe jo pa kompensim të uriturve që i grinë uria.

Sa i përket shfrytëzimit të të mirave nga i detyruari, si f.v., shfrytëzimi i mjetit transportues nga i mbeturi në rrugë dhe huazimi për të detyruarin (të mbeturin) në rrugë. Për shfrytëzimin e mjeteve pa pagesë ekzistojnë dy mendime: Ibn Tejmije e preferon mendimin se të varfrit i jepet pa pagesë, kurse të pasurit me pagesë. Shembull: Shfrytëzimi i shtëpisë për banim nga i detyruari, si në rast të vërshimeve, zjarreve, luftërave e të ngjashme. Për këtë Hanbelijtë kanë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë: e shfrytëzon pa pagesë;

Mendimi i dytë: e shfrytëzon me çmimin e caktuar në treg.⁷⁶

Gjykimi për këto raste është gjykim i interesit për të cilat nuk ekziston tekst konkret, por që bëjnë pjesë brenda llojit të cilin Ligjvënësi e konsideron si interes në mënyrë globale, pa e përcaktuar me ndonjë tekst konkret.

- 4. Kush sjell ndonjë shkak (arsye) i cili dëshmon për të drejtë pronësi ose për t'u liruar nga ndonjë detyrë, e ky dëshnim bëhet në mënyrë të ndaluar, ai shkak anulohet dhe ekzistenca e tij shpallet inekzistente dhe nuk rezulton kurrfarë efekti juridik.**

Hanbelijtë japin fetva në bazë të kësaj, e cila është prej parimit të interesit, të cilat do t'i përmendim si në vijim:⁷⁷

1. Shkurorëzuesi në shtratin e vdekjes, nuk mund t'ia merr të drejtën e trashëgimisë bashkëshortes së shkurorëzuar e cila nuk e akuzon dhe nuk heqë dorë. Ka edhe raste të tjera të tilla, për të cilat Hanbelijtë kanë dhënë dy mendime.

2. Ai i cili dëshiron t'i ikë dhënies së zekatit ashtu që të mos arrijë shumën e nisabit, e për këtë e pakëson ose e shpronëson, ai prapë se prapë e ka obligim ta japë zekatin.
3. Vrasësi i trashëgimtarit, edhe nëse është trashëgues prapë nuk trashëgon nga ai trashëgimlënës, pa marrë parasysh a është fajtor apo jo. Vrasësi (testament trashëgues) i testamentlënësit nuk e trashëgon pjesën e tij dhe vrasja është shkak që të zhvlerësohet ai testament.
4. Ai i cili dehet me qëllim, deklarata e tij është e vlefshme, si dhe veprimtaritë e tij konsiderohen të rregullta dhe konsiderohet fajtor, ndërsa nuk merren parasysh fjalët dhe veprat nëse dehet me injeksion (nga të tjerët) dhe në mënyra të tilla të ngjashme.
5. Pastrimi (shndërrimi) i alkoolit në uthull nuk do të thotë se lejohet dhe se është i pastër.
6. Ai i cili nuk është në ihram nuk lejohet ta pret gjahun e atij i cili është në ihram, dhe ai i cili lirohet nga ihrami nuk lejohet që ta pret kafshën e atij i cili është në ihram.

E afërt me këtë rregull të fundit është rregulli “Kush e përshpejton në mënyrë të ndaluar të drejtën e tij apo atë e cila i lejohet, dënohet me privimin e asaj të drejte.”

Nga kjo rezultojnë ligjet tjera, sikurse për vrasësin e trashëgimtarit ose vrasësin e testamentlënësit. Tradhtarit të shpërndarjes së pasurisë së luftës i ndalohet pjesa e tij (kjo sipas një transmetimi). Kush e marton një grua në kohën e idetit, ajo grua i ndalohet atij (kjo sipas një transmetimi) derisa ta shkurorëzoj. Kush e gjuan një kafshë para se të lirohet nga ihrami, ajo kafshë nuk i lejohet atij, edhe nëse pastaj lirohet nga ihrami.⁷⁸

Të gjitha këto fetva bazohen në parimin e interesit, pasi që për ta nuk ekziston tekst konkret, por për këtë dëshmojnë lloje të ligjeve të cilat janë prej teksteve të sheriatit të cilat në mënyrë globale sinjalizojnë për interes. Prej teksteve më të rëndësishme të cilat dëshmojnë për ato interesa është privimi i vrasësit të trashëgimtarit nga trashëgimia.

Malikijë këtë bazë e formulonjë kështu: “Nëse i ngarkuari, për shkak të ndonjë pengese pikësynon që ta arrijë interesin, atëherë veprohet me të kundërtën e atij pikësynimi.”⁷⁹

- 5. Shkaqet në akte dhe pronësime llogariten të njëjta me shkaqet e përbetimeve.**

Koncepti i këtij interesi është se shkak të dërgon te akti i cili jep të drejtën e pronësimit i cili ndikon në vlefshmërinë apo pavlefshmërinë, siç është rasti tek përbetimet.

Kjo është një bazë e sheriatit e cila nuk dokumentohet me ndonjë tekst konkret, por e merr kuptimin nga një numër i konsiderueshëm i argumenteve të sheriatit dhe pastaj zbatohet në këto çështje:⁸⁰

- Ndalimi i çështjeve të shitblera në formën **“Ijnetun”**.

- Dhurimi i një sendi (vlere) borxhliut para se t’i paguhet borxhi.⁸¹

- Dhurata e idhujtarëve për udhëheqësin e ushtrisë.

- Dhurimi për administratorët (si f.v.: ekzekutivëve, prokurorëve dhe administruesve tjerë) nëse nuk u është dhënë atyre edhe para emërimit të tyre.

- Dhurimi i mehrit nga ana e gruas për burrin e saj, nëse ai e kërkon prej saj, sepse shkak i saj është kërkimi i vazhdimit të kurorëzimit, e nëse e shkurorëzon atë, ajo ka të drejtë ta kthejë.

- Dhurata nuk mund të bëjë dobi te gjykatësi apo me të ngjashmit me të. Nuk lejohet sepse kjo i bie si të jetë pagë, dhe për shërbime që janë në interes shoqëror nuk lejohet të pranohen shpërblime.

Fetvatë për këto çështje, bazën e kanë te parimi i interesit, pra në interesin për të cilin nuk ka dokumentim konkret, ashtu që të merret vendim nëpërmjet rrugës së kijasit. Ky është lloj interesi i përshtatshëm me llojin e veprimtarisë së Ligjvënësit dhe kthim në bazën, që Ligjvënësi në mënyrë globale e ka marrë për bazë në disa ligje, e prej tyre janë ndalesa e shitblerjes e formës së **“Ijnetun”** dhe dhurata ndaj borxhliut.

Ibn Kajimi ka folur edhe më shumë në sqarimin e rëndësisë së qëllimit për ta marrë si bazë në vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e aktit dhe se qëllimi është thelbi i aktit. Marrja për bazë e qëllimit në akte, ka përparësi ndaj marrjes për bazë të *shprehurit* dhe se rregull e sheriatit është: “Qëllimet dhe besimet merren për bazë në veprimtari dhe shprehje ashtu siç merren në adhurime dhe gjëra që afrojnë te Zoti.”⁸² gjë që tregon se Hanbelijtë e marrin për bazë parimin e interesit.

6. Nuk bëhet ekzekutimi i donacionit të borxhlinjve.

Disa Hanbelijë kanë dhënë fetva se nuk bëhet ekzekutimi i donacioneve të borxhlinjve në të drejtë të borxhmarrësve, si p.sh., sadakaja dhe dhurata, nëse nuk ka qenë i penguar dhe ka ndodhur pas kërkesës, që do të thotë, pas heqjes dorë nga akuzimi dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor.

Këto fetva nuk kanë mbështetje në tekste, por është interes, i cili e ka bazën në llojin të cilin e ka marrë për bazë Ligjvënësi në mënyrë globale pa ndonjë tekst konkret.

Këto fetva kanë argumentim në dy baza:

E para: Atë që e ka nënvizuar Ahmedi r.a. Në transmetimin e Ahmed bin Hanbelit thuhet se ai i cili pasurinë e tij e lë donacion si vakf apo sadaka, përderisa prindërit e tij kanë nevojë, atëherë ai donacion i kthehet atij. Ai është argumentuar me hadithin e transmetuar për këtë.

E dyta: Ahmedi r.a. në një transmetim tjetër ka nënvizuar se kush lë testament për të huajt dhe ka farefis nevojtar, testamenti u kthehet farefisit të tij. Nga kjo rezulton se kush jep donacion, ndërsa e ka për obligim të shpenzoj, shpenzim obligativ për trashëgimtarët ose e ka ndonjë borxh që nuk e ka kryer, ai donacion i kthehet prapa.⁸³

Nëse interesi është në furnizimin e prindërve, atëherë edhe interesi i tij është në sigurimin e të drejtës së borxhlinjve.

7. Rindërtimi i murit të përbashkët nëse është duke u shembur; e të ngjashme.

Hanbelijtë kanë dhënë fetva se, nëse shembet muri i përbashkët, dhe nëse duhet të ndërtohet përsëri, atëherë ai që pengon të ndërtohet muri duhet të detyrohet që ta ndërtojë së bashku me tjetrin.

Nëse shembet kulmi në mes të pjesës së epërme dhe të poshtme, rindërtimi bëhet nga të dy pronarët, sepse dobia është e të dyve.

Nëse prishet kanali i dy bashkëpjesëmarrësve, detyrohen që ta ndërtojnë që të dy bashkëpjesëmarrësit.

Nëse njëri prej bashkëpjesëmarrësve e kërkon hisen e caktuar nga hisja tjetër, detyrohet tjetri që të heqë dorë nga ajo hise, por nëse është e pamundur që të definohet hisja, atëherë njëri prej tyre detyrohet që ta blej të tërën nëse tjetri kërkon ta shesë.

Në të gjitha këto raste, njëri prej bashkëpronarëve ia kompenson tjetrit, për të mënjeluar dëmin e bashkëpronarit tjetër.

Nuk shoh se ka ndonjë tekst konkret i cili e konfirmon këtë interes, mirëpo është interes i përshtatshëm i llojit të veprimtarisë së Ligjvënësit dhe i mbështetur në bazën e tërësishme e ajo është, detyrimi për kompensim për ta larguar dëmin e qëllimshëm ligjërisht.

Kjo, duke u bazuar se Ligjvënësi e detyron pronarin t'ia blej fqinjit ose bashkëpronarit i cili e kërkon të drejtën abstrakte/konkrete e ajo është, detyrimi i kompensimit për të mënjeluar dëmin dhe peygamberi s.a.v.s. pronarit të trungut të hurmës e cila ka qenë në kopshtin e tjetrit i ka kërkuar që t'ia shes ose t'ia dhuroj atë trung hurme pronarit të kopshtit, mirëpo pronari i trungut të hurmës nuk ka pranuar as njërën e as tjetrën, andaj peygamberi s.a.v.s. i ka thënë, **-Ti je dëmtues**, dhe pas kësaj e lejon pronarin e kopshtit që ta heq atë trung hurme nga aty.⁸⁴

Ahmedi, këtë fetva e konsideron si dëshmi të bazës së përgjithshme, e ajo është se, detyrimi për kompensim është lejuar për të mënjeluar padrejtësinë, apo për të penguar dëmin, ose edhe është i lejuar për shkak të nevojës ose për shkak të domosdoshmërisë, me fjalë tjera, është lejimi detyrimisht i shpronësimit të diçkaje nga tjetri me çmimin e atij sendi për shkak se anon ana e interesit, sikurse te **“Shufua”**.⁸⁵ Kjo është bazë e sheriatit të cilën nuk e konfirmon ndonjë tekst konkret, por që është në përshtatshmëri me veprimtarinë e Ligjvënësit.

Prej rasteve praktike të kësaj baze, e cila ka mbështetje në parimin e interesit është edhe ajo të cilën e përmend Ibn Kajimi. Nëse njerëzit kanë nevojë për prodhimin e ndonjë produkti, si në bujqësi, rrobaqepësi, ndërtimtari, etj., atëherë qeveritari i obligon profesionistët e atij prodhimi, normalisht duke i paguar, sepse ndryshe nuk mund të plotësohet interesi i njerëzve, pos në atë mënyrë.⁸⁶

Prej rasteve tjera: Lejimi i përcaktimit të çmimit të mallrave për tregtarët, nëse tregtarët e teprojnë dhe e shfrytëzojnë gjendjen e njerëzve, pasi që mallrat i kanë në duart e tyre, ato detyrohen që t'ua kompensojnë për interesin e përgjithshëm. Nëse ngritja e çmimeve bëhet për shkak të ofertës dhe kërkesës, atëherë nuk ka përcaktim të çmimit.⁸⁷

Prej rasteve tjera: Pengimin e konkurrencës së jashtëligjshme e cila sjell deri te mbizotërimi ndaj njerëzve të tjerë dhe e cila e pengon konkurrencën e lirë në tregti, p.sh., detyrimin e njerëzve që të mos blejnë askund pos te disa persona të caktuar, që ato mallra t'i blejnë vetëm prej tyre e pastaj ato i shesin siç dëshirojnë, ose qiradhënien e ndonjë hoteli në rrugë apo në fshat, me ndonjë çmim të caktuar me kusht që mos t'i shitet askujt përpos qiramarrësit.⁸⁸

Kjo përfshinë edhe rastin kur një grup pajtohet për të monopolizuar ndonjë profil të caktuar, si f.v., gypat e ujësjellësit, ose qiradhënia për diçka të caktuar, ose pajtueshmërinë e prodhuesve të një artikulli apo punonjësit e

atij artikulli që ta shesin ose ta blejnë vetëm me një çmim të caktuar për t'i dëmtuar punonjësit tjerë me ta. E gjithë kjo është padrejtësi dhe e ndaluar.

8. Pengimi i arrogancës në të shfrytëzuarin e së drejtës.

Hanbelijtë kanë përmendur shumë fetva të ndërtuara mbi parimin e interesit, i cili është i përshtatshëm me llojin e veprimtarisë së Ligjvënësit edhe pse nuk ekziston ndonjë tekst konkret që tregon shprehimisht se ato raste janë *interes*.

Ky lloj i veprimtarive nënkupton se: Një person është i kushtëzuar që ta shfrytëzoj të drejtën e tij por pa e dëmtuar tjetrin. Nëse e drejta e tij e dëmton tjetrin, atëherë nuk i lejohet shfrytëzimi i së drejtës së tij, ose më e pakta që i lejohet është që ai t'ia kompensoj tjetrit dëmin e shkaktuar nga shfrytëzimi i së drejtës së tij.

Ibn Rexhepi thotë: Lejohet prishja e kontratave nëse në ato kontrata dëmtohet njëri prej të kontraktuarve, ose i ndonjë tjetri i cili ka të bëjë me atë kontratë. Ajo kontratë as nuk fuqizohet, as nuk zbatohet, vetëm nëse parashihet kompensimi i dëmit ose të ngjashme me të, atëherë në atë mënyrë lejohet.⁸⁹

Nuk lejohet që njëri prej kontraktuesve të një ndërmarrje ose të një shoqërie aksionare ta prish kontratën kur fsheh diçka nga bashkëpjesëmarrësi sepse ky është maskim i qëllimit për shkaktim të dëmit, sepse kjo është ngrirje e pasurisë për të mos pasur përfitim.⁹⁰

Kjo bazë e sheriatit apo interes i tërësishëm merret nga tekstet e sheriatit, dhe Ligjvënësi e ka tërhequr vëmendjen në ato interesa dhe në ato degëzime, sepse qëndrueshmëria e teksteve të sheriatit tregon se Ligjvënësi ka pikësynim moslejimin e një veprimi që shpie në dëmtim, pasi dëmtimi i muslimanit është haram.

Vërehet se, poseduesi i së drejtës mund ta shfrytëzoj të drejtën vetëm në mënyrën kur nuk e dëmton tjetrin dhe kjo i bie sikurse të ketë pikësynuar dëmtimin e tjetrit, ose zvogëlimin e mundësisë dhe marrjen e masave të domosdoshme për të penguar dëmtimin e tjetrit.

9. Kush e kryen një obligim për tjetrin, pa lejen e tij, ai e kthen prapë atë çka e ka shpenzuar, vetëm në qoftë se ka qenë e pamundur të merret leje prej tij.

Kjo bazë, nuk ka mbështetje në ndonjë tekst konkret, por është marrë nga mënyra e veprimit të Ligjvënësit sepse është interes i tërësishëm për të cilin është përkujdesur Ligjvënësi në përpilimin e ligjeve dhe në çka është bazuar.

Nëse një njeri ia kryen borxhin një njeriu tjetër pa lejen e tij, ai borxh kthehet.

Nëse një njeri shpenzon për gratë, farefisën dhe bagëtinë e tjetrit, i cili e ka për obligim të shpenzojë, pasi që më herët nuk e ka lejuar, ai duhet ta rimarrë shpenzimin. Njësoj i kthehet shpenzimi, për të lindurin para kohe, qoftë bagëti apo diçka tjetër, i cili ka pasur nevojë për t'u siguruar për ushqim dhe përkujdesje.

Në shpenzimin e ndonjërit prej ortakëve nga pasuria e përbashkët, në mungesë të tjetrit apo moslejimi i shpenzimit duke ia kryer borxhin njërit prej trashëgimtarëve të vdekur, atij duhet t'i kthehet te trashëgimtarët e tij, te secili në pjesë të barabarta.

Këtë bazë e kuptojmë prej asaj se pejgamberi s.a.v.s. ka lejuar që ai i cili e merr peng një kafshë, ta shfrytëzoj atë për bartje dhe qarkullim dhe përballë atij shfrytëzimi të shpenzoj. Për mjetin transportues shpenzon nëse është peng (garancion). Qumështin e pi me shpenzimet e tij nëse është peng (garancion). Për atë që e shfrytëzon edhe për transportim edhe për qumësht, shpenzon.⁹¹ Kjo dëshmon se në ato raste merret parasysh interesi.

Argument se ai i cili e kryen obligimin për tjetrin, ai ia kthen po në atë masë (shumë) që e ka kryer atë obligim. Kjo është ajo që e thotë Ibn Kajim pasi që e citon hadithin se: Ai i cili shpenzon për pengun, shpenzimi bëhet borxh për pengmarrësin sepse ai obligimin e ka kryer për atë dhe është e pamundur që kjo të dëshmohej në çdo vakt dhe të kërkuarit e lejes prej udhëheqësit. Për këtë arsye Ligjvënësi e ka lejuar që përgjegjësia dhe borxhi të mbeten në barrë të pengut ashtu që edhe pengmarrësi edhe penglënësi të kenë interes.⁹²

Ky parim, në ligje njihet si teori e shfrytëzimit pa kurrfarë shkaku dhe çdo përfitim qoftë material qoftë moral realizohet prej poseduesit, pa marrë parasysh a bëhet nëpërmjet mënyrës së përfitimit prej asaj pasurie apo duke e larguar dëmin prej asaj pasurie, sepse është pakësuar në aspekt negativ nga ana e borxhliut. Sa i përket të robëruarit nga robëria, është dobja morale në të.⁹³

10. Cilit i lejohet të shfrytëzoj diçka dhe pastaj i ndalohej, atëherë ai nuk ka të drejtë ta shfrytëzoj deri sa t'i lejohet nga qeveritari ta blejë ose ta merr me qira.

Kjo është bazë e tërësishme të cilën e ka marrë për bazë Ligjvënësi. Kjo, duke u bazuar nga hadithi i cili sinjalizon për dëmshpërblimin të cilin e treguam më herët, të cilin e ka transmetuar Ibnul Abidijni, i regjistruar në

librin “Muvetae”. Ibn Xhendebi e ka pasur një palmë në një mur (pra në kopsht, të mbështetur për muri) të njërit prej ensarëve dhe ai dhe familja e tij hynin në kopshtin e fqinjit dhe e pengonin. Ensariu ankohet te pejgamberi s.a.v.s., e atëherë pejgamberi s.a.v.s. i thotë pronarit të palmës, - Shitja - e ai refuzon. Pastaj i thotë, - Dhuroje, dhe e fiton xhenetin, e ai përsëri refuzon. Atëherë pejgamberi s.a.v.s. i thotë, - **ti je dëmtues**. Pastaj i thotë ensariut, - shko dhe shkule palmën. Nga kjo bazë rezultojnë çështjet si në vijim:

Vendoset ndonjë dërrasë në murin e fqinjit nëse nuk e dëmton fqinjin (kjo nuk lejohet te imam Ahmedi).

Detyrohet burri që ta lejoj bashkëshorten e tij që të shkoj në haxhin obligativ.

Lejohet marrja e ujit tepricë nga toka e tjetrit. E kjo, nëse kërkon leje për ta shfrytëzuar, e nëse pronari i tokës e refuzon, refuzimi i tij nuk merret parasysh dhe vendosja për vendbanim obligativ, nëse nuk i lejohet vendstrehimi.

Lejohet të merret prej pasurisë së tjetrit dhe nuk merret parasysh leja apo mosleja e tjetrit.

Nëse pronari nuk lejon shpenzimin për ushqimin e bagëtisë së tij, detyrohet shpenzimi për atë bagëti apo shitjen e asaj bagëtie.

Nëse borxhmarrësi shkon për t’ia dhënë borxhin borxhdhënësit por që ai refuzon ta marrë borxhin, atëherë borxhi i jepet udhëheqësit (qeveritarit) dhe lirohet borxhmarrësi nga ajo barrë.⁹⁴

Të gjitha këto dispozita, nuk janë marrë nga teksti shprehimor e as nga logjika e kijasit, por janë marrë nga lloji (pakoja) të cilin Ligjvënësi e ka marrë si peshojë (për bazë) dhe pa argument të drejtpërdrejtë dhe është në përputhshmëri me interesin i cili është në harmoni me llojin e interesave të sheriatit. Kjo pra, quhet harmonizim me interesin.

Përfundim – Hanbelijtë e pranojnë interesin për çështje për të cilat nuk dihet se ekziston ligji prej tekstit shprehimor ose prej logjikës së tekstit nëpërmjet kijasit të arsyes konkrete, por ekziston interesi të cilin e pranojnë sepse ai interes është në përshtatshmëri me mënyrën e veprimtarisë së Ligjvënësit dhe është në përputhje me bazat e përgjithshme dhe me rregullat e tërësishme dhe me këtë te ta bëhet argumentimi me argumentet e teksteve, si p.sh. te Shafiijtë, dhe nuk është interes të cilin e parasheh mendja pa pasur dokumentim me atë interes të cilin e merr për bazë Ligjvënësi.⁹⁵

E treta: Të vepruarit me parimin preventiv (parandalues).

Sikurse Malikijë dhe Shafijë, edhe Hanbelijë veprojnë me parimin e pengimit të shkatërrimit dhe mbylljen e dyerve të së keqes dhe dëmtimit, të cilën do ta sqarojmë në temë më vete.

Tani është e rëndësishme të sqarojmë lidhshmërinë në mes të parimit preventiv dhe të interesit,⁹⁶ sepse në parim ka ngjashmëri në mes të parimit preventiv dhe atij të interesit, sepse në secilën prej tyre ekziston interes i përgjithshëm të cilin e dokumentojnë tekstet e shariatit në mënyrë globale pa ndonjë argument konkret. Qëllimi është i njëjtë, e ai është, sigurimi i interesit të përgjithshëm dhe largimi i dëmit të përgjithshëm.

Siç kemi sqaruar, parimi i interesit është interesi për të cilin nuk dëshmon ndonjë tekst konkret, por që bën pjesë në llojin e interesit, në të cilin bazohet Ligjvënësi, në mënyrë globale pa ndonjë tekst konkret, ndërsa parimi i pengimit të së keqes do të thotë se veprimi i ligjësuar për interes të caktuar pengohet nëse nëpërmjet saj realizohet një interes shkatërrues i njëjtë apo i nivelit edhe më të madh. Këtu, fekihi gjykon që ai veprim të pengohet, për të mos lejuar të keqen dhe për të nuk ka ndonjë tekst i cili dëshmon për atë interes konkret, që do të thotë se nuk ekziston tekst i cili dëshmon për atë interes që në atë rast gjykon për të penguar atë veprim, por që pengimi i asaj veprimtarie është i lejuar nëse ajo veprimtari sjell dëm e që rishikohet në bazën e prerë. Interesi i tërësishëm është dëshmuar nëpërmjet teksteve të shariatit në mënyrë globale pa argument konkret.

Nga kjo, disa autorë e shëmbëllojnë interesin dhe pengimin e së keqes me shembuj të njëjtë sikurse është dënimi për prodhimin e mjetit të porositur, mospranimi i pendimit të tradhtarit, ekzekutimi i grupit për vrasjen e një personi, tubimin e njerëzve në një mus'haf dhe kjo për dy arsye.

Kush shikon nga këndvështrimi se interesi i cili patjetëron dispozitën në rastin e interesit nga baza e cila e tregon konkretisht atë domosdoshmëri thotë se është parim i interesit.

Kush shikon nga këndvështrimi se ai veprim është ligjësuar prej baze pasi që në të ekziston interesi mirëpo prej saj shkaktohet dëm i njëjtë ose më i madh dhe largohet dhe e pengon atë, atëherë e llogaritin brenda parimit preventiv, nga shkaku se konsiderohet pengimi i të lejuarës pasi që ajo shpie në të palejuarën.

Profesori ynë, shejhu Ebu Zehra r.a., ka thënë: Shikimi nga ky këndvështrim (parimi preventiv) na shpie deri te përfundimi se ajo është

vërtetuar në realizimin e bazës paraprake (parim i interesit), largim i dëmit dhe sjellja e interesit (dobisë), aq sa ekziston mundësia e largimit (të dëmit) dhe sjelljes (së dobisë), pasi që prej pikësnyimeve të sheriatit është realizimi i interesave në këtë botë nëpërmjet rrugëve legjitime, për të cilat feja i gjykon për qetësimin e shpirtit dhe trupit, si dhe mënjanimi i dëmit dhe pengimin e vuajtjeve në bazë të mundësive. Çdo gjë e cila shpie në atë rrugë të dëmshme dhe rrethana që sjellin dëm, atëherë, bazë është që të merret vendim ndalimi i asaj rruge ose anasjelltas rruga e cila sjell dobi, bazë është që të mundësohet hapja e asaj rruge. Qëllimi me fjalën interes, është dobia e përgjithshme, ndërsa me fjalën dëm, ajo çka sjell vuajtje ose që dëmton shumicën e njerëzve. Duke u bazuar në këtë, nëse për një person realizohet interesi personal, ndalohet nëse dobia e tij sjell dëm të përgjithshëm, ose me fjalë tjera e pengon interesin e përgjithshëm. Kjo pengesë hyn tek ligji preventiv dhe dhënia përparësi interesit shoqëror ndaj atij personal. Kontrollon malli para se të del në treg, monopolizimi i tregut është i ndaluar sepse edhe pse në esencë shitblerja është e lejuar, por nëse një gjë e tillë tolerohet, atëherë njerëzve (shoqërisë) u vështirësohet gjendja dhe nuk ekziston liria e të vepruarit reciprok dhe lejimi i monopolizimit sjell dëmin e përgjithshëm. Për këtë arsye ndalohet një veprim i tillë për të parandaluar të keqen. Kështu që kjo është ndalesë e përgjithshme edhe pse në të kanë dobi disa individë.⁹⁷

E katërta: Kushtet e të vepruarit me parimin e interesit.

Për të vepruar me parimin e interesit, Malikijtë dhe Hanbelijtë kanë kushtëzuar tri kushte:

1. **Që interesi të jetë i përshtatshëm me pikësnyimet e Ligjvënësit,** ashtu që të mos kundërshtohet me një bazë prej bazave dhe të mos jetë në kundërshtim me një tekst apo me ndonjë argument të prerë, por që të jetë në përputhshmëri me interesat për të cilat pikësnyon t'i realizoj Ligjvënësi dhe që të jetë prej llojit të saj dhe jo të shkatërrimit të qëllimeve të saj edhe pse për ato interesa nuk ka ndonjë dëshmi të posaçme e cila dokumenton për ta, shembull, rastet e rralla të cilat i kam përmendur në fillim të temës së kijasit.

2. **Që në vetvete të jetë racionale.** Kjo buron në atributet të cilat i pranon logjika dhe janë në përputhshmëri me logjikën, ashtu që ajo dispozitë për atë rast sjell interes në mënyrë të prerë dhe jo me mëdyshje apo me mendim se sjell interes. Kjo do të thotë se nga ligjësimi i ligjit ose sjell interes ose largon dëmin, shembull, regjistrimi i kontratave në

protokole automatikisht minimizon dëshmitë e rrejshme e cila në raportet e njerëzve vazhdimisht praktikohet, përderisa marrja e të drejtës së burrit për shkurorëzim dhe dhënia e të drejtës për shkurorëzim gjykatësit, kjo nuk lejohet, për shkak se është në kundërshtim me tekstin dhe nuk sjell dobi të sigurt, përderisa përcaktimi i çmimit të mallrave në rast nevojë sjell dobi me profitin e realizuar dhe pengon mashtrimin (keqpërdorimin) për të fituar sa më shumë dhe kjo bëhet për të larguar vështirësinë nga njerëzit. Kështu pra, sa i përket asaj se pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar përcaktimin e çmimit të tregut⁹⁸ është posaçërisht për disa raste dhe për disa rrethana për të cilat ende nuk ka mashtrime dhe në të cilat rrethana njerëzit janë të devotshëm dhe janë të besueshëm ndaj njëri-tjetrit, e që më pastaj janë ngritur çmimet, ose për shkak të mungesës së tyre, ose për shkak të numrit të madh të blerësve. Imam Maliku e ka lejuar përcaktimin e çmimit qoftë edhe për mallrat ushqyese të njerëzve dhe të kafshëve. Dijetarët e mëvonshëm e kanë konsideruar përcaktimin e çmimit përpos në dy artikuj ushqimor: në mishra dhe vajra. Këtë e kanë bërë për shkak të ruajtjes së interesit të njerëzve dhe largimin e dëmit prej tyre.

3. Që interesi i cili realizohet nga përpilimi i ligjit të jetë interes i cili i përfshinë njerëzit në përgjithësi e që të mos jetë interes personal, ose interes i një grupi të caktuar të njerëzve, sepse ligjet e shariatit janë vendosur për të gjithë njerëzit, si p.sh., ligjësimi i ligjit për interesin e emirit apo kryetarit, ose të parisë së tij, ose të familjes së tij. Në këtë rast, ligjërisht nuk lejohet ky interes. Ngjashëm me këtë: Vrasja e muslimanit të vendosur si mur i gjallë nga ana e pabesimtarëve në një kala (fortifikatë). Në këtë rast nuk lejohet vrasja, pasi që ka mundësi të rrethohen dhe nuk ka frikë prej armiqve se mos po e okupojnë vendin islam.

Këto kushte të të vepruarit me parimin e interesit janë: Që interesi të jetë i realizueshëm dhe jo vetëm imagjinar (hipotetik) se mund të sjell interes apo të largoj dëm dhe që të mos bie ndesh me këto interesa me ligjin, apo me parimin i cili është i vendosur me tekst ose me ixhmaë dhe që të jetë interes i përgjithshëm, ashtu që të sjell dobi në shumicën e njerëzve.

E pesta: Konfrontimi i interesit me tekstet.

Sipas mendimit tim, as që nevojitet të parashtrohet pyetja në këtë çështje, pasi që dihet se i jepet përparësi tekstit në çdo rast kur në të kundërtën ka interes sepse dijetarët veprimin me parimin e interesit e kanë kushtëzuar që të veprohet çdo herë kur është në harmoni me qëllimet e Ligjvënësit dhe që nuk bie ndesh me tekstet e Tij. Ne e dimë se teksti pashmangshëm e ruan dhe siguron interesin, gjë që dëshmon se ajo që bie ndesh me të është e ndërtuar mbi bazën e interesit hipotetik apo të veçantë (parcial). Edhe pas kësaj është hasur mospajtim në mes të dijetarëve sa i përket kësaj çështjeje dhe në atë kur teksti nuk ka tregueshmëri të prerë dhe të qartë në tregueshmërinë dhe vendosmërinë e tij, përderisa sa i përket tekstit me tregueshmëri dhe vendosmëri të prerë, dijetarët janë pajtuar se nuk lejohet të veprohet me parimin e interesit nëse është në kundërshtim me tekstin përpos rastit të izoluar të dijetarit Tufi të cilin do ta sqarojmë në detaje. **Shembull:** Ndalimi i kamatës, është bërë me tekst të prerë dhe tregueshmëria buron prej thënies së Allahut:

وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَا

“Dhe Allahu e ka lejuar shitblerjen, ndërsa e ka ndaluar kamatën.”
(El Bekare : 275).

Si dhe:

فَإِنْ لَّمْ تَفْعَلُوا فَأْذَنُوا بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَإِنْ تُبْتُمْ فَلَكُمْ رُءُوسُ أَمْوَالِكُمْ
لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ ﴿٢٧٩﴾

“Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali fillestar. Në këtë mënyrë nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni.” (El Bekare : 279)

Në bazë të kësaj nuk lejohet specifikimi, ashtu që duke e lejuar kamatën në ndonjë përqindje të caktuar si p.sh. deri në 7%.

Sa i përket konfrontimit të interesit me tekstin, dijetarët kanë dhënë tri mendime:⁹⁹

1. Një pjesë e dijetarëve, nuk e lejojnë të vepruarit me parimin e interesit nëse është në kundërshtim me tekstin, sepse sheriat bazohet në tekst, ose në ixhmaë, ose në analogji me ta dhe nëse bie ndesh interesi me tekstin, atëherë absolutisht nuk merret për bazë parimi i interesit. Shafiijtë, e me ta janë pajtuar edhe Hanbelijtë, veprojnë me parimin e interesit vetëm pas tekstit, ose të fetvasë së sehabiut.

Sa i përket kundërshtimit me mendimin e sehabiut, është replikuar, ndërsa sa i përket tekstit, nuk ka çka të replikohet, si p.sh., kuptimi i Ebu Bekri Sidikit ndaj atyre që e pengojnë dhënien e zekatit, ashtu që askush të mos i ndaj kushtet elementare të islamit, sepse kjo bie ndesh me thënien e Muhamedit s.a.v.s.: **“Jam i urdhëruar t’i luftoj njerëzit deri sa të thonë: Nuk ka zot tjetër pos Allahut. Nëse e thonë këtë, atëherë prej meje u është siguruar gjaku dhe pasuria e tyre, vetëm nëse është në pyetje me të drejtë dhe përgjegjësi japin tek Allahu.”**¹⁰⁰

Shembull tjetër: Heqja e kategorisë së *përvetësimit të zemrave* nga ata të cilët e meritojnë zekatin, pasi që nuk ka nevojë për atë kategori, sepse islami është forcuar, edhe pse kjo kategori është meritore sipas thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

﴿إِنَّمَا الصَّدَقَتُ لِلْفُقَرَاءِ وَالْمَسْكِينِ وَالْعَمِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ

“Vërtetë zekati u takon të varfërve, të gjorëve, ata të cilët punojnë për të dhe atyre të cilët duhet përvetësuar zemrat e tyre...” (Et Tevbe : 46) Po ashtu Umeri r.a. e ka llogaritur legjitim shkurorëzimin e trihershëm me një fjalë, kjo si ndëshkim ndaj njerëzve të cilët e përdornin shumë edhe pse në kohën e Muhamedit s.a.v.s. llogaritej vetëm një shkurorëzim dhe jo tre shkurorëzime.¹⁰¹

Sehabet janë pajtuar për ndëshkimin e prodhuesve kur u jepet paradhënie edhe pse në esencë ata janë besnik, e kjo për shkak të parandalimit të keqpërdorimit të porosive, siç kemi treguar më parë.

Replikohet me atë se, luftimi i penguesve të zekatit është brenda tekstit sepse bën pjesë në brendi të tekstit të thënies së Muhamedit s.a.v.s. **“...përpos me të drejtë...”**. Sa i përket heqjes së kategorisë së **“përfitimit të zemrave”** është ixhtihadë në zbatimin e tekstit dhe të kuptuarit të tij. Ligji është arsyetuar se kjo kategori ka qenë e paraparë për ta forcuar islamin dhe pasi që islami është forcuar, atëherë edhe arsyeshmëria është e panevojshme dhe ligji anulohet, kështu që nuk llogaritet anashkalim i tekstit, por zbatim i tij.

Sa i përket treshkurorëzimit, ky ligj ka të bëjë me diplomacinë e sheriatit dhe është e drejtë e qeveritarit.

Sa i përket ndëshkimit të prodhuesve (me porosi), kjo për shkak të joseriozitetit të tyre dhe atëherë kur ata nuk janë serioz në punën e tyre, dhe atëherë kur nuk ka mbetur besnikëri prej tyre.

2. Një grup i dijetarëve i jep përparësi interesit para tekstit dhe ky grup ndahet në dy nëngrupe.

Grupi i parë: Siç është treguar prej autorëve bashkëkohor Malikijë, sikurse ata edhe Hanefijtë, pas një analizimi të tyre, mbështeten në parimin e interesit përballë tekstit dhe e specifikojnë tekstin jo të qartë në tregueshmërinë e tij, ose në marrjen e vendimit prej tij atëherë kur interesi është i sigurt dhe i prerë dhe atëherë kur interesi është prej llojeve të interesit të cilat i ka paraparë Ligjvënësi. Në bazë të kësaj, ata (Hanefijtë) e specifikojnë të përgjithshmen prej Kur'anit, nëse është jo i sigurt me parimin e interesit dhe nuk e pranojnë lajmin (hadithin) e vetmuar nëse është në kundërshtim me interesin e sigurt, sepse **nëse bie ndesh e sigurta me jo të sigurtën, i jepet përparësi të sigurtës**. Do ta elaboroj mendimin e këtij nëngrupi.

Grupi i dytë: Prijës i këtij grupi është Nexhmud-dijn et-Tufi, i cili është dijetar prej dijetarëve të shek. VIII,¹⁰² mendimin e të cilit do ta sqaroj. Ky është prej sektit “Gulatu Shiatu” siç e tregon Ibn Haxhibi në librin “Tabekat” të Hanbelijve. Tufi mendon se duhet t’i jepet përparësi parimit të interesit ndaj tekstit dhe ixhmait, e kjo në çështjet e veprimtarive ndërnjerëzore,¹⁰³ pa marrë parasysh se a është teksti i sigurt apo jo i sigurt,¹⁰⁴ dhe kjo bëhet duke e specifikuar dhe sqaruar ata dhe jo duke i arsyetuar prej tyre. Me një fjalë, ai argumentohet me atë se Ligjvënësi, interesin e ka bërë bazë prej bazave të ligjësimit dhe i jepet përparësi çdo herë, po ashtu është argumentuar me përgjithshmërinë e teksteve siç janë:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَتْكُمْ مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَشِفَاءٌ لِّمَا فِي الصُّدُورِ وَهُدًى

وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴿٥٧﴾ قُلْ بِفَضْلِ اللَّهِ وَبِرَحْمَتِهِ فَبِذَلِكَ فَلْيَفْرَحُوا هُوَ خَيْرٌ مِّمَّا

يَجْمَعُونَ ﴿٥٨﴾

“O ju njerëz, ju ka ardhur juve këshilla nga Zoti i juaj i cili është edhe shërim në atë çka keni në gjokset tuaja, po ashtu është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Thuj:-Nga mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij dhe për këtë le të gëzohen, ajo është më e mira nga gjithçka.” (Junus : 57, 58)

Pastaj ajeti tjetër:

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَوةٌ يَا أُولِيَ الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٧٩﴾

“Dhe ju në hakmarrje siguron jetën o ju pronarë të mendjes.” (El Bekare : 179)

Po ashtu edhe thënia e Muhamedit s.a.v.s.: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”**

Prej argumenteve të tij¹⁰⁵ janë edhe:

E para: Tekstet janë të ndryshme dhe kundërshtuese, ndërsa ruajtja dhe sigurimi i interesit është çështje për të cilën janë pajtuar që të gjithë, kështu që ka përparësi të pasohet, sepse shpie në pajtueshmëri dhe dihet se është e kërkuar që të bëhet unifikimi i mendimeve në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا

“Dhe bashkohuni të gjithë në tërësi në litarin (Librin) e Allahut dhe mos u përçani.” (Ali Imran : 103) dhe në bazë të thënies së të dërguarit s.a.v.s.: **“Të mos kundërshtoheni sepse përçahen zemrat e juaja.”**¹⁰⁶

E dyta: Në sunet ekzistojnë argumente të kundërshtimit të teksteve me interesin, e prej tyre po e përmendim thënien e pejgamberit s.a.v.s. kur i thotë Aishes r.a.: **Po të mos ishte populli yt i ri në islam, do ta shkatërroja Qaben dhe do ta ndërtoja mbi themelet e Ibrahimit.**¹⁰⁷ Mosrindërtimi i Qabes nënkupton se është bërë për shkak të interesit të njerëzve.

Shembull tjetër: Ibn Mes’udi ka kundërshtuar tekstin me ixhmain, kur e ka lejuar tejemumin për personin e papastër (xhunub) kur ka thënë: “Po t’u lejonim këtë atyre, kam frikë se ndonjëri prej tyre do ta ftohë ujin dhe do të merrte tejemum duke e parë ujin.”¹⁰⁸ Këtë kundërshtim e ka bërë sepse e ka paraparë se e ruan interesin në çështje të adhurimit.

Replikë: Sa i përket argumentimit, kundërshtohet me përgjithshmërinë e teksteve, ashtu që baza e presupozuar është e pavlefshme dhe çdo gjë që rezulton prej saj bëhet e pavlefshme, pasi që asnjëherë nuk mund të paramendohet që të ndeshen tekstet me interesin e përgjithshëm sepse ligjet e sheriatit ndërtohen mbi bazën e sigurimit të interesit të përgjithshëm.

Ajetet tregojnë se sheriatu ka ardhur për sigurimin e interesit të robërve. Hadithi (shkenca e hadithit) sqaron se sheriatu nuk pranon të dëmtohet robi, por edhe nuk lejon të dëmton. Absolutisht, nuk mund të ndodhë konfrontim në mes të tekstit dhe interesit. Ata që deklarohen për parimin e interesit, siç janë Malikijtë, nuk pretendojnë se në praktikë mund të ndodhë konfrontim, por i japin prioritet argumentit më të fuqishëm ndaj argumentit më të dobët, i cili është i pasigurt. Kjo është kështu atëherë kur argumentimi bëhet me tekst jo të sigurt, e jo kur bëhet argumentimi me tekstin e sigurt.

Argumentimi i parë replikohet me atë se, nuk janë tekstet baza e konfrontimit, por baza e konfrontimit është interesi, pasi që interesi ndryshon në bazë të kohëve, vendeve dhe rrethanave.

Argumentimi i dytë replikohet me atë se, nuk ekziston konfrontim në mes të teksteve siç pretendojnë ata. Mosmarrja e vendimit për prishjen e Qabes për të siguruar interesin, nuk është në kundërshtim me tekstin, ashtu që të themi se ekziston tekst i cili është në kundërshtim me interesin.

Sa i përket kundërshtimit të Ibni Mes'udit, ai nuk është i ndërtuar mbi bazën e interesit në kundërshtim me tekstin, sepse në ajetin e tejumumit ai nuk e parasheh se ka të bëjë me kontaktimin seksual, por ajeti ka për qëllim prekjen e gruas. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَقْرُبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ
وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ
أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِّنَ الْغَايَةِ أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا
طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفُوًّا غَفُورًا ﴿٤٣﴾

“O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur derisa të dini se ç’flitni, e as duke qenë xhunubë (të papastër) derisa të laheni, përpos kur jeni udhëtarë. Nëse jeni të sëmurë, jeni në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen nga ultësira (nevojtorja), ose keni takuar gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë mësyjeni dheun dhe fërkoni me duart (tejemmum). All-llahu shlyen e falë mëkatet.” (En-Nisa : 43)

Përderisa atë që e tregojnë disa shahabe se kur janë bërë të papastër dhe nuk kanë gjetur ujë, janë larguar nga namazi, ndërsa pejgamberi s.a.v.s. u ka thënë: Përdore dheun e pastër sepse kjo të mjafton. Te Ibn Mes'udi ky tekst është i pavlefshëm, ashtu siç është i pavlefshëm për të hadithi të cilin e

transmeton Amari se një njeri shkon te Umeri dhe i thotë: Jam bërë i papastër dhe nuk po gjej ujë. I thotë: Atëherë, mos u falë. Atëherë Amari i thotë: O emir i besimtarëve, a të kujtohet kur unë dhe ti ishim në një ekspeditë dhe ndodhi papastërtia mbi ne dhe nuk kishim ujë. Atëherë ti nuk u fale, ndërsa unë e përdora dheun për tejemum dhe u fala dhe kur shkuam te pejgamberi s.a.v.s. të tha, - Të ka mjaftuar që t'i biesh me duar dheut dhe pastaj t'i shkundësh duart dhe pastaj t'i lëmoje fytyrën dhe duart.¹⁰⁹ Umeri i thotë, - Frikësoju Zotit o Amar. Amari i thotë, - Nëse dëshiron kurrë nuk do ta tregoj këtë ngjarje. Atëherë Umeri i thotë, - Trego për atë që duhet treguar.¹¹⁰

3. Gazaliu dhe Amediu mendojnë se gjykohet me parimin e interesit përballë tekstit, atëherë kur ekziston domosdoshmëria e prerë dhe e tërësishme, që do të thotë jo vetëm kur paraqitet nevoja dhe as atëherë kur prejudikohet apo presupozohet dhe as atëherë kur bëhet posaçërisht për një grup të njerëzve, për këtë arsye e kanë marrë si shembull rastin kur pabesimtarët i përdorin robërit musliman si mur të gjallë dhe kështu lejohet vrasja e tyre për shkak të interesit të përgjithshëm e ajo është sigurimi i shoqërisë islame dhe vendit islam dhe ky interes është në kundërshtim me tekstin i cili ndalon vrasjen e muslimanëve të cilët nuk bëjnë mëkat dhe nuk kryejnë ndonjë krim.

E vërteta është se Gazaliu ka sjellë shembuj tjerë, kështu që i lehtëson kushtet e mëparshme. Gazaliu lejon të veprohet me parimin e interesit nëse ai interes është në nivelin e nevojave, mirëpo në bazë të rregullit sheriatik i cili është: nëse vijnë në pyetje dy të këqija apo dy dëme, sheriat synon largimin e dëmeve më të mëdha dhe të këqijave më të mëdha. Shembull: Vënien e taksave për të pasurit në interes të ushtrisë, nëse fondi është i papërbalueshëm dhe ekziston frika se ushtarët i kthehen nevojave të tyre e cila sjell që pabesimtarët të okupojnë vendet islame, ose mund të paraqitet krizë në ato vende.¹¹¹

Po këtë shembull e kanë përmendur Malikijtë kur kanë dashur të argumentojnë me parimin e interesit. Në arsyetim ata thonë: Ana e përparësisë vërehet në atë se po të mos vepronte udhëheqësi ashtu, do të dobësohej lidhja dhe atëherë shtetit do t'i kanosej rreziku i trazirave dhe do të mbizotëronin lakmuesit.

Prej shembujve tjerë të ta kemi edhe: Akti i kurorëzimit me shpejtësi,¹¹² e cila mund të shpie deri te fitimi i pasurisë haram, kur rrugët e fitimit hallall janë të vogla. Ata nuk e pengojnë derisa të mos vjen çështja në pikën

e rënies në dëmtim më të madh e ajo është frika për të mos rënë pre e prostitucionit, bile edhe për të anashkaluar në tërësi martesën. Kjo mund të jetë e domosdoshme por mund të jetë edhe e nevojshme.

Prej shembujve tjerë, te Hanefijtë është pranimi i dëshmimeve me të dëgjuar në vërtetimin e vakëfeve të vjetra të cilave u kanoset rreziku. Kjo veprohet kështu edhe pse është në kundërshtim me tekstin i cili e kushtëzon që dëshmia e dëshmitarit duhet që të ketë qenë prezent. Dihet se peygamberi s.a.v.s. kur e ka pyetur një dëshmitar për dëshmimin e tij, - A po e sheh diellin? Ai i thotë, - Po. Pastaj peygamberi s.a.v.s. i thotë, - Nëse sheh kështu, dëshmo, në të kundërtën mos dëshmo.¹¹³

Komenti i Malikijve në çështjen e të kundërshtuarit të interesit me tekstet

Në lidhje me këtë temë, vërejtëm se Malikijtë dhe Hanefijtë janë ndikuar nga disa libra të mëhershëm dhe të sotme dhe e refuzojnë lajmin e vetmuar kur të jetë në pyetje interesi. Kjo qasje kuptohet qartë nga dy aspekte. Për të kuptuar të vërtetën themelore është ajo se argumentimi i interesit nuk është argument të cilin e sheh vetëm logjika, por është rrugë prej rrugëve të argumentimit me tekste të sheriatit e cila i bashkëngjitet ligjit dytësor (degëzor ose ndodhisë) edhe pse nuk dokumentohet me tekst konkret, por që e ka dëshmuar baza e tërësishme, e që njihet si harmonizimi i veprimit të Ligjvënësit nga tërësia e teksteve.

E para: Specifikimi i tekstit nëpërmjet parimit të interesit.

Prej interesave të tërësishme e që janë më të rëndësishmet te Imam Maliku, në bazë të ixhtihadit të tij janë:¹¹⁴

1. **Hipotetika në ligje**, që do të thotë, të llogariturit e një çështjeje hipotetike si çështje praktike. Nga kjo bazë ligjore apo interes i tërësishëm rezulton ligji që alkoolisti të ndëshkohet me tetëdhjetë goditje (shkopinj) sepse Ligjvënësi këtë parim e ka marrë nga të vetmuarit me një grua të panjohur, sepse ekziston dyshimi për prostitucion dhe po ashtu të ndalurit e udhëtimit të gruas pa kujdestar për shkak se ekziston dyshimi për prostitucion. Ndalohet martesa e femrës me dajën apo axhën e saj sepse

shkëput lidhjet farefisnore, si dhe obligueshmëria e marrjes gusul për shkak të prekjës së organit gjenital me organin gjenital. Ndalimi i pirjes së uthullës pas të tretës herë sepse dyshohet për përdorim alkooli. Ndalimi i blerjes së borxhit dhe dhurimi i borxhit. Privimi i vrasësit nga trashëgimia.

Të llogariturit e shkakut në vend të shkaktuesit. Të llogariturit e një çështjeje hipotetike si çështje e ndodhur (praktike). Në bazë të këtij parimi analogohet ndëshkimi i alkoolistit me tetëdhjetë goditje (shkopinj) sepse është në harmoni me veprimin e Ligjvënësit në përpilimin e ligjeve dhe nuk është interes të cilin e parasheh vetëm të menduarit apo ligjësim me mendje, me dëshirë apo sipas appetitit.

2. Obligueshmëria e dhënies përparësi interesit të përgjithshëm ndaj atij të veçantë. Kjo bazë e sheriatit bazohet në atë se pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen e rezidentit me jorezidentin,¹¹⁵ dhe të takimit jashtë qytetit të tyre, me qëllim që të sigurohet interesi i qytetarit dhe tregtarëve dhe po ashtu është i ndaluar monopolizimi për t'u siguruar interesi i përgjithshëm. Lejohet të izolohet i çmenduri për t'u siguruar pasuria e shoqërisë. Ebu Bekri kur është bërë halife i besimtarëve, e ka ndërprerë tregtimin për veten e tij ashtu që të lë të lirë interesin e muslimanëve.

Te Malikijë, ky parim praktikohet me rastin e dënimit të paradhënies për produktin nëse produktet dëmtohen në duart e tyre (prodhuesve). Lejohet që të rrahet i akuzuari për të treguar dhe shpëtuar pasurinë nga hajnat dhe uzurpatorët ose për të tregtuar për veprimet e tyre kur ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme se i akuzuari i di.

3. Domosdoshmëria e largimit të dëmit më të madh prej dy dëmeve. Kjo bazë e sheriatit rezulton në ligjësimin e luftës edhe pse lufta merr jetë të njerëzve sepse me të mënjanohet dëmi nga sulmet e armikut dhe siguri i fesë. Argumentim për këtë kemi ligjësimin e hakmarrjes dhe dënimeve strikte, e cila është ligjësuar vetëm për të siguruar shpirtrat, pasurinë dhe nderin. Pastaj, luftimi ndaj kriminelëve dhe penguesit e zekatit, për të parandaluar trazirat dhe çrregullimin në shoqëri. Urdhërimi në punë të mira dhe parandalimi i të këqijave është bërë për interes shoqëror.

Në bazë të këtij parimi, Shatibiju e ka lejuar institucionalizimin e taksës së haraxhit atëherë kur zbrazet buxheti dhe forcat e armatosura kanë nevojë për fonde. Imami është argumentuar që ashtu të shtohet numri i ushtarëve të ushtrisë me qëllim që të parandalohen trazirat dhe të sigurohet shteti. Po

ashtu, në bazë të këtij parimi Shatibiu ka lejuar që të blihet e nënvlerësuar dhe jo e mbivlerësuar dhe emërimin e imamit i cili nuk është muxhtehidë në shkenca të sheriatit atëherë kur nuk ekziston asnjë muxhtehidë.

4. Domosdoshmëria e sigurimit të jetëve. Është bazë e tërësishme sheriatike. Argument për këtë kemi ndalimin e vrasjeve dhe ligjësimin e dënimit të hakmarrjes për vrasësin dhe për të mos u shfarosur obligueshmëria e ushqimit. Po ashtu obligueshmërinë e zekatit dhe zgjerimin e mundësive për nevojtarët. Po ashtu krijimin e institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe ushtarake.

Në bazë të këtij parimi zbatohet dënimi i një grupi për shkak të vrasjes së një individi dhe po ashtu nëse hyn në një tokë e cila është e ndaluar, lejohet të ushqehet me haram vetëm në masë të mbulimit të nevojës ushqimore.

5. Kjo është një bazë sheriatike e cila kërkon sigurimin e interesit të përgjithshëm ose prioritetin e saj ndaj interesit të veçantë.

Këtë parim e ka zbatuar Maliku, në rastet për kriminelin kur ai është dënuar për çështje materiale. Imam Maliku ka marrë vendim që t'i sjell zafranin të cilin e ka fituar me mashtrim mashtruesi dhe t'u jepet sadaka të varfërve. Po ashtu Umeri r.a. ka urdhëruar që të derdhet qumështi i keqpërdorur.

Nga këto fetva, mund të përfundojmë në atë se kanë bazë në interesin e përgjithshëm te Imam Maliku dhe prodhojnë rezultate si në vijim:¹¹⁶

Rezultati i parë: Të argumentuarit me parimin e interesit është rrugë e veçantë e të argumentuarit me tekstet e sheriatit.

Në drejtimin e imam Malikut, argumentimi me parimin e interesit nuk konsiderohet argumentim jashtë kornizave të teksteve të sheriatit, por është rrugë e veçantë e të argumentuarit me tekste sheriatike.

Te imam Maliku, dispozita ose merret prej vet tekstit, që do të thotë prej “shprehjes së tekstit” e cila quhet argumentim me argumentim tekstual, si f.v. thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ ط

“Dhe mos e mbytni njeriun të cilin e ka ndaluar Allahu, pos me të drejtë.” (El En’am : 151) kjo është shprehje e cila e tregon ndalimin e vrasjes, ose merret dispozita nga logjika e ndonjë teksti, e kjo është

analogjia, ose parimi i interesit dhe kjo ndodh kur teksti dëshmon për ndonjë interes si f.v. ndalimi i çdo lloji të pijeve alkoolike dhe dënimi i pirësit të alkoolit i cili rezulton nga logjika e tekstit të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَمُ رِجْسٌ مِّنْ عَمَلٍ

الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٩٠﴾

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixози, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.” (El Maide : 90), ose merret dispozita nga logjika e teksteve në përgjithësi duke mos qenë i përcaktuar në asnjë tekst në mënyrë të veçantë, por që të gjitha ato tekste bashkohen në një kuptim dhe tregojnë për një bazë të tërësishme e cila llogaritet si interes i patjetërsueshëm për një degë (ligj sekondar) të asaj baze, dhe të një lloji i cili hyn në atë lloj të cilën e dëshmojnë tekstet dhe kështu argumentet janë të qëndrueshme për atë dispozitë, si f.v., dispozita për ndëshkimin e kontratave me paradhënie për prodhimtari dhe dënimi me të holla. Ndëshkimi me goditje për akuzim të padrejtë. Këto dispozita janë marrë nga logjika e shumë teksteve sepse kur të bie ndesh interesi i përgjithshëm me interesin personal, i jepet përparësi interesit të përgjithshëm. Logjika e të vepruarit kështu është në atë se: Përfitohet ky koncept i përgjithshëm nga ato të pjesshme dhe pastaj zbatohet në ato raste sekondare. Kjo quhet të vepruarit me parimin e interesit, që do të thotë: zbatimi i teksteve dhe të vepruarit me logjikën e argumenteve.

Të argumentuarit me parimin e interesit është të argumentuarit me argumente bazike e cila është formuar nga shumë argumente të prera për të. E kjo, është aktivizim i atyre teksteve, e jo jashtë kornizës së atyre teksteve, por që dijetarët e quajnë: argumentim me interesin neutral – korrespondent, sepse nuk merret vetëm nga një tekst i caktuar por merret nga një grumbull tekstesh dhe një grumbull argumentesh. Ky është koncepti i tërësishëm për të cilin Ligjvënësi ka pasur për qëllim me tekstet e tij dhe përpilohen dispozitat. Kështu që është e pamundur që të paraqitet kundërshtimi mes tekstit dhe parimit të interesit pa marrë parasysh se teksti a është i prerë apo jo i prerë sepse ai interes është themeluar nga shumica e përgjithshme e atyre teksteve. Logjikisht dhe juridikisht është e pamundur të ketë kundërthënie në mes të teksteve të shariatit.

Rezultati i dytë: Në çdo interes harmonik mund të analogohet me interesat e përgjithshëm. Te imam Maliku, interesi harmonik është interesi të cilin e dëshmojnë bazat e sheriatit. Dallimi në mes saj dhe kijasit përkufizohet në atë se parimin e interesit e dëshmojnë lloji i teksteve, ndërsa kijasit e dëshmojnë një pjesë e atij lloji të teksteve.

Nga kjo, mund të aprovohet një lloj kijasi në të gjitha rastet e interesit harmonik, saqë Gazaliu e ka quajtur kijasit (analogjia) i interesit, përderisa imam Haramejni e ka quajtur kijasit konceptual (i interesit).

Imam Maliku e ka caktuar dënimin e alkoolistit me tetëdhjetë goditje, si rrjedhojë nga kijasi i interesit me kijasit harmonik, po ashtu në ndëshkimin e paradhënies në prodhimtari, në rrahjen e të akuzuarit në dënimet materiale, në institucionalizimin e haraxhit. Në autorizimin për imam personin i cili nuk është muxhtehidë, për të parandaluar të keqen dhe sigurimin e sistemit shoqëror. Për t'u lejuar vazhdimi i kryerjes së detyrës së atij i cili është më pak i ditur se sa tjetri i cili është më i ditur, vetëm e vetëm për të mos shkaktuar trazira dhe për sigurimin e vendeve islame.

Përfundim: Te imam Maliku, parimi i interesit është: Interesi të cilin ndonjë tekst i caktuar as nuk e ka dëshmuar, por edhe nuk e ka anuluar, por është interes në harmoni dhe në përputhshmëri me tekstet. Harmonizimi i interesit nënkupton që të jetë brenda llojit të interesit të cilin e parasheh ligjvënësi ose është bazë e tërësishme e formuar nga një numër i konsiderueshëm i teksteve.

Lidhshmëria e interesit me tekstin shihet në dy aspekte:

E para: Kthimi i interesit parësor të degës në bazën e tërësishme ose në llojin për të cilin kanë dokumentuar tekstet në mënyrë globale. Ky kusht është i patjetërsueshëm për ta marrë në konsideratë çdo interes gjatë ligjësimit dhe nuk merren për bazë interesat e rralla.

E dyta: Që të mos bie ndesh interesi me ndonjë tekst të caktuar dhe nuk merret parasysh interesi i anuluar.

A i jep imam Maliku prioritet interesit ndaj tekstit?

E vërteta është se imam Maliku nuk i jep përparësi parimit të interesit ndaj tekstit, ose që të specifikoj përgjithësimin e tekstit me parimin e interesit. Në fetvatë e tij, nuk mund të hasësh se i ka dhënë përparësi interesit ndaj tekstit, e edhe po të supozonim se në ndonjë ndodhi me anë të fetvasë së tij e ka kundërshtuar përgjithësimin e tekstit, ajo çka e specifikon atë përgjithësim nuk është interes parcial, por janë tekste të shumta të tërësishme të cilat dëshmojnë në llojin e atij interesi. Ne e kemi bërë të ditur se çdo interes të cilin e parasheh imam Maliku në ligjësimin e interesit të llojit, i cili lloj interesi është në përputhshmëri me frymën e Ligjvënës. Ky interes harmonik vjen në pyetje kur interesin e vendosim brenda bazës ligjore të cilën e dëshmojnë tekstet në mënyrë globale.¹¹⁷

E dyta: Fetvatë e rezultuara nga imam Maliku.

Kjo temë bëhet e qartë kur t'i sqarojmë fetvatë, për të cilat është thënë se kanë specifikuar tekstet me parimin e interesit.¹¹⁸

1. **Të mos obligohet për gjidhënie bashkëshortja me reputacion.** Kjo fetva nuk bie ndesh me tekstin i cili tekst është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

﴿وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَدَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُتِمَّ الرَّضَاعَةَ﴾

“Dhe nënat le t’u japin gjë fëmijëve të tyre për dy vite të plota, kjo është për ata të cilat dëshirojnë ta plotësojnë gjidhënien.” (El Bekare : 233) sepse ky tekst nuk tregon për obligueshmërinë e gjidhënies për çdo nënë. Për këtë janë pajtuar komentuesit e Kur’anit.¹¹⁹ Mbështetja e Malikut në fetvatë e tij është se tradita në të cilën ka jetuar ka ndikuar që të mos merr vendim që të obligoj gruan e fisshme për gjidhënie, por nëse i jep gjë, ajo meriton shpërblim për gjidhënie, përderisa për gruan e cila nuk ka reputacion nuk ka shpërblim.

2. **Ndëshkimi për prodhimtarinë parapaguese.** Nuk është në kundërshtim me ndonjë tekst të caktuar, por ndëshkimi i prodhuesit është interes i cili bën pjesë brenda llojit të cilin lloj Ligjvënës e ka konsideruar në shumë tekste në mënyrë globale dhe është marrë nga një numër i konsiderueshëm i argumenteve, të cilat argumente tregojnë për t’i dhënë përparësi interesit të përgjithshëm ndaj interesit të veçantë në secilin rast,

për të cilin nuk ekziston tekst konkret nëse ekziston krahasimi në mes të atyre dy interesave, shembull, ndalesa për vendtakimin e produktit dhe blerja e rezidentit ndaj jorezidentit. E gjithë kjo është për të siguruar interesin e qytetarit.

Nëse vërehet ndryshimi i kohës dhe njerëzit degjenerohen ashtu që prodhuesit i shtypin besnikët dhe në të shumtën e rasteve u bëjnë padrejtësi, atëherë prodhuesi është i akuzuar, ku në të shumtën e rasteve ai nuk duhet të jetë i akuzuar, sepse ndonjëherë produkti për të cilin akuzohet, nga aspekti i jashtëm tregohet se ai ka të drejtë (e jo blerësi) dhe përderisa akuzuesi duhet të ketë dëshmi, atëherë prodhuesi ndëshkohet deri sa të sjellë dëshmi se produkti është dëmtuar (nuk është cilësor) nga faktorët e jashtëm, e jo prej tij. Kështu, ndëshkimi bëhet në bazë të tekstit dhe në bazë të ixhtihadit në formulën e tekstit dhe nuk është veprim apo mendim i dhënies përparësi interesit duke e kundërshtuar tekstin.

3. Pranimi i dëshmisë së fëmijëve për plagë të shkaktuara. Kjo nuk llogaritet specifikim i tekstit, i cili tekst është dëshmimi i dy dëshmitarëve, vetëm për sigurimin e interesit të qytetarit, por është interes harmonik i llojit të frymës shariatike, i cili bën pjesë brenda kornizës bazë të cilën Ligjvënësi e ka llogaritur si bazë nëpërmjet argumenteve të shumta dhe teksteve në mënyrë globale. Kjo bazë është bazë për të siguruar që të mos ndodhë gjakderdhja, e cila bazë rezulton nga shumë tekste të vazhdueshme të shariatit të cilat e dëshmojnë këtë në mënyrë të prerë.

Edhe poqëse themi se këtë lloj interesi nuk e tregojnë tekstet se është në harmoni me ta, atëherë specifikimi i tekstit është ixhmai i banorëve të Medinës, të cilin argument imam Maliku e ka vendosur në vendin e hadithit mutevatir.

4. Kohëzgjatja e idetit për atë e cila nuk ka menstruacione. Te imam Maliku zgjat një vit, me fjalë tjera tre muaj pasi që t'i kalojnë nëntë muaj. Bazë e kësaj fetvaje është ixhmai i banorëve të Medinës, ose i Medhhebit të Umerit, dhe assesi nuk konsiderohet specifikim i tekstit:

وَالْمُطَلَّقَاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ

“Dhe të shkurorëzuarat, le të presin tri etapa të pastrimit.” (El Bekare : 228) Pra, nuk është dhënë fetva vetëm në bazë të parimit të interesit.

5. Ekzekutimi i tradhtarit shpifës dhe mospranimi i pendimit të tij. Nuk është interes në kundërshtim me tekstin, por ekziston hadithi **“Jam i urdhëruar që t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe nëse e dëshmojnë këtë, e kanë të garantuar nga unë jetën dhe pasurinë e tyre.”**¹²⁰ Por specifikim i hadithit është:

فَلَمْ يَكُ يَنْفَعُهُمْ إِيْمَانُهُمْ لَمَّا رَأَوْا بَأْسَنَا ط

“Dhe nuk iu bënë dobi atyre besimi i tyre, kur të shohin rrezikun nga ne.” (Gafir : 85) Edhe po të deklaronim se bazë e kësaj fetvaje është parimi i interesit, ky interes prapëseprapë nuk është në kundërshtim me tekstin, por është interes në interpretim të tekstit.

6. **Burgosja dhe detyrimi për të akuzuarin.** Kjo nuk është dëshmuar nga imam Maliku, që i akuzuari të pranoj krimin e bërë, siç pretendojnë disa Malikijë, por është prej disa dijetarëve Malikijë. Por edhe nëse e pranojmë këtë se është prej tij, prapëseprapë nuk është interes i pabazuar përballë tekstit të hadithit **“Argumenti për akuzuesin dhe përbetimi për të akuzuarin (refuzuesin).”**¹²¹ por është interes në harmoni, por mbështetjen e ka në interesin i cili është në frymën dhe harmoninë e veprimeve të Ligjvënësit dhe bën pjesë brenda kornizës së llojit të teksteve në mënyrë globale, edhe pse nuk e dokumenton ndonjë bazë konkrete. Kjo është: i jepet përparësi interesit të përgjithshëm ndaj atij individual. Në të vërtetë, specifikues janë tekstet të cilat dokumentojnë bazën e tërësishme, e jo vetëm interes i pabazuar. Në të vërtetë, detyrimi (rrahja) nuk shpie në pranimin e vetpranimit të tij apo dënimin me pasuri, por është ndëshkim për të akuzuarin dhe për ta qetësuar tjetrin, ose për ta definuar mallin dhe të paraqes argument për ta definuar mallin, dhe të paraqes argument për pronarin e vet. Vetpranimi i të akuzuarit, nuk llogaritet se është në kundërshtim me hadithin e lartpërmendur sepse me hadithin bie ndesh atëherë kur nuk e pranon veprën i akuzuari dhe jo atëherë kur e pranon.

7. 8. **Lejimi i përcaktimit të çmimeve kur të paraqitet nevoja dhe lejimi i të takuarit në periferi (në mes të shitësit dhe blerësit) kur të ketë mall me shumicë.**

Kjo nuk është në kundërshtim me tekstin i cili i ka ndaluar. Siç e dimë nga hadithet e njohura, kjo është praktikum i vet sunetit, të kuptuarit me ixhtihadë arsyen e ndalimit të tyre dhe interpretimin e konceptit në realitet, është interpretim i kuptimit adekuat ose interes i cili rezulton nga vet teksti dhe jo jashtë kornizës së tekstit.

Pejgamberi s.a.v.s. kur e ka ndaluar përcaktimin e çmimit të mallrave nuk e ka ndaluar për shkak të përcaktimit të tyre, por për shkak se në përcaktim paraqitet padrejtësia në tregti, kur bëhet ngritja e çmimeve e cila nuk vjen prej tyre, por për shkak të ofertës dhe kërkesës dhe ata shesin me atë çmim. Nuk ka përcaktim të çmimit nëse nuk paraqitet nevoja e përcaktimit të çmimeve, pra atëherë kur ka mallra të mjaftueshme në treg dhe shitja bëhet me çmimin meritot (të arsyeshëm) pa bërë padrejtësi apo mashtrim, por atëherë kur tregtarët bëjnë monopolizim dhe mashtrime, duke shfrytëzuar nevojën e njerëzve për ushqim, atëherë eksperti jurist (fekihu) jep fetva për lejimin e përcaktimit të çmimit për ta mënjeluar padrejtësinë dhe duke detyruar tregtarët që të jenë të drejtë. Kështu që, përcaktimi i çmimit bëhet për të mos lejuar tregtarët të ngritin çmimet. Ixhtihadi në të bëhet nga interpretimi i tekstit, në dritën e interesit, i cili interes buron nga vet teksti dhe nuk është specifikim i tekstit me parim të interesit dhe as të vepruarit me parim të interesit në kundërshtim të tekstit të hadithit të pejgamberit s.a.v.s. i cili ka ndaluar përcaktimin e çmimeve.¹²²

Sa i përket takimit të tregtarëve në periferi, dihet se pejgamberi s.a.v.s. e ka lejuar një veprim të tillë, për shkak të interesit të blerësve dhe sigurimit të artikujve për ta. Kështu që, nëse ka artikuj të mjaftueshëm në treg dhe çmimi i tyre është i arsyeshëm, atëherë lejohet takimi i tregtarëve në periferi, e kjo për të mbrojtur vet shitësin, për shkak të mosdijes së çmimeve në treg, e kështu mund ta shes mallin shumë lirë, kështu që i lejohet atij ta rikthej mallin (sipas transmetimit të Ebu Hurejrës), nëse shitësi e di çmimin e arsyeshëm apo të shtrenjtë. Kështu që hadithi nuk e ka formuluar në tërësi pengesën.

E gjithë kjo është ixhtihadë që nxjerr në pah: interesin ose urtësinë e cila synohet të arrihet nga dispozita dhe nuk është dhënie prioritet interesit ndaj tekstit të sheriatit, por në realitet është të vepruarit me vet tekstin dhe interpretimin i cili përshtatet me tekstin, ose nëpërmjet faktorëve të cilët i përgjigjen tekstit të cilët faktorë sinjalizojnë interesin i cili rezulton prej tyre, ose urtësinë për të cilën është ligësuar dispozita.

Te disa Malikij, kjo quhet parim i interesit, ose përfitimi i bazës juridike, ose zëvendësim i bazës juridike sikurse te shumica absolute e dijetarëve.

9. 10. Lejimi i shfrytëzimit të pasurisë së luftës kur paraqitet nevoja dhe lejimi i shkulljes së bimëve për haxhiun në kohën e ihramit, nëse ato bimë i dëmtojnë haxhilerët. Fetvaja e imam Malikut për këto dy çështje, dëshmon për një bazë juridike të caktuar dhe nuk është dhënie prioritet

interesit ndaj tekstit të shariatit, por është specifikim i tekstit të shariatit me një tekst tjetër, nëpërmjet kijasit. Dispozita e kijasit është marrë nga logjika e tekstit e cila e ka përpiluar ligjin bazë.

Sa i përket shfrytëzimit të pasurisë së luftës, ky mendim është i preferuar edhe te Shafijjtë edhe te Malikijtë, për t'u bazuar në parimin e interesit për të cilin dëshmon teksti konkret me kijasë. Është vërtetuar në “sahihë” nga ibni Umeri për lejimin e ushqimit, si f.v., mjalti, rrushi, pemët dhe duke krahasuar (duke bërë kijasë). Maliku ka lejuar prerjen e deveve, lopëve dhe deleve duke pasur parasysh se në të dy rastet shuhet uria kur të ketë nevojë.¹²³ Gjë që tregon për specifikimin e tekstit ndalues të keqpërdorimit të pasurisë së luftës. Ky tekst dëshmon ligjin bazë.

Sa i përket prerjes së pemëve të cilat i dëmtojnë haxhilerët në Qabe, është marrë nëpërmjet kijasit të lejimit të mbytjes së pesë kafshëve neveritëse¹²⁴ duke pasur parasysh se edhe në ligjin bazik edhe në ligjin i cili rrjedhë prej tij, arsyeja është e njëjtë. Hadithi **“Mos të shkulet pema, mos të gjuhet dhe mos të mbytet asgjë.”**¹²⁵ është specifikuar me hadithin e lejimit të mbytjes së pesë dëmtuesve dhe nuk është dhënie prioritet interesit pa qenë i bazuar në hadith të pejgamberit s.a.v.s.

Sqarim i mendimit të dijetarit Tufi sa i përket parimit të interesit

Shkurtazi kam treguar për argumentimin e Tufit në dhënie prioritet parimit të interesit ndaj tekstit dhe ixhmait dhe po ashtu kam sqaruar për anët e dobëta të atyre argumentimeve. Në këtë rast do të sqaroj bazat e mendimit të tij dhe idetë e tij anormale.

E para: Bazat e teorisë së Tufit.

Teoria e Tufit në dhënie prioritet interesit bazohet në katër çështje:¹²⁶

Çështja e parë: Mendimi i lirë për t'u kuptuar dëmi dhe dobia (interesi). Tufi mendon se mendimi njerëzor është i lirë për të kuptuar dëmet dhe dobitë në fushën e marrëdhënieve ndërnjerëzore (muamelat) dhe traditës. Kjo është në kundërshtim me mendimin e dijetarëve islam të cilët, dëmin dhe dobinë (interesin) e konsiderojnë si inspirim (udhëzim) nga

tekstet e sheriatit të cilat dokumentohen në lloj të interesit ose të një lloji të frymës së sheriatit.

Çështja e dytë: Interesi është argument i sheriatit i pavarur prej teksteve të sheriatit. Kjo nënkupton se parimi i interesit në argumentimin e vet nuk bazohet as në lloj të teksteve të sheriatit. Kjo nënkupton se parimi i interesit në argumentimin e vet nuk bazohet as në lloj të teksteve të sheriatit dhe as në kategori të saj, por bazohet drejtpërdrejtë dhe tërësisht në logjikë. Te dijetari Tufi, parimi i interesit është ajo çka e gjykon mendja se është interes pa qenë i edukuar për atë ligj nga tekstet e sheriatit, por që edukohet prej traditave dhe eksperiencës, për këtë arsye, tek ai ky është argumenti më i fortë prej argumenteve të sheriatit.

Gjatë sqarimit të parimit të interesit u vërejt qartë se ata të cilët e pranojnë parimin e interesit kanë deklaruar se interesi si argument bazohet në tekste të sheriatit dhe nuk merret për bazë përpos nëse është në harmoni me ligjësimin e Ligjvënësit. Ata e interpretojnë harmonizimin e interesit në mënyrën e futjes së saj brenda kornizës së një lloji të dispozitave për të cilat tekstet dokumentojnë në mënyrë globale. Argumentimi me parimin e interesit të ta është: argumentimi me logjikën e teksteve të cilat dëshmojnë llojin e interesit, që do të thotë se, interesin të cilin e konsiderojnë se është interes është interesi i cili në argumentimin e vet ka mbështetje në tekste të sheriatit.

Çështja e tretë: Fusha në të cilën veprohet me parimin e interesit ka të bëjë me fushën e marrëdhënieve ndërnjerëzore (muamelat) dhe jo me fushën e adhurimit (ibadet). Tufi mendon se parimi i interesit si argument sheriatik merret me fushën e marrëdhënieve ndërnjerëzore (muamelat) por jo edhe me fushën e adhurimit. Sa i përket çështjeve të adhurimit dhe çështjeve të caktimit të Zotit, parimi i interesit nuk mund të jetë argument për ta. Sipas tij, derivimi i dallimit në mes të çështjeve të adhurimeve dhe raporteve ndërnjerëzore është në atë se: Ligjvënësi obligimin e adhurimit e ka paraparë që të jetë posaçërisht për të, përderisa çështjet e raporteve ndërnjerëzore i ka paraparë për dobi të njerëzve. Ai i di më së miri për obligimet ndaj Tij, në çështje të adhurimit, gjë që na obligon neve t'i pasojmë tekstet në lidhje me adhurimet, përderisa robërit e dinë mirë çka është në interes të tyre dhe ato duhet të realizojnë ato interesa edhe nëse nuk përputhen me tekstet e Ligjvënësit.

Shatibiu e ka vërtetuar se fusha e të vepruarit me parimin e interesit ka të bëjë me tradita, raportet ndërnjerëzore dhe jo në adhurime. Në këtë aspekt, Tufi është në pajtueshmëri me Malikijtë.

Çështja e katërt: Parimi i interesit është argumenti më i fuqishëm i ligjësimit. Tufi mendon se parimi i interesit është absolutisht argumenti më i fuqishëm prej argumenteve të sheriatit. Në bazë të kësaj, parimi i interesit nuk është vetëm si argument, nëse për atë çështje mungon teksti apo ixhmai, por parimi i interesit ka përparësi ndaj tekstit dhe ixhmain nëse ka kundërshtim në mes tyre, në atë mënyrë që e specifikon, apo e sqaron tekstin apo ixhmain dhe jo duke e paralizuar tekstin apo duke e anashkaluar atë, njësoj sikurse kur i jepet prioritet sunetit ndaj Kur'anit duke e sqaruar atë. Kështu pra, interesi rezulton prej thënies së të dërguarit të Allahut s.a.v.s.: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”** Kështu i jepet përparësi parimit të interesit ndaj tekstit, pa marrë parasysh a është teksti i prerë në zinxhirin apo përmbajtjen e tij apo jo i prerë në zinxhirin apo përmbajtjen e tij, siç e kemi sqaruar më parë.

Pa marrë parasysh se Tufi nuk e bën dallimin në mes të tekstit të prerë dhe jo të prerë, disa mendojnë se,¹²⁷ mundësia e kundërshtimit në mes të tekstit dhe interesit sipas Tufit ka të bëjë në mes të tekstit dhe interesit, përderisa sa i përket tekstit të prerë, Tufi nuk lejon që interesi të jetë në kundërshtim me tekstin dhe i jep përparësi tekstit ndaj interesit, nëse ndodh një gjë e tillë.

Vërehet qartë se interesi të cilin e parashohin Malikijtë dhe të tjerët, ka të bëjë me dhënien e prioritetit të interesit ndaj tekstit jo të qartë, por edhe nëse presupozojmë se ata e thonë këtë, atëherë: **Është interesi harmonik nga lloji i të vepruarit të Ligjvënësit dhe i cili bën pjesë brenda bazës së prerë të cilën në mënyrë globale e dëshmojnë tekstet, të cilave u jepet përparësi ndaj teksteve jo të prera.** Në të vërtetë është specifikim i teksteve të sheriatit i cili specifikim është i llojit të interesit sheriatik dhe jo i interesit të cilin e gjykon mendja e njeriut siç kemi sqaruar më parë, sepse këtë interes të cilin e deklarojnë Malikijtë dhe të tjerët, nuk e meriton të jetë argument i sheriatit, e mos të flasim që t'i jepet përparësi ndaj teksteve të sheriatit.

Sa i përket parimit të interesit për të cilin Tufi deklaron se është argument, është interesi i cili bazohet në gjykimin e mendjes njerëzore dhe të cilin nuk e kanë dëshmuar tekstet në asnjë rast se është dëshmi, e ai

interes është në kundërshtim me tekstin dhe jo që mbështetet në tekste. Unë veç e kam sqaruar se absolutisht kjo nuk llogaritet si argument.

E dyta: Dyshimet e Tufit në dhënie përparësi interesit ndaj tekstit dhe ixhmait.

Dhënies përparësi interesit ndaj tekstit dhe ixhmait Tufi i argumenton me tri argumente. Këto argumente të pavërteta do t'i sqaroj si në vijim:¹²⁸

Argumentimi i parë: Tufi për të mbrojtur mendimin e vet në dhënien përparësi interesit ndaj ixhmait argumentohet me atë se mospranuesit e ixhmait kanë thënë se duhet të sigurohet interesi. Kjo do të thotë se është pikëbashkimi i tyre, ndërsa ixhmai është argument për të cilin nuk janë pajtuar. Të përmbyturit e asaj për të cilën nuk janë pajtuar. Ky argument i pabazë replikohet si në vijim:

1. Disa refuzues të ixhmait, si f.v., nidhamijtë, shiitët, nuk kanë deklaruar në këtë rast për parimin e interesit, për këtë nuk është i vlefshëm deklarimi i Tufit se, refuzuesit e ixhmait e pranojnë parimin e interesit.

Sa i përket shiitëve, ata nuk e pranojnë parimin e interesit si argument të sheriatit, sepse parimi i interesit është mendim, e tek ata mendimi nuk merret për bazë, por ata e marrin mendimin e imamit që sipas tyre është i pagabueshëm.

Nidhamiu nuk e pranon ixhmain, për shkak se do të argumentohet me mendim të lirë dhe me kijasë, kështu që ka përparësi të mosvepruarit me parimin e interesit.

2. Nuk ka kuptim deklarimi i Tufit për pajtueshmërinë e sigurimit të interesit sepse interesin për të cilin deklarojnë të tjerët si interes, është interesi i cili është në harmoni me frymën dhe veprimet e Ligjvënës, përderisa interesi për të cilin dëshirohet të argumentohet dhe veprohet është interes që është kryesisht i mendjes së pavarur dhe interes që është në kundërshtim me veprimet e Ligjvënës.

3. Disa argumentues të ixhmait, si p.sh., dhahirijtë, këta e refuzojnë sigurimin e interesit, siç thotë edhe vet Tufi, gjë që tregon se është në kundërshtim me deklarimin e tij dhe me bazën e teorisë së tij, pasi që është në kundërshtim me teorinë e tij, kur ai e llogaritet tekstin dhe ixhmain prej argumenteve më të forta, i cili i ka llogaritur nëntëmbëdhjetë argumente, e pastaj prapë ka thënë: I jepet prioritet interesit ndaj ixhmait, kështu pra, interesi për Tufin është argumenti më i fortë ndaj të gjitha argumenteve.

Po ashtu, prej kundërshtimeve me veten e tij është thënia e tij: Sigurimi i interesit është pikë unifikimi dhe pajtimi, ndërsa ixhmai është çështje e mendimeve të mospajtimit, dhe nga shkaku se sigurimi i interesit bëhet si një lloj i ixhmail, atëherë edhe ixhmai i sigurimit të interesit është çështje e mendimeve të mospajtimit, sepse është lloj i ixhmail. Kështu pra, fundoset baza e Tufit në të cilën mbështetet, e ajo bazë është prioriteti i interesit ndaj ixhmail sepse është më i fuqishëm njëri argument, ndërsa më i dobët argumenti tjetër.

Argumenti i dytë: Tekstet janë kundërthënëse dhe kanë mospajtueshmëri. Tufi argumentohet me atë se duhet t'i jepet përparësi interesit ndaj tekstit sepse tekstet janë kundërthënëse dhe kanë papajtueshmëri e kjo është shkak i papajtueshmërisë e cila është prej dispozitave të urryera, përderisa sigurimi i interesit në vetvete është çështje faktike në të cilën nuk ka kundërshtim e kjo është shkak për dispozitat e pëlqyera, për këtë arsye ka përparësi të pasohet. Shihet se ky argument ngërthen në vete dy çështje:

- kundërthënia e argumenteve dhe
- sigurimi i interesit është çështje faktike.

Çështja e parë: Kundërthënia e argumenteve dhe mospajtueshmëria e tyre. Kjo çështje replikohet në dy mënyra:

Mënyra e parë: Argumentet në vijim tregojnë se në tekste në fakt nuk ka kundërthënie dhe mospajtime:

1. Kur'ani – Shumë ajete të Kur'anit tregojnë se ajetet e Kur'anit nuk kanë kundërthënie mes tyre, e prej atyre ajeteve është edhe kjo thënie e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ اخْتِلَافًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾

“Po të ishte (ky Kur'an) prej ndokujt tjetër pos Allahut, do të hasnim në të shumë kundërthënie.” (En Nisa : 82)

Pastaj ajeti tjetër:

فَإِنْ تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ

“Dhe nëse konfrontoheni në mes vete për diçka, atëherë kthehuni te Allahu dhe i dërguari i Tij.” (En Nisa : 59) Kjo do të thotë se tekstet e

shariatit janë bazë për të mėnjanuar kundėrshtimet dhe nuk mund tē paramendohet nė asnjē ast qē tē ketē mospajtime dhe kundėrthēnie, sepse atēherē do t'i vishej mangēsi zbritjes sē Kur'anit dhe ky ēshtē gjykim absurd pasi qē (Kur'ani) i ka plotēsuar kushtet e pajtueshmērisē dhe tē konsensusit se ēshtē i pagabueshēm. Po si tē jenē tekstet kundėrthēnēse, kur dihet se janë prej Allahut, dhe argumentimi se ēshtē prej Allahut ēshtē se ka lidhshmēri nė Kur'an dhe pajtueshmēri dhe harmonizim nė mes teksteve dhe nuk ka kundėrthēnie nė mes tē kuptimit dhe teksteve tē tij.

2. Po tē kishin qenē tekstet e shariatit nė kundėrshtim dhe nė papajtueshmēri nė mes vete, atēherē (sheriati) do tē na shpinte nė ēshtjen e obligueshmērisē sē papėrballueshme sepse nēse dy tekste kundėrshtohen nė mes vete, do tē bēhej e pamundur tē veprohej me ta sepse p.sh. ndonjē tekst kėrkon tē veprohet dika, e nė anēn tjetėr teksti tjetėr do ta ndalonte po tē njējtin veprim.

3. Nuk mund tē paramendohet qē nė realitet tē ketē kundėrthēnie nė mes tē teksteve sepse kjo do tē shpinte nė humbjen e konceptit tē qēllimeve tē Ligjvėnėsit nė ligjėsimin e ligjeve. Shatibiu ka deklaruar kėshtu: Nuk mund tē paramendohet qē tē ketē kundėrthēnie nė mes tē dy argumenteve pėr dika sepse p.sh. nēse Ligjvėnēsi nuk mund ta arrij qēllimin e Tij nė argumentet kundėrthēnēse sepse kur pėr njē ēshtje thotē **“veproje”** dhe po pėr atē ēshtje thotē **“mos e vepro”** nuk do tē mund tē kuptohet kėrkesa e veprimit prej fjalės sē kėrkėsės sē “mosveprimit” dhe urdhėrimit tē veprimit sepse fjalēn “vepro” nuk mund ta perceptoj i ngarkuari me ngarkesēn dhe nuk e di se cilēn detyrē duhet ta kryejē nė atē rast.

Argumentet tē cilat janë pėrmendur janë tē shumta dhe nuk ka nevojē ta zgjasim mē shumē pėr tē zhvlerēsuar pretendimet pėr kundėrthēnie nė shariat.¹²⁹

E dyta: Kundėrthēnia e teksteve nė shikim tē muxhtehidit nuk shpie nė kundėrshtimet e urryera ligjėrisht. Tufi deklaron se kundėrthēnia e teksteve shpie nė kundėrshtime dhe kēto kundėrthēnie dhe kēto kundėrshtime janë shkak i kundėrshtimit tē urryer ligjėrisht. Tufi arsyetohet me kundėrshtimin i cili ligjėrisht urrehet dhe tėrheq vėrejttjen me po tē njējtat tekste tē cilat dēshmojnē pėr zhvlerėsimin e pretendimeve se nė tekstet e shariatit ekzistojnē kundėrthēnie dhe mospajtime.

Kjo replikohet me atē se kundėrshtimin tē cilin Ligjvėnēsi e ndalon dhe tėrheq vėrejttjen, nuk ka tē bējē me kundėrshtimin nė tē kuptuarit e teksteve tē cilat Allahu ka urdhėruar tē pasohen sepse nė atē rast Ligjvėnēsi do tē

ishte në kundërshtim me veten e Tij, pasi që urdhëron për pasimin e teksteve e më pastaj mospasimi kur të ketë mospajtime dhe kjo kërkon që disa muxhtehidë të perceptojnë një kuptim e disa të tjerë të perceptojnë kuptim tjetër e pastaj Ligjvënësi ta ndaloj atë mospajtim dhe ta tërheq vërejtjen për atë mospajtim, e këtë nuk e thotë asnjë i logjikshëm.

Papajtueshmëria e urryer është si produkt i gjykimit të ideve dhe të pasimit të epsheve e cila është në kundërshtim me atë të cilën kanë ardhur tekstet e shariatit.

Nëse tekstet shpijnë në drejtimin e kundërshtimit për të cilën Ligjvënësi i ka urryer dhe ka tërhequr vërejtjen, atëherë Ligjvënësi nuk do t'i kishte zbritur ato tekste dhe nuk do t'i kishte urdhëruar robërit për t'i pasuar, por e ka lejuar hulumtimin për t'i perceptuar kuptimet.

Nëse Tufi ka pranuar se tekstet e shariatit janë argumente në adhurime (ibadet) dhe se në ta nuk ka të bëjë interesi, me fjalë tjera, në ato argumente nuk ka mospajtime, pse atëherë nuk i trajton ashtu edhe tekstet që kanë të bëjnë në tradita (adat) dhe në marrëdhëniet reciproke (muamelat) pasi që burimi i tyre është i njëjtë.

Nëse në tekstet që kanë të bëjnë me adhurimet (ibadet) në sy të ndonjë muxhtehidi haset ndonjë mospajtim atëherë është e mundur që ato të tubohen dhe elaborohen nëpërmjet rrugës së bashkimit dhe unifikimit të tyre, pse të mos ketë mundësi që të tubohen dhe elaborohen nëpërmjet rrugës së bashkimit dhe unifikimit të tyre në tekstet që kanë të bëjnë në marrëdhëniet reciproke (muamelat).

Sa i përket çështjes së dytë. Sigurimi i interesit është realitet i pamohueshëm i cili nuk lejon mospajtime.

Edhe kjo replikohet me atë se në esencë dhe në praktikë ka ndodhur mospajtimi në bazën e interesave dhe të dëmeve.

Me këtë argument argumentohet Tufi se duhet t'i jepet përparësi interesit ndaj teksteve të shariatit duke deklaruar se sigurimi i interesit është realitet i pamohueshëm i cili nuk lejon mospajtime dhe kjo është shkak i unitetit i cili ligjërisht kërkohet, mirëpo kjo bie ndesh nga dy aspekte:

E para: Po ashtu edhe tekstet e shariatit janë çështje që në vetvete nuk lejojnë papajtueshmëri dhe nga ky nivel janë të njëjtë me interesin.

E dyta: Praktikumi parimit të sigurimit të interesit në realitet dhe në çështjet parciale nuk është shkak i unifikimit i cili kërkohet ligjërisht, argument për këtë e kemi realitetin i cili paraqitet tek njerëzit, e ajo është se mendjet të cilat nuk janë burim i ligjeve të cilat zbresin nga qielli

ndryshojnë në bazën e interesave dhe dëmeve, bile edhe pajtimin e tyre në atë çështja se interesi apo dëmi ndryshojnë në çështjet parcialet të cilat realizojnë ato interesa ose që mënjanojnë dëmin, prapëseprapë kjo nuk tregon për atë se ekziston konfrontim i së vërtetës dhe të pavërtetës kur të zbresin shpalljet qiellore tek peygamberët siç i kanë kundërshtuar popujt e tyre peygamberët e tyre në shikimin e dëmit dhe të interesit, dhe të kundërtën në mes tyre dhe nga ajo që ekziston sot në ligjet dhe filozofitë të cilat imoralitetin e llogarisin si të ligjshme, po ashtu të mirën e llogarisin të keqe e po ashtu edhe traditat e karaktereve, vlerave dhe feve.

Këtyre mospajtimeve dhe këtyre mendimeve në çështje të interesave dhe largimit të dëmeve, mund t'i shpëtojmë vetëm duke i pasuar tekstet. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَلَوْ أَتَبَعَ الْحَقُّ أَهْوَاءَهُمْ لَفَسَدَتِ السَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ

“Sikur e vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe toka dhe gjithçka që gjendet në to.” (El Muëminunë : 71)

Edhe poqëse replikohej se ndonjëherë tekstet shpijnë në rrugën e papajtueshëmisë, kjo është e lavdëruar dhe ligjërish nuk është e nënçmuar, sepse muxtehidi është përgjegjës që të mos del jashtë kornizës së teksteve të prera dhe është i kushtëzuar me tekstet e prera për të mos lënë hapësirë për t'i tubuar të gjitha kuptimet e tekstit dhe në realitet ato janë tekste të kufizuara dhe të cilat orientojnë në çështje për të cilat nuk ka tekst në ndodhitë në të cilat ka interesa të cilat i dëshmojnë ato tekste për llojin e atij interesi i cili llogaritet interes.

Ku është kjo, që të lihet anash logjika me Ligjin e cila është në përputhshmëri me interesin pa kritere siç e mendon Tufi?! dhe po ashtu mendimet e ndryshme dhe lirinë e mendimit për të përcaktuar interesin dhe dëmin e pakushtëzuar.

Argumenti i tretë: Zbritjen e teksteve nga suneti të cilat i kundërshtojnë interesat. Tufi deklaroi se është vërtetuar se në disa çështje suneti bie ndesh me interesat, prej tyre ka përmendur: Ibn Mes'udi e ka kundërshtuar tekstin dhe ixhmain në rastin e tejemumit për shkak të interesit të paraparë në adhurim.

Rast tjetër: E kanë kundërshtuar sehabet thënien e peygamberit s.a.v.s. kur ka thënë: **Asnjëri prej jush mos ta falë ikindinë pa arritur te fisi beni**

Kurejdha.¹³⁰ E disa e kanë falur ikindinë pa arritur atje dhe kanë thënë: Me këtë nuk e ka pasur për qëllim për ne.

Rast tjetër: Kur Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë Aishës r.a.: **Po mos të ishte populli yt në fazën fillestare të islamit, do ta rrënoja Qaben dhe do ta ndërtoja mbi themelet e Ibrahimit.**¹³¹ Kjo dëshmon se rindërtimi i Qabes në themelet e Ibrahimit është vaxhib, mirëpo nuk ka vepruar për shkak se ka qenë në interes të shoqërisë.

Rast tjetër: Pejgamberi s.a.v.s. kur i ka urdhëruar që haxhin ta rikthejnë në umre, i kanë thënë: Po si ta rikthejmë në umre kur deri tani e dimë se jemi për haxh¹³² dhe janë ndalur. Kjo do të thotë se e kanë kundërshtuar tekstin me anë të traditës.

Rast tjetër: Kur pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar Ebu Bekrin që të thërret me zë: **“Kush thotë La ilahe il-lall-Llah do të hyjë në xhenet.”** E Umeri e sheh dhe i thotë, - Kështu ata do të bëhen përtacë.¹³³ Kjo do të thotë se e ka kundërshtuar tekstin me parimin e interesit.

Rast tjetër: Një njeri hyn në xhami dhe falet, ndërsa sehabet habiten me të (duke e ditur reputacionin e tij të keq). Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi Ebu Bekrin dhe Umerin që ta vrasin atë. Ata dy refuzuan duke i thënë, - Si ta vrasim njeriun përderisa ai është duke u falur.¹³⁴ Këto dy sehabë e kanë lënë tekstin dhe këtu nuk ka mbështetje në diçka tjetër përpos respektimit të ibadetit dhe kjo do të thotë kundërshtim i tekstit me parimin e interesit dhe këtë më pastaj e ka miratuar pejgamberi s.a.v.s. dhe e ka lejuar ixhtihadin e tyre, pasi që e ka kuptuar qëllimin e tyre dhe sinjeritetin e mendimit të tyre.

Pasi janë sjellë këto ndodhi, Tufi ka deklaruar: Po kështu, kushdo që e ka paraqitur sigurimin e interesit të të ngarkuarve me argumentet tjera të sheriatit ai e ka pasur për qëllim përmirësimin e gjendjes së tyre dhe realizimin e asaj çka Allahu i Lartmadhëruar i ka graduar që të jetojnë sa më mirë dhe i ka tubuar ligjet të cilat prej tyre ka që përputhen, por ka që nuk përputhen dhe kështu ato ligje lejohen nëse nuk janë të përcaktuara dhe duhet që t'i jepet prioritet sigurimit të interesit ndaj argumenteve tjera të sheriatit, kur janë në pyetje çështjet e ixhtihadit të nivelit më të ulët se përndryshe ajo është prioritarja e përcaktuar, siç e kemi cekur më lartë.

Mendimi i tij replikohet me atë se, një veprim i tillë është i pavlefshëm, sepse këto ndodhi përfshijnë në vete të vepruarit sipas mënyrës së vet Ligjvënësit. Baza e kësaj është të vepruarit me sunetin shprehimor, vepror apo miratues.

Vet personi ligjërues (Ligjësues) është ai i cili nuk e ka rindërtuar Qaben mbi themelet e Ibrahimit, e si mund të thuhet: I dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka kundërshtuar tekstin me parimin e interesit. Po cilin tekst e ka kundërshtuar peygamberi s.a.v.s.? dhe a nuk llogaritet ligjësimi shprehimor (me anë të fjalës), vepror dhe miratues, si vet tekst ligjësues?!

Personi ligjësues është ai i cili e ka miratuar ixhtihadin e Umerit kur e ka ndaluar thirrjen e Ebu Bekrit në rastin e hadithit: **Kush thotë “La ilahe il-lall-Llah” do të hyjë në xhenet.**

Po ashtu vet Muhamedi s.a.v.s. është ai i cili e aprovoi ixhtihadin e Umerit dhe Ebu Bekrit për mosvrasjen e falësit. Nëse veç është i saktë ai lajm (transmetim). Kështu, ky ixhtihadë i tyre me aprovimin e peygamberit s.a.v.s. është sunet.

Sehabet të cilët janë falur para se të arrijnë te fisi beni Kurejdha kanë bërë ixhtihadë në bazë të urtësisë së interesit, të cilin e kanë kuptuar prej tekstit dhe jo pse e kanë anashkaluar tekstin me parimin e interesit.

Sa i përket Ibn Mes’udit, në atë se e ka anashkaluar tekstin i cili e lejon tejemumin kur njeriu është xhunub dhe këtë e ka bërë për shkak të interesit. Ky mendim është i ekzagjeruar sepse mbështetja e Ibn Mes’udit për moslejimin e tejemumit për shkak të papastërtisë është vet teksti, prej të cilit është kuptuar për prekje të bashkëshortes, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ

“Ose nëse i keni prekur gratë.” (En Nisa : 43) Pra është prekje ajo e cila e obligon abdesin dhe jo kontaktimi seksual.

Dhe në fund – Tufi argumentohet me veprimin e Ibni Mes’udit dhe të tjerëve, ndërsa sehabet nuk janë argument në çështjet e adhurimit edhe pse thënie e tyre llogariten si interes në tradita, por jo edhe në adhurime, përderisa sa i përket adhurimeve nuk pranohen si argument, përpos prej ixhmait, tekstit dhe argumenteve të tjera të sheriatit.

A nuk është edhe kjo një formë tjetër e mendimit të tij kontrovers dhe çuditës, dhe i cili është në kundërshtim me themelet e drejtimit të tij dhe një argument i cili i hedhë poshtë pretendimet e tij në dallimin e adhurimeve dhe marrëdhënieve reciproke dhe përparësi ka mbështetja në tekste e më pastaj në sigurimin e interesave.

Këto tri mendime të Tufit, me të cilat pretendon se duhet t’i jepet përparësi sigurimit të interesit ndaj tekstit dhe ixhmait, që të gjitha janë të paqëndrueshme dhe iluzionare dhe nuk kanë të bëjnë me realitetin.

Fusnotat:

1. “El Mustesfa”, 1/139.
“Sherhul Esnevi”, 3/67.
“El-Med-hal ila medhheb Ahmed”, 136.
“El-Ibhaxh”, 3/43-111.
“Revdatu Nadhir”, 1/412.
2. “El-muvafekat”, 1/38.
3. Malikijt, Shafijjtë, këto baza vitale i renditin si vijon: Feja, jeta, mendja, pasardhësit, pasuria.
Hanefijjtë i ka renditur ndryshe: feja, jeta, pasardhësit, mendja pastaj pasuria sepse këto janë të drejta të njeriut për këtë arsye i jepet përparësi kisasit (hakmarrjes) ndaj ekzekutimit të tradhtisë (largimit nga feja) dhe i dorëzohet kujdestarit dhe jo qeveritarit dhe anashkalohet xhumaja dhe xhemaati për të siguruar fenë dhe tradhëtia është e drejtë e Allahut që anon në të shumtën e rasteve e drejta e robit dhe dorëzimi i të drejtës te kujdestari është bashkim i dy të drejtave, ndërsa anashkalimi i xhemaatit nuk ka të bëjë me prioritetet e asaj të cilën e hulumtojnë. (“El-muvafekatë”, 2/10; “El-mustesfa”, 1/140; “Muslim Thubut”, 2/283.
4. Ibni Haxheri ka thënë: Nuk e kam parë në këtë formulim të tekstit, por në hadithin e Sead bin Ebi Vekasit te Bejhekiju: Vërtet Allahu, kallugjerizmin na e ka shndërruar në pastërti dhe tolerancë. Në hadithin tjetër: Martohuni sepse do të jemi me më së shumti popullatë prej popujve tjerë dhe mos u bëni kallugjer si në krishterizëm. Transmeton Bejhekiju ng aEbi Umamet. Sujutiju ka thënë: Është i dobët. (“El-Xhamiu Sagirë”, “Keshful Hafa”).
5. E kanë regjistruar dy shejhët dhe Nesaiju nga Enes bin Maliku r.a. (“Rijadus-Salihijn”, 75; “Xhem’ul Xhevamiu”, 1/32).
6. “Sherhul Udad ala muhtesar el muntehij”, 2/242-289.
“El-Med-hal ila medhheb Ahmed”, 138.
7. “El Muvafekat”.
“Revdatu Nadhir”.
“Sherhul Udad”.
“Fevatihü Rahmut”.
“El Mustesfa”.
“Sherhul Esnevi”.
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë”.
“Il-Ibhaxh sherhul minhaxh”.
“El-med-hal ila medhhebil Ahmed”.
“Usulul Fikh – lil Hudarij”.
“Usulul fikh – li Ebu Zehra”.
8. “El-mestesfa”.
9. “El muvafekat”.
10. “El muvafekat”
“Mudhekerat, 7, shejh Muhamed Zafzaf min edileti muhtelifu fijha”.
11. “Sherhul Esnevi”.

“Nihajetul usul sherh minhaxhul vusuli ila ilmil usul lil Bejdaviju”, 3/164.

“Irshadul Fuhul”.

“El-med-hal ila medhhebi Ahmed”.

12. “El ihkam fi usulil-Ahkam”, 138.

13. “El mustesfa”.

14. “El-mebadiul ameti lil-fikh-lil Xhaferij”, 304.

“Usulul istinbatë lil Hajderij”, 265.

15. “El med-hal-lil Gazalij”, 354.

“Usulul ameti”, 404.

16. Vërehet se këtë e ka transmetuar Gazaliu nga Imam Maliku. Nuk ka bazë në këtë medhheb, por është bërë e njohur dhe është përhapur në mes njerëzve pa pasur ndonjë mbështetje apo bazë e cila i vërteton këto fetva se janë dhënë prej tij.

Po ashtu nuk është vërtetuar nga Imam Maliku se e ka lejuar vrasjen për dënim të papërcaktuar ose që e ka lejuar të rrahet i akuzuari për të treguar qte që dëshirohet ose që e ka lejuar që t’u merret pasuria të varfërve për shkak të interesit.

17. “El Mustesfa”, 1/140-142.

18. “Imam Hanbel”, prof. Muhamed Ebu Zehra, 298.

19. “Muleh-has Ibdalul-kijas”, 5.

20. “El-Esneviyu”.

“Mudhekerat fi usuli fikh”, shejh Zekijr, 185.

21. “El-ihkam fi usulil ahkam”, el Amedij, 2/138.

22. “Iëlamul mukiijn”, 3/14.

“Sherhul Esneviyu”, 3/165.

23. E ka thënë Ibni Haxhibi në librin “Sherhul Udadi”, 2/238. Shihet qartë përgjithësimi në ajetin e lartpërmendur, që do të thotë se duhet pasur në konsideratë interesat e tyre, në të gjitha ligjet të cilat ligje nuk sjellin interes, ato ligje nuk do të ishin ligje mëshirësie dhe nuk ka obligueshmëri pa dobi dhe do të ishte në kundërshtim me përgjithësimin. Pastaj thotë: Në të shumtën e rasteve ligji e ka arsyeshmërinë e vet. Kjo nga shkakut që të logjikohet dhe të shikohet kuptimi.

24. Hadhithi është i mirë. E ka transmetuar Ibni Maxhe, Darukutniju dhe të tjerët, me mbështetje zinxhirore. Maliku e ka transmetuar si hadith mursal në librin e tij “Muvetta”. Hadithi ndahet te Ebi Seid el Hudriju r.a. (“Dyzet hadithet e Neveviyu”.

25. “El-Mustesfa”, 1/143.

26. “Irshadul Fuhul”, 212-213.

27. “El-Muvafekat”, 1/39.

28. “El-iëtisam”, Shatibiju.

“El-Muvafekatë”, 1/29.

“Ibn Hanbeli”, prof. Muhamed Ebu Zehra, 302.

29. “Mekasidu Sher’jatu”, dr. Hasem Hamid, 2/322.

30. “Err-Risale”.

31. “Medasidu Sheriati”.

32. “El-Ihkam”.

“Nihajetu Sual”.

“El-Mestesfa”.

“El Menhulë”.

33. “Et-tekrirë vet-tehbire”.

“Muslim Thubut”.

34. “El-Muvafekat”, 1/39.

Ai ka thënë: Argumentimi harmonik, me të cilin mbështetet Maliku dhe Shafiiu. Edhe pse nuk dokumenton një bazë ligjore konkrete, veç dokumenton bazë të tërësishme ligjore.

35. “Irshadul fuhul”, 212. Thotë: Nëse interesi harmonik i bazës së tërësishme ligjore prej bazave ligjore ose të bazës së pjesëshme, atëherë të ndërtohen ligje mbi të, përndryshe jo.

36. “Tehrixh el furuë alel usulë”, 169.

37. “El-Menhulë lil Gazaliu”, 364.

38. “El Mustesfa”, 2/91.

“Tehrixh el furuë alel usulë”, 163.

“Sherhul mehalij”, 2/174.

- librat bazë të kijasit.

39. Në librin e tij “Err-Risale”. Shafiiu në argumentimin për rregullat e usulit, në të cilat mbështetet fekihi, ai e pason atë që e tregojnë rregullat e përgjithshme apo bazën e përgjithshme nga e cila burojnë degët dhe e përcakton veten e tij në përfitime të ligjeve, pastaj argumentohet për këtë bazë me argumente të cilat në përgjithësi dhe jo në veçanti shpijnë në vlefshmërinë e asaj baze ligjore. Shembull, argumentimi për argumentimin e kijasit në bazën ligjore të përgjithshme, të cilin Ligjvënësi e ka llogaritur që ligjet sekondare të ligjësohen në bazë të përputhshmërisë me bazën dhe kijasi të bëhet bazë për ligjësim, e ajo është se i ngarkuari (njeriu) në bazë të mundësive të arrij deri te kryerja e obligueshmërisë konkrete dhe trasimin e rrugës së ixhtihadit për të arritur deri te e dëshiruara nëse nuk mund të arrihet deri te e caktuara konkrete.

40. “El mustesfa”, 1/139.

41. Ibid.

42. Dallim i vogël në mes të kijasit dhe parimit të interesit është se, kijasi mbështetet në atributin konkret të përshtatshëm nëpërmjet tekstit, ashtu sikurse atributi ndikues ose nëpërmjet përputhshmërisë me dispozitën e Ligjvënësit ashtu siç është në atributin harmonizues përderisa parimi i interesit duhet që patjetër të mbështetet në ndonjë argument të cilin Ligjvënësi e llogarit si argument, vetëm se ato interesa nuk përfshihen si interesa posaçërisht prej tyre, por përfshinë llojin e interesit të largët prej tyre si f.v., lloji i sigurimit të shpirtave, mendjeve, jetëve, pasurive dhe pasardhësve (“Davabitul meslehatu”, dr. Muhamed Seid Ramadan”, 217).

43. “El Mustesfa”, 1/139, 140.

44. Ibid, 141.

45. “El Mustesfa”, 1/143.

46. Ibid, 1/41.

47. “Medasidul sheriati – Hamid”, 2/452.

48. Ibid, 457.

49. Ibid, 2/462.

50. Ibid, 463.

51. Ibid, 570.

52. “Muslimu Thubut”, 2/218.

53. "Et-Tekrirë vet-Tehbirë", 3/150.
54. "Muslimuth-Thubutë", 2/210.
55. "Muslimuth-Thubutë", 2/217.
56. "El-mustesfa", 1/144.
57. "Medasidush-sheriat – Hamid", 2/597.
58. "Mekasidush-sheriat Hamid", 2/604.
59. Transmeton Buhariu nga Enesi, po ashtu Davudi dhe tirmidhiu nga Ibni Umeri.
60. "Mekasidush-Sheriat – Hamid", 2/466.
61. "Irshadul Fuhulë", 212.
62. "Sherhu tenkijhul fusulë", 171-199.
63. "Ibni Hanbeli", 297.
64. "Iëlamul mukijjë".
65. Ibid, 2/392.
66. Transmeton Buhariu. E ka sjell edhe Tirmidhiu duke e dokumentuar prej hadithit të Hakim bin Hazamit. E kanë transmetuar Ahmed, Tirmidhiu, Davudi dhe Ibni Maxhe nga hadithi i Ebu Hurejres ("Subules-selam", 3/31).
67. "El Kavaid", Ibni Haxhib, 417.
- "Iëlamul mukijj", 2/393.
68. "Iëlamul mukijj", 2/130-133. Shiko fjalën e mrekullueshme të parimit të shpronësimit, një pjesë të bashkpronarit të tij me kundërshtim.
69. Transmeton Ahmed dhe Ibni Maxhe nga Ibni Abasi.
70. Transmeton Maliku, Ahmed dhe Ibni Maxhe nga Ebi Hurejre ("Et-Tenvirul Havalik", 2/218).
71. Transmeton Maliku në "Muvetaë", 2/218, nga Amr bin Jahja el Mazuniji e ai nga babai i tij.
72. Teksti i rregullit të Hanbelijë është: Çka konkretisht e kërkon nevoja të shfrytëzohet nuk ka dëm që të shfrytëzohet, por lehtësim apo që gjendet vazhdimisht, ose për shkak të dobive prej atyre nevojave duhet të shfrytëzohet pa pagesë dhe nuk kompensohet ("El-Kavaid", 227).
73. E ka regjistruar Muslimi dhe autorët e suneneve nga Xhabiri. K ndaluar fitimin prej qenve dhe leopardëve ("Xhemiul fevaid", 1/138).
74. E ka regjistruar Ahmed dhe dy shejhët nga Ebi Hurejre: Mos e pengoni tepricën e ujit duke e mbyllur rrjedhën apo burimin. Te shumica absolute e dijetarëve kuptimi është afër bunarit.
75. .
76. .
77. .
78. "El Kavaid", 230.
79. "El-Muvafekat", 1/259.
80. "El-Kavaid", 321.
81. Nuk lejohet dhurata para kryerjes së borxhit sepse do të kishte kuptim të korrupsionit, për këtë arsye nuk lejohet, siç e ka transmetuar Buhariu në "Tarijhun" e tij: Kur të jepet borxh, nuk pranohet dhuratë prej tij. Transmeton Enesi.

Po ashtu nga Ibn Maxhe transmeton Enesi: Nëse ndonjëri prej juve jep borxh dhe i jepet dhuratë apo i dhurohet në shërbim për t'i hipë ndonjë mjet transportues (kafshë) as mos ta pranojë atë dhuratë dhe as mos të hipë në të, vetëm po që se ka qenë zakon apo e kanë vepruar atë veprim edhe më parë (para dhënies së borxhit). Përserisa shtesa mbi borxhin e cila jepet kur të kryhet borxhi, pa ndonjë kusht apo pa ndonjë kërkesë, sipas të gjitha gjasave lejohet, pa dallim në mes të shtesës së cilësisë apo sasisë pak a shumë, bile është e pëlqyeshme me hadithin nga Ebi Hurejre, Ebi Rafiu dhe Urbad bin Sarijete, regjistruar në dy koleksionet e sakta. Te Ahmedi: Më i miri nga ju është ai i cili më së miri i lanë borxhet. (“Nejlul evtarë”, 5/231)

82. “İlâmul mukijîn”, 3/106-108.

83. “El Kavaid”, Ibni Haxhib.

84. E transmeton Maliku në “Muvetaâ” nga Muhamed el Bakiri e ai nga babai i tij Ali Zejnlul Abidijnë.

85. “Et-Tarikul Hukmijeti”, 259.

86. “Et-Tarikul Hukmijeti”, 247.

87. “Et-Tarikul Hukmijeti”, 244.

88. “Et-Tarikul Hukmijeti”, 245.

89. “El-Kavaid”, 110.

90. “El-Kavaid”, 112.

91. Transmetojnë koleksionistët përpos Muslimit dhe Nesaijut (që do të thotë e ka transmetuar Ahmedi, Buhariu, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu dhe Ibni Maxhe), nga Ebi Hurejre (Nejlul Evtarë”, 5/234).

92. “İlâmul mukijîn”, 2/292.

93. “Medasidu sheriati – Husejn Hamid”, 2/391.

94. “El-Kavaid”, 32.

95. “Mekasidu sheriati”, 32.

96. Ibid, 512.

97. Maliku – 459.

98. Transmetojnë koleksionistët përpos Nesaijut. E ka saktësuar Ibni Habani.

- E ka regjistruar Ahmedi, Bezari dhe Ebu Jealij, në senedet e tyre.

- E ka regjistruar Ibn Maxhe dhe Darukutniju në sunenet e tyre nga hadithi i Malikut në formulimin: Në kohën e Muhamedit a.s. në Medine u ngritën çmimet dhe njerëzit shkuan te Muhamedi a.s. dhe i thanë: - O i dërguar i Allahut, çmimet janë ngritur, përkufizoj ti. Pejgamberi s.a.v.s. u thotë: - Vërtet, Allahu është përcatues i çmimeve dhe ngushtues i gjendjeve, zgjerues dhe furnizues. Dëshiroj që ta takoj Allahun dhe asnjëri nga ju të mos kërkoj nga unë padrejtësi qoftë materiale qoftë fizike. Sa i përket përcaktimit të çmimeve, nuk ka dashur t'i caktoj. (“Nejlul Evtarë”, 5/219; “Keshful hafa”, Axhluni dhe “Mekasidul hamseti”, Sehaviju.

99. “Ibni Hanbel”, 303, Ebu Zehra.

100. Hadith mutevatir. Transmetojnë gjashtë koleksionistët nga Ebi Hurejre (“En-nudhumul munathir”, 29).

101. Transmeton Ahmedi dhe Muslimi nga Ebi Abasi i cili ka thënë: Në kohën e pejgamberit s.a.v.s. ka qenë një shkurorëzim me fjalë: je e shkurorëzuar tri herë të llogariten tri shkurorëzime.

Umer bin el Hatabi ka thënë: Njerëzit janë përsheptuar në një çështje, e cila për ta ka qenë egoizëm, nëse do t'ua lejonim atyre, ata vet e kanë vazhduar. Në transmetimin e Ebi Davudit: "... në kohën e pejgamberit s.a.v.s., në kohën e Ebu Bekrit dhe ka pasur elemente të tilla edhe në kohën e Umerit." ("Nejlul Evtarë", 6/230).

102. Ai është Ebu Rebië Sulejman ibn Abdul Kavij bin Abdul Kerijm et-Tufi, pastaj Bagdadiju. Ka lindur në vitin 670 h. në vendin Tufi afër Bagdadit. Ka lexuar te Ebi Hajani i cili ka qenë i njohur si Imam. Ka kuvenduar em imamët e Damaskut, prej tyre me Ibni Tejmijen. Ka vdekur në qytetin Halilë në muajin Rexhep të vitit 716 h. dhe e ka urreyer të veprohet sikurse të shiitët imamij.

103. Sa i përket adhurimeve, ka thënë: Është posaçërisht për Ligjvënësin, nuk mund të dihet masa, sasia, pesha dhe vendi i së drejtës së tij vetëm se prej Ligjvënësit dhe robi paraqitet para tij siç e ka programuar dhe vepron ashtu siç e ka mësuar Zoti që të jetë i kënaqur prej tij. Kështu është ky rast. Për këtë arsye kur është bërë adhurimi, filozofët me thëniet e tyre i kanë refuzuar shariatet. E kanë hidhëruar Allahun e Lartmadhëruar dhe i kanë humbur edhe të tjerët dhe kanë humbur edhe vet. Ndërsa e kundërta është në drejtat e të ngarkuarve. Ligjet e tyre janë politikë e ligjësimi të tyre, ato ligje janë ligjësuar për interesin e tyre. Kështu edhe llogariten dhe kjo duhet realizuar. ("Risalete fi Usulil Malikije", 67).

104. Disa kanë thënë: Tufi nuk e favorizon interesin ndaj tekstit të veçantë, ose që e thotë që të jetë përballë tekstit të prerë në zinxhirin dhe tregueshmërinë e tij, por nëse teksti dhe ixhmai i kundërshtojnë interesat, duhet t'i jepet përparësi interesit ndaj tyre nëpërmjet specifikimit dhe sqarimit të tyre, jo nëpërmjet rrugës së shkëputjes prej tyre, ose duke i anashkaluar (paralizuar) ata. ("El-meslehata fit-teshriul- islamij" autor dr. Mustafa Zejd, fq. 209).

105. "Risalete fi usulul malikijeti", posaçërisht në fq. 46, 55, 56, 64, 65. Në hyrje të librit i ka përmendur nëntëmbëdhjetë argumentime të ligjësimi. Ata të cilët i kanë komentuar dhe interpretuar në indeks kanë arritur në dyzet e pesë argumente e prej tyre Xhemalud-dijn el-Kasimiju.

106. Transmeton Muslimi, Nesaiju dhe Ebu Davudi nga Ebi Mes'udë el Bedrij. ("Xhem'ul fevaid", 1/243).

107. Ky tekst në këtë formulim është bërë i njohur në gjuhën e fukahave dhe interpretuesve të dy shejhat dhe të Nesaiju nga Aishja r.a.: Oj Aishe, po të mos ishte populli yt ende i freskët nga epoka e injorancës, do të urdhëroja që të priset Qabja dhe do ta vendosja mbrenda hapësirës prej së cilës e kanë nxjerrë jashtë, do ta ngulitsha për toke, do t'ia bëja derën nga lindja dhe derën nga perëndimi dhe do ta precizoj në themelet e Ibrahimit. ("Keshful hafa", 2/233, el Axheluni).

108. Transmetojnë dy shejhët nga Ibni Mes'udi. ("Xhem'ul Fevaid", 1/109).

109. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga hadithi i Amar bin Jasirit në formulimin: Të ka mjaftuar të veprosh kështu, dhe e ka prekur me duart e tij dheun në tokë, pastaj i ka shkundur, pastaj e ka lëmuar me shuplakën e tij dorën e djathtë, dhe me shuplakën tjetër dorën e majtë, pastaj me shuplakë e ka lëmuar fytyrën e tij. Në formulimin e Ismailit: Të ka mjaftuar që me duart tua ta prekësh tokën, pastaj të i kishe shkundur duart, pastaj me dorën e djathtë të lëmojshe të majtën dhe me të majtën të lëmojshe të djathtë pastaj të kishe lëmuar fytyrën. ("Xhem'ul Fevaid", 1/90; "Subules Selam", 1/95).

110. E kanë regjistruar dy shejhët nga Abdu Rrahman bin Ebeziju (“Xhem’ul Fevaïd”). Po ashtu e kanë transmetuar autorët e suneneve, shkurtazi me fjalë të përafërta. Vërehet se Umeri nuk e ka përgënjeshtuar Amarin, por e ka urdhëruar që ta tregoj atë.
111. “El Mustesfa”, 1/141.
- “El-Ihkam fi usulil Ahkam”, Amediu, 3/138.
112. “El Muvafekat”, 4/210.
113. E ka regjistruar Ibn Adiu me zinxhir të dobët. Ka dashur ta vërtetoj El-Hakimi por ka gabuar siç e tregon Ibn Haxheri në librin “Fi bulugul muram” (“Subules-Selam”, 4/130).
114. “Mekasidu sheriat”, dr. Husejn Hamidi, 1/69.
115. Transmetojnë grup autorësh, Ahmed, gjashtë koleksionistët, përpos Tirmidhiut nga Ibni Abasi në formulimin: Le të mos takohen në periferi (fshehtas) dhe të mos i shes rezidenti të huajit. (“Nejlul Evtar”, 5/164).
116. “Mekasidu Sheriat”, 1/95.
117. Ibid, 1/116.
118. Ibid, 116-182.
- “El Iëtisam”, Shatibiu, 2/115.
119. “Tefsirul Taberij”, 2/290.
- “Tefsiru Rraziju”.
- “Tefsir Ibni Kethiri”, 1/283.
- “Tefsirul Xhasas”, 1/477.
- “Ahkam”, Ibn Arabij.
- “Bahrul Muhij”, 2/263.
120. Hadithi mutevatir. E kanë regjistruar dy shejhët dhe katër autor të suneneve nga Ebu Hurejre.
121. Transmeton El Bejhekiu me zinxhir të saktë nga Ibni Abasi r.a.
122. “El multeka sherhul muvettaë”, 5/18.
- Hadithin e ka regjistruar Ahmed dhe Tirmidhiu, e ka saktësuar Ebu Davudi dhe Ibni Maxhe nga Enes bin Maliku në formulimin: Janë ngritur çmimet në kohën e peygamberit s.a.v.s. dhe i kanë thënë: - O i dërguar i Allahut, sikur t’i kishe përcaktuar ti çmimet, ndërsa Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Pa dyshim se Allahu është furnizues, ai është ngushtues i furnizimit dhe Ai është përcaktues i çmimeve, ndërsa unë shpresoj ta takoj Zotin e Lartmadhëruar që asnjëri nga ju atëherë të mos më kërkoj as dëmshpërblim fizik dhe as material. (“Nejlul Evtarë”, 5/219).
123. “Tenvirul Havaliki sherh muvetta Malik”, 2/9.
- Hadithin e transmeton Buhariu (“Subules selam”, 4/60).
124. E ka regjistruar Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu nga Aishja: Pesë shkatërrimtar vriten në Qabe: miu, akrepi, sorra, ??? dhe qeni i çartur. Ky është tekst prej Tirmidhiut, ndërsa nga Ibni Umeri dhe Ibni Abasi sipas Muslimit dhe Ahmedit “dhe gjarpri”. (“Nejlul Evtarë”, 5/26).
125. Mutefikun alejhi në mes të dy shejhave nga Ibni Abasi (“Nejlul Evtarë”, 5/24).
126. “Mekasidu Sheriat”, 2/530.
- “Ibni Hanbeli”, fq.304, Ebu Zehra.
127. “Mekasidu sheriat”, 2/538, Husejn Hamid Mustafa Zejd.
128. Ibid.

“Davabitul meslehati”, fq. 207, dr. Seid Ramadan.

129. “El muvafekat”, 4/112.

130. Transmeton Buahriu nga Ibni Umeri, r.a. (“Sahihul Buhari”, 5/243).

131. Ibid. Është kuptuar se transmetimi i saktë është: Po të mos ishte populli yt i freskët nga koha e injorancës ose të pabesimit, do ta prishja Qaben dhe do ta ndërtoja mbi themelet e Ibrahimit a.s.

132. Transmeton Ahmedi dhe dy shejhët nga Xhabiri. Transmetojnë dy shejhët dhe Ebu Davudi dhe Nesaiju nga Ibni Abasi r.a.

133. Transmeton Ebu Jealiju nga Ebu Bekri Siddiki, ndërsa në atë zinxhir është Suvejd bin Abdul Azizi. Është hadithë metrukë (“Mexhmea Zevaid”, 1/15).

Transmetohet tregimi nga Ebi Dardai dhe Umeri dhe Ahmedi, Bezaziu dhe Taberiu në librin “El-Kebirë” dhe “El-Muvesat”.

Më i sigurt është zinxhiri i Ahmedit. Në atë zinxhir është Ibni Lehiate. Me këtë janë argumentuar shumë.

- E ka transmetuar el-Bezaziu nga Ebi Seid el Hudriju në formulimin: Kush thotë me sinjeritet LA ILAHE IL-LALLAH do të hyn në xhenet. (Hadith i saktë)

134. Është vërtetuar në sunet se peygamberi s.a.v.s. e ka ndaluar mbytjen e falësve dhe se namazi ndalon gjakderdhjen dhe i fshinë mëkatet. (“Mexhmea Zevaid”, 1/24-28 dhe 296-301).

- Transmeton el Bezaziu nga Enesi se Ebu Bekri r.a. ka thënë: Peygamberi s.a.v.s. e ka ndaluar të vriten falësit.

Përmbajtja:

<i>Parimi i interesit</i>	4
Tema e parë: Llojet e Interesave.....	7
Tema e dytë: Definicioni i parimit të interesit	8
Tema e tretë: Argumentimi i parimit të interesit	10
Si e llogaritë Shafiiu interesin?	20
Teoria e parimit të interesit te Gazaliu	22
Klasifikimi i parë: Klasifikimi i interesit në bazë të dëshimit të shariatit.....	22
Klasifikimi i dytë: Klasifikimi i interesit në bazë të fuqisë së saj.....	23
Klasifikimi i tretë: Klasifikimi në bazë të përshtatshmërisë dhe përgjithshmërisë apo tërësisë	25
Teoria e parimit të interesit te Hanefijtë	27
E para: Harmonia	27
E dyta: Istihsan i Hanefijëve	31
E treta: Çka llogaritet përshtatshmëri apo zëvendësim.....	33
Teoria e parimit të interesit te Hanbelijtë	35
Komenti i Malikijve në çështjen e të kundërshtuarit të interesit me tekstet.....	56
A i jep imam Maliku prioritet interesit ndaj tekstit?.....	61
Sqarim i mendimit të dijetarit Tufi sa i përket parimit të interesit.....	65

